Materialet e kënaqshme të dheut të përdorura si rimbushje për transhetë, kullim dhe për strukturat duhet të përbëhen nga materiale vendase të klasifikuara si dhe nga rërë të mirë graduar, rërë me përmbajtje balte ose argjile të cilat janë të pastër nga mbetjet, rrënjët, drunjtë, materiale të tjera vegjetale si dhe plehra.

3.7.3 Mbushja Përzgjedhëse

Materiali i përzgjedhur për mbushje duhet të përbëhet nga rëra dhe gurët e shtypur. Rimbushja do të kryhet duke shtypur shtresat për të arritur nivelin e 96% të standardit Proctor në rastin e materialit të ngjeshur, ose Id>0.67 në rastin materialit jo të ngjeshur. Materiali që duhet të përdoret do të miratohet nga Mbikëqyrësi.

3.7.4 Rërë Lumi

Rëra duhet të jetë rërë natyrore lumi, e përbërë nga grimca të forta dhe të pastra, të qarta në ngjyrë dhe në formë sferike. Rëra duhet të jetë e pastër dhe pa substanca organike, baltë, apo papastërti të tera. Përbërja e granulimit të rërës duhet të jetë nga 0,5mm deri në 1,0mm.

3.7.5 Materialet e Shtratit

Duhet të jetë rërë e imët dhe me një granulim nga 0 mm deri në3.0 mm.

PJESA 3 - ZBATIMI

3.8 PREGATITJA E SIPËRFAQES

3.8.1 Ruajtja e Shtresës së Punueshme

Dhe' i përshtatshëm për pastrim nga kantieri ku gërmimi kryhet dhe ndahet në mënyrë të veçantë nga materiali tjetër i gërmuar. Material i papërshtatshëm për tu përdorur si shtresë e punueshme do të largohet nga kantieri. Pozicionimi i shtresës së sipërme, në mënyrë që materiali të jete lehtesisht i lexueshem per shkallen e perfundimit. Kur të gërmohet shtresa e sipërme dhe ajo nuk përmbush standardet e kërkuara, duhet të mundësohen materiale të përshtatshme përdorimi te shtresës sipërme.

3.9 GËRMIMI

3.9.1 E përgjithshme

Gërmimi do të përfshijë heqjen dhe hedhjen e të gjithë materialit për të marrë të gjithë ngjitjet nën shkallë sipas specifikimeve.

3.9.2 Ruajtja e Personave dhe Pronës

Të gjitha gërmimet do të kryhen pas rrethimeve dhe të kenë shenja paralajmëruese gjatë orëve të natës. Strukturat, kanalizimet, trotuaret pllakat dhe ndërtimet e tjera menjëherë ngjitur me gërmimet do të ruhen ndaj dëmtimeve duke përfshirë zhvendosjen, lëvizjen anësore, heqjen e bazamentit dhe rrëshqitjet. Barrierat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që ngarkimi i mjeteve pranëgërmimeve të shmanget. Trungje parandaluese duhet të vendosen në cepin e gërmimeve për të parandaluar që mjetet të mos kalojnë në zonën e gërmimit kur ecin mbrapsht.

3.9.3 Gërmimi për Struktura

Gërmimi për strukturat duhet të konfirmojë me dimensionet dhe mbushjet e treguara me një tolerancë plus minus 15cm dhe do të shkojnë në një distancë të mjaftueshme nga themelet për të lejuar mundësi të mjaftueshme punimi minimalisht 50cm për vendosjen e formave të betonit, instalimin e shërbimeve dhe të ndërtimeve të tjera të treguara, si dhe për inspektim. Në gërmimet për bazamentin e themeleve, të bëhet kujdes që të mos ngacmohet fundi i gërmimeve. Në përgjithësi 10cm e fundit të gërmimeve duhet të largohen pak para se të hidhet betoni.

3.9.4 Gërmimi i Transheve

Gërmimi do të përbëhet nga gërmimi për themelet ose kanalizimet dhe transhetë e vendosjes së bimëve. Të pergatiten transhe aq vertikale sa të jetë e mundur përveç se kur lejohet skarpata.

3.9.5 Gërmimi për Gropat e Ndërtimit dhe Themelet

Punimet e Gërmimit duhet të përfshijnë gërmime për thellesi gropash te pjerrta apo te drejta ne varesi të godinave duke përfshirë përgatitjen themeleve, duke niveluar dhe ngjeshur. Për më tepër duhet të përfshijë gërmimet për thellesi gropash ndertimi duke përfshirë transportin deri në 2km dhe të mbushë dheun duke e ngjeshur.

3.9.6 Gërmimi për Zonat e Shtruara

Gërmimet do të kenë në përbërje të tyre klasifikimin për zonat e shtruara; gërmimi dhe nxjerrja e të gjithë materialeve të papërdorshme pavarësisht karakterit të tyre, nga nënshtresat; dhe hedhjen e të gjithë materialit të gërmuar, siç është specifikuar në përputhje me vijat, klasifikimet, seksionet dhe dimensionet e përcaktuara në skica, dhe për të zëvendësuar materialet e papershtatshme nga germime te tjera dhe operacione klasifikuese.

3.9.7 Gërmimet e Paautorizuara

Gërmimet e paautorizuara të cilat përmbajnë heqje materialesh përtej ngritjeve të treguara të nënshtresave ose të dimensioneve anësore pa miratimin specifik të Mbikëqyrësit do të rivendosen pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues. Gërmimet e paautorizuara në bazamentin e themeleve prej betoni ose me një mbushje të përzgjedhur të mirëngjeshur, pa ndryshuar lartësinë maksimale të miratuar. Kudo që të kryhen gërmimet e paautorizuara do të rimbushen dhe ngjeshen në baze të klasifikimit të gërmimeve të autorizuara.

3.9.8 Qëndrueshmëria e Gërmimeve

Anët e gërmimeve mbi një thellësi prej 1,5m duhet të jenë me pjerresi, me kënd mbështetës për materialin e gërmuar, ose do të mbahen dhe lidhen aty ku animi nuk është i mundur ose sepse ka kufizime në hapësirë ose për arsye të materialeve të gërmuara. Anët dhe pjerresite e gërmimeve do të ruhen si të tilla deri në perfundim te mbushjeve apo vendosje në kushte të sigurta deri në sistemim ose lidhje. Kujdes i duhet kushtuar për të parandaluar rrezimin e aneve, kur gërmimet janë subjekt i lëkundjeve nga trafiku i mjeteve ose veprimit të makinerive apo nga ndonjë burim tjetër.

Materialet e gërmuara nuk duhet të jenë pranë buzez të skarpates se perforcuar, por në largësinë jo më shumë se një e treta e thellësisë së transhesë. Për transhetë e pa perforcuara, kjo distancë do të varet nga thellësia e gërmimeve, përmbajtja e lagështisë dhe fuqia ngjitëse e materialit dhe profili i gërmimit. Në përgjithësi, materiali i gërmuar duhet të vendoset jashtë me një anim prej 45 gradësh që kalon nga fundi i gërmimit.

3.9.9 Perforcimet dhe Mbeshtetjet

Materialet e përdorura për perforcimin dhe mbeshtetje, si nyje e formave dhe madhësive të ndryshme duhet të jenë në kushte të mira shërbimi. I gjithë druri i përdorur duhet të jetë i mirë dhe pa nyje të mëdha e të hapura. Perforcimet dhe mbështetjet në gërmime duhet të ruhen pavarësisht kohëzgjatjes së gërmimeve ose kohës që gërmimi qëndron i hapur. Të gjitha perforcimet dhe mbështetjet duhen çuar ne nivelin e gërmimeve. Kurdoherë që heqja e tyre mund të lejojë lëvizje anësore të dheut nën strukturat ngjitur, duhet të përdoret dru i presuar dhe platforma metalike si dhe të lihen e te priten në mënyrë permanente në vend, në bazë të kërkesës.

3.9.10 Largimet e Ujrave

Gërmimet duhet të kryhen në një mënyrë që të parandalojnë ujin sipërfaqësor ose nëntokësor, të përmbytë kantierin dhe zonën përreth. Uji nuk duhet lejuar që të grumbullohet në gërmim.
I gjithë uji duhet të largohet nga gërmimet në mënyrë që te mos ndodhe paqendrueshmeria e fundit të themeleve, animi i pilotave dhe ndryshimet në dhe' që përkeqësojnë qendrueshmerine e nënshtresave dhe të themeleve. Pompat thithëse dhe linjat e shkarkimit si dhe sistemet e tjera të largimit të ujit me gjithë përbërësit e tyre duhet të mundësohen dhe të mirëmbahen sipas nevojës për të çuar ujin larg gërmimeve. Operacionet e heqjes dhe largimit të ujit duhet të jenë të vazhdueshme deri në rimbushjen totale dhe deri në momentin kur ndërtimi i cili është subjekt i presionit të ujit, të ketë marrë fuqinë e nevojshme. Në të gjitha hapat, operacionet e largimit të ujit duhet të vazhdojnë sa kohë që uji mund të futet ose mblidhet në gërmime. Uji i larguar nga gërmimet dhe uji i shiut duhet larguar në kanalizimet ujëmbledhëse sipas miratimit të Mbikëqyrësit. Kanalet e përkohshme të tharjes dhe shmangiet e tjera duhet të jepen dhe ruhen jashtë kufijve të gërmimeve për secilën strukturë. Përdorimi i gërmimeve të skarpatave për shërbime në kantier si kanalizime te përkohshme të tharjes nuk do të lejohen.

3.10 RIMBUSHJE & MBUSHJE

3.10.1 E përgjithshme

Rimbushja do të konsistoje në vendosjen e materialit të specifikuar rimbushës, në shtresa, në gërmimet e nënshtresave të treguara. Mbushja duhet të përbëhet nga vendosja e materialeve të specifikuara në shtresa, mbi sipërfaqen e tokës për nivelin e treguar, për çdo zonë siç është klasifikuar më poshtë:

3.10.2 Rimbushje dhe Materialet Mbushes

Materialet e dheut për rimbushje duhet të jenë të pastra nga mbetjet e argjilës, gurë ose zhavorr më të mëdhenj se 6cm. Mbetjet dhe ndonjë material tjetër i dëmshëm i çdo madhësie duhet të hiqet. Mbushjet duhet të jenë me material të kënaqshëm.

3.10.3 Përgatitja e Sipërfaqes se Tokes per mbushje

Bimësia, mbetjet, materialet e dheut të cilat nuk janë të kënaqshme, pengesat dhe materialet e dëmshme duhet të largohen nga sipërfaqja e nivelit te tokes para vendosjes së mbushjes. Sipërfaqet e pjerrta me pjerresi nga nje vertikale ne katër horizontale, duhet të plugohen, pastrohen ose tharmohen në të tillë mënyrë që materiali mbushës të lidhet me materialin ekzistues. Kur sipërfaqja e tokës ka një dendësi më pak se sa ajo e specifikuar për zonën e veçantë të klasifikuar, sipërfaqja e dheut duhet të copëtohet, kthehet në pluhur, dhe te permbaje kushte lageshtie më të mirat e mundshme të materialit të dheut në thellësinë e kërkuar dhe përqindje dendësisë maksimale.

3.10.4 Rimbushja e Transheve

Transhetë duhet të rimbushen me kujdes me materialet e specifikuara dhe depozituar në shtresa maksimale prej 15 cm, ne thellësi të lirë. Materiali i nevojshëm përreth (për sa i përket fundit) duhet të barazohet nga të gjitha anët e kanalizimeve në të gjithë gjatësinë, dhe duhet të ngjeshet tërësisht dhe me kujdes deri sa kanalizimi të ketë një shtresë mbuluese prej jo më pak se 30cm. Duhet pasur kujdes që tubacioni ose kanalizimet të mos dëmtohen, apo lyerjet dhe bojërat speciale që rrethojnë kanalizimin ose tubacionin. Pasi të vendoset kjo shtresë, duhen vendosur shenja dalluese/treguese për kanalizimet përkatëse. Pjesa tjetër e materialit rimbushës duhet të depozitohet në transhe në shtresa të pangjitura prej 30cm dhe të ngjeshet me makineri ngjeshëse të operuara me dorë. Transhetë dhe gropat e gërmimit që nuk janë mbushur siç duhet aty ku ndodh sedimentimi, duhet të rihapen në thellësinë e kërkuar për të marrë ngjeshjen e duhur e më pas të rimbushen dhe ngjeshen me sipërfaqen e kthyer në shkallën e kërkuar të ngjeshjes.
Për të parandaluar humbjen e materialit nëpërmjet efekteve të drenazhimit në materialin e poshtëm dhe atë përreth në transhetë e pjerrta, barriera te papershkrueshme materiali si masa argjirore, duhet të instalohen në të gjithë gjerësinë e gërmimit të paktën 30m me qendër të matur përgjatë vijës së transhesë.

3.10.5 Përgatitja nën Shtresore për Zonat e Shtruara

Pas perfundimit te fazes dhe menjëherë përpara depozitimit të materialit sipërfaqësor, nënshtresa duhet të sillet në trajta te duhura, sipas kategorise dhe prerjeve te duhura te dhena në përputhje me këto specifikime. Të gjitha gropat dhe shtypjet duhet të hiqen duke i tërhequr dhe me teh në mënyre që të sigurohet njëtrajtshmëri në sipërfaqe. E gjithë nënshtresa duhet të sillet në një sipërfaqe të fortë dhe kompakte, në një vijë të drejtë duke rrotulluar mbi to rrulat e miratuar, deri sa të ngjeshet tërësisht. Ky veprim duhet të përfshijë lagien dhe riformatimin e kërkuar për te marrë ngjeshjen e duhur. Të gjitha vendet e buta dhe jo kompakte duhet të hiqen tërësisht dhe hapësira të rimbushet me materialin e përshtatshëm dhe të ngjeshet tërësisht. Në ato zona duhet vendosur nje shtrese stabilizuese, nga lart nën shtresa nuk duhet të tregojë një devijim më të madh se sa 12mm. Ngjeshja e nënshtresave duhet të shtrihet deri tek anët për një distance prej të paktën 30cm përtej skajit të shtreses stabilizuese apo shtrimit. Nënshtresa duhet të mirëmbahet në kushtet e përfunduara deri kur të jetë vendosur shtresa e pare e sipërfaqes.

3.10.6 Përgatitja për Zonat e Mbjella

Zonat e mbjella duhet të kategorizohen nga dimensionet, pamjet dhe prerjet e tyre sipas treguesve në skica. 10 cm e sipërm të këtyre zonave do të përbëhen nga dhe' i punueshëm, i cili duhet të ngjeshet lehtësisht. I gjithë materiali poshtë shtresës së punueshme duhet të ngjeshet sipas specifikimeve për përgatitjen e nënshtresave.
Shtresa e punueshëm do të përhapet në mënyrë uniform në zonat e përcaktuara dhe të përhapet në mënyrë të barabartë më një trashësi mesatare prej 10cm me një trashësi minimale prej 8cm. Para se të hidhet shtresa e punueshme, nënshtresa e ngjeshur nga trafiku mbi të apo shkaqe të tjera, duhet lehtësuar me përdorim të diskut ose plugës në një thellësi prej 6cm për të lejuar lidhjen e nënshtresës. Shpërndarja duhet të kryhet në të tillë mënyra që mbjellja të mund të vazhdojë me pak përgatitje të dheut ose plugim. Çdo rregullsi në sipërfaqe e cila rezulton nga hedhja e shtresës së punueshme ose e ndonjë veprimi tjetër do të korrigjohet në mënyrë që të parandalojë formimin e gropëzave ku mund të mblidhet uji. Shtresa e punueshme nuk do të vendoset kur nënshtresa është tepër e lagur, tepër e thatë ose në kushte të këqija për plugimin e duhur.

3.11 NGJESHJA

3.11.1 E Përgjithshme

Ngjeshja e materialeve të dheut për rimbushje dhe mbushje, do të kryhet me përdorimin e pajisjeve ngjeshëse të përshtatshme për materialin e dheut që ngjeshet për përdorim në zonën ku po punohet. Ngjeshja e dheut duhet të kontrollohet gjatë ndërtimit për përputhshmëri në përqindje te dendësisë maksimale për çdo klasifikim zonal sipas specifikimeve.

3.11.2 Vendosja dhe Ngjeshja

Materiali mbushës dhe rimbushës do të vendoset në shtresa prej jo më shumë se 15 cm në thellësi. Para ngjeshjeve, çdo shtresë mbushëse ose rimbushëse duhet të njomet ose ajroset sipas nevojës për të dhënë përqindjen optimale të lagështisë së materialit të dheut. Materiali mbushës dhe rimbushës do të jetë i ngjeshur me dendësi maksimale prej 95% në një thellësi prej jo më pak 25cm për çdo klasifikim zonal në bazë të specifikimeve. Asnjë material mbushës ose rimbushës nuk do të vendoset në sipërfaqet të cilat janë me baltë, të ngrira ose që përmbajnë ngrica apo akull. Materialet për mbushje dhe rimbushje pranë strukturave duhet të sillen në mënyrë të barabartë rreth strukturës në thellësinë e materialit të mbushjes ose të rimbushjes (të matur nga fundi i themeleve ose i mureve mbajtës) deri në nivelin përfundimtar, e duhet të ngjeshen me makineri ngjeshëse të operuara me dorë. Mbushjet poroze duhet të ngjeshen me minimumin dy kalime të një ngjeshësi lëkundës të operuar me dorë.

3.11.3 Ngjeshja

Dheu i nënshtresës në prerje duhet të ketë një dendësi prej ta paktën 95% në thellësinë 25cm nën sipërfaqen e nënshtresës. Mbushjet, anët dhe/ose rimbushjet poshte soletes se betonit dhe 30cm e sipërme në zonat e shtruara duhet të ngjeshen në jo më pak se 95% të dendësisë maksimale; rimbushjet e tjera pranë por që nuk mbështesin elementë strukturorë të paktën 90%. 30 cm e sipërm të transheve duhet të ngjeshen në të paktën 95% si dendësi maksimale.

3.12 GRADIMI

3.12.1 E Përgjithshme

Të gjitha zonat brenda kufizimeve të shkalles nën këtë seksion, duke përfshirë zonat e kalimit

do të jenë ne shkalle uniforme. Sipërfaqet e përfunduara do të sheshohen me tolerancat e specifikuara.

3.12.2 Zonat me Bar

Zonat me siperfaqe te perfunduar për të marrë shtresen finale nuk do të jetë më shumë se 3cm mbi ose nën pamjet e treguara nënshtresa.
Përqindja minimale me peshë të farës së gjallë do të jetë 88%.
Plehu do të jetë 12% nitrogjen, 18% fosfor dhe 12% potasium (12-18-12) dhe në përbërje uniforme, me derdhje të lirë dhe i përshtatshëm për përdorim
Nivelimi:
Parregullsitë në sipërfaqe nga plehërimi ose veprime të tjera duhet të nivelohen përpara se të hidhet fara. Mbjellja e farave:
Të gjitha punimet e farave do të kryhen gjatë sezonit më të favorshëm të mbjelljes për speciet e përcaktuara.

3.12.3 Zonat e trotuareve

Sipërfaqja e zonës nën trotuare do të trajtohet në kufi, sipas shkalles, prerjeve dhe rifinitures sipërfaqja e përfunduar nuk do të jetë më shumë se 1-2cm poshte pamjeve te shtresave të treguara.

3.13 PERPUNIMI I ZONAVE TË NGJESHURA

Ku është e duhur zonat e ngjeshura mund te preken nga ndërtimet e mëpasshme ose moti i keq, sipërfaqja duhet të riformulohet dhe ngjeshet siç specifikohet më lart, në dendësinë para se të kryhen ato ndërtime, ri- ngjeshja mbi kanalizimet nëntokësore duhet të kryhen me makineri të operuara me dorë.

3.14 MARRJA E KAMPIONEVE DHE TESTIMET

Testimi

Të gjitha testimet duhet të kryhen siç specifikohet më poshtë:

Testimi i mbushjeve me grimca

Testi i gradimit duhet të kryhet në çdo shembull. Testet duhet të kryhen për çdo 100 m3 material të përdorur ose një pjesë e saj dhe kurdoherë që ndryshon burimi.

Testi i Ngjeshjes

Testet e ngjeshjes duhet të kryhen në vendndodhje si më poshtë:

Materialet	**Frekuenca e Testeve**
(1) Mbushje dhe rimbushjet	**1 për ngritje për çdo100m2**
(2) nënshtresa (dendësia që është në vend)	**1 për ngritje për çdo800m2**
(3) mbushja e transheve poshtë shtresave	**1 për ngritje për çdo200m transhe**

3.15 MAKINERI DHE PAISJE

Për shkak se objekti është strukturë spitalore në funksion, dhe një pjesë e repartit të urgjencës do të vazhdojë aktivitetin gjatë punimeve, të gjitha pajisjet që do të përdoren për prishje dhe transport të materialeve brenda godinës duhet të plotësojnë këto kërkesa teknike:

Të jenë pajisje elektrike ose pneumatike (me ajër të kompresuar) dhe jo me motor me djegie të brendshme (naftë ose benzinë), me qëllim eliminimin e emetimeve të gazrave dhe reduktimin e ndotjes së ajrit në ambientet spitalore.

Pajisjet duhet të kenë nivel të ulët zhurme dhe vibrimi, në përputhje me kërkesat për punime në ambiente spitalore dhe në zona me pacientë.

Të jenë kompakte dhe të përshtatshme për punë në ambiente të brendshme, korridore dhe hapësira të kufizuara.

Pajisjet duhet të jenë të pajisura me sisteme reduktimi pluhuri, si: aspirim pluhuri ,lagie me ujë gjatë prishjes.

Të gjitha pajisjet duhet të kenë: certifikim CE ,dokumentacion teknik dhe manual përdorimi , kontroll teknik dhe mirëmbajtje të rregullt.

Pajisje tipike që përdoren në spitale për prishje të brendshme

1. Mini-Eskavatorët Elektrikë (Më të rekomanduarit)

Në spitale, përdorimi i motorëve me naftë brenda ose afër godinave është i ndaluar për shkak të gazrave toksikë. Avantazhi: Zero emetime gazi dhe zhurmë minimale. Modelet: Prodhues si CAT (301.9), Bobcat (E10e) ose JCB ofrojnë versione me bateri që kalojnë nëpër dyer standarde (gjerësi rreth 71-100 cm).

2. Mini-Eskavatorët me Zinxhirë Gome

Për të mos dëmtuar dyshemetë ekzistuese (si ato me vinil apo PU flooring që diskutuam), përdoren eskavatorë që kanë zinxhirë gome dhe jo metalikë.

Funksioni: Gërmime për themelet e reja, kanale për tubacionet e oksigjenit ose rrjetin e ri elektrik.

3. Karroca elektrike transporti
4. Aspirator industrial për pluhur
5. Makineri ngjeshjeje dhe heqje mbeturinash, për punë në hapësira të kufizuara, me gjerësi deri në 10 cm me 100 cm, me lopatë të përparme.
6. 1Makineri germimi dhe ngjeshjeje, për punë në hapsira të ngushta, me gjerësi deri në 15cm me 90 cm.
7. Vinç 4 m, me shpejtësi të ngritjes jo më pak se 2.8 m/min, dhe shpejtësi motori 3 Kw.
8. Motokarroc me zinxhir, të pajisur me pirun ngritës të përparmë për transportin e ngarkesave të rënda, e pajisur me kontenier hidraulik me kapacitet të ngarkimit 600 kg.

4 STRUKTURA BETONI TE DERDHURA NE VEND

PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

4.1 REFERENCAT

Standartet e references jane standartet shqiptare dhe standartet e vendeve te bashkimit Evropian EEC si dhe ato te Shteteve te Bashkuara (AFNOR, ASTM, AASHTO etj) qe konsiderohen si ekuivalente.
Sipermarresi per standartet duhet paraprakisht te marre miratimin e Supervizorit te punimeve perpara fillimit te punimeve.

Njesite
Dokumentat dhe specifikimet teknike jane hartuar duke perdorur sistemin metrik nderkombeter (SI) te njesive. Ne kete specifikim perdoren shkurtimet e meposhtme:

Njesite	**Shkurtim**
Milimeter	mm
Meter (linear, katror, kub)	m, m^2, m^3
Diameter	D
Ore	h
Litra	L
Rezistenca	MPa
Rezistenca	N/mm^2
Ngarkesa	Ton, [kg]

Ligjet dhe Normat e aplikueshme
Normat Shqiptare
Normat dhe standardet Evropiane

DIN EN 12350-1 : 2001	**Kampionet e betonit të marra në kantier**
DIN EN 12390-2	**Përgatitja e testeve të betonit**
DIN EN 12504-1	**Kampionet e betonit të forcuar**
DIN EN 12390-3	**Testet ne shkatërim të betonit ne shtypje**
DIN EN 934-2	**Perzjeresit e betonit dhe metodat e kontrollit**
DIN EN 206	**Betoni, specifikimet, performanca, prodhimi dhe konformiteti**
DIN EN 12350-2	**Testimi i betonit te Freskët –Testi i konsistences se betonit te fresket**

DIN 18331	**Procedurat e kontratës së ndërtimit (VOB) Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike në kontratat e ndërtimit . Punimet me beton**
DIN 18541-1	**Rripat ngjitës termoplastik waterstop per mbylljen e nyjeve te strukturave te betonit. Format, dimensionet, standartet.**
DIN 18541-2	**Rripat ngjitës termoplastik waterstop per mbylljen e nyjeve te strukturave te betonit. Testimet dhe inspektimet ne kantjer.**

4.2 DOKUMENTACIONI

Të dhënat e Prodhuesit

Per cdo material te perdorur ne kantjer duhet te mbahen dhe te paraqiten paraprakisht tek mbikqyresi i punimeve certifikatat dhe karakteristikat teknike. Per perdorimin e materialeve te ndertimit duhet te merret miratimi me shkrim nga supervizori i punimeve.

Vizatimet Teknike

Nga fillimi i punimeve ne kantjer inxhinieri i kantjerit dhe supervizori duhet te pajien me dokumentacionin teknik te projektit.

Dokumentacioni teknik permban te gjithe dosjjen e vizatimeve teknike te nderhyrjeve ne strukturat ekzistuese dhe ne ndertimet e reja.
Permasat dhe pozicionet e elementeve strukturale duhet te verifikohen ne vend. Kjo kerkese eshte shume e rendesishme ne rastin e nderhyrjeve ne strukturat ekzistuese pasi mund te kete nderhyrje te realizuara ne kohe te mevoneshme nga ndertimi fillestar dhe te pa dokumentuara.
Vizatimet teknike per strukturat betonarme paraqesin dimensionimin e kallepeve dhe detajimin e armatures se celikut per cdo element struktural.
Gjate zbatimit te merret parasysh fakti se gjatesite e xhuntimit te shufrave jane dhene ne vlerat minimale te tyre. Cdo ndryshim duhet te jete ne vlera me te medha se ato te percaktuara ne vizatimet teknike
Vizatimet teknike per strukturat metalike paraqesin dimensionimin per cdo element struktural.
Gjate zbatimit ne nderhyrjet e strukturave ekzistuese permasat duhet te verifikohen ne vend.

4.3 DORËZIMI DHE RUAJTJA E MATERIALEVE.

Materialet e paketuar duhet të dorëzohen në vendndodhjen e projektit në kopje origjinale te tyre, te paketuar ne pako apo kontenier të pahapur. Pakot duhet të mbajnë emrin e prodhuesit qartësisht të identifikueshëm, emrin e markës, materialin, peshën ose volumin, dhe informacione të tjera identifikuese, të ruajtura në origjinalin e tyre, pako ose kontenier të pathyer në një vend të thate dhe padepërtueshëm nga agjentet atmosferike, deri sa të jenë gati për përdorim. Përbërësit e papaketuar duhet të ruhen në mënyrë që të evitohen ndotje nga materialet e tjera.
Armatura e celikut duhet te depozitohet në grumbuj të veçante, mbi toke për të shmangur ndryshkjen, ndotjen nga ndotësit si graso, vaj, pluhur etj. Per cdo paketim te thyer apo te hapur duhet te behet identifikim i sakte.
Betoni plastik i pergatitur duhet te jete i gatshëm per kantjer pasi te jene realizuar kallepet dhe

te jete lidhur armatura e celikut per strukturat betonarme.
Soletat e parafabrikuara qe perdoren kryesisht ne mbulesen e depos se karburantit do të dorëzohen dhe ruhen në kantjer pa u dëmtuar.

4.4 CILËSIA E BETONIT

Betoni klasifikohet bazuar ne:

- Rezistencen
- Klasen e ekspozicionit
- Klasen e konsistences se betonit plastik
- Rezistenca e betonit identifikohet nepermjet klasave te rezistences se betonit sipas tabeles me poshte.

Perdorimi sipas Euronormave percaktohet per cdo element nese nuk percaktohet ndryshe ne projekt.

Klasat e rezistences se betonit	
C 8/10	**Beton mbushes**
C 12/15	**Shtresa**
C 16/20	
C 20/25	**Themele, kolona, trare, soleta**
C 25/30	**Themele, kolona, trare, soleta**
C 30/37	**Themele, kolona, trare, soleta**
C 35/45	**Suporte, ura, vepra te rendesise te vecante**
C 40/50	
….	**….**
C 100/115	**Ultra performance**

- Klasa e ekspozicionit percaktohet sipas pozicionimit te elementit ne strukture.

Klasa e ekspozicionit	**Veprimi**
XC	**Karbonatizim**
XD	**Kloride**
XS	**Uji i detit**
XO	**Korrozioni**
XF	**Ngricat**
XA	**Kimik**

- Klasa e konsistences se betonit plastik

EN		
Klasa	**Perdorimi**	**Masa e hapjes [mm]**
S1	**Cati, mbushje,**	**10 deri 40**
S2	**Themele, soleta, struktura te tjera**	**50 deri 90**
S3	**Themele, soleta, beton i pompueshem**	**100 deri 150**
S4	**Themele, soleta, shtresa, beton i pompueshem**	**160 deri 210**
S5	**Nivelim**	**>210**

Klasat e rezistences percaktojne paraprakisht perdorimin e betonit ne elementet e vecante strukturale. Percaktimi perfundimtar merr ne konsiderate edhe faktoret e tjere si klasen e ekzpozicionit te elementit dhe klasen e konsistences.
Per cdo element prej betoni ose betoni te armuar identifikimi i klases se betonit te perzgjedhur duhet te plotesoje tre tabelat e mesiperme nese nuk ka specifikim tjeter ne projekt.

PJESA 2 - PRODUKTET

4.5 BETONI DHE BETONI I ARMUAR

4.5.1 Kërkesat e rezistences

Rezistenca e betonit duhet te plotesoje kerkesat sipas projektit teknik per nderhyrjet strukturale ne godinat ekzistuese dhe ndertimin e lementeve apo strukturat e reja.
Referuar projektit teknik struktural klasa e betonit e kerkuar eshte C30/37.
Per punimet e tjera si shtresa, mbushje punime jo strukturale kerkesat per punime betoni i referohen tabelave te seksionit 1.6.

4.5.2 Cilësitë e betonit

Të përgjithshme

Betoni duhet te plotesoje testet e rezistences per mostrat standarte kubike me brinje 15cm ose cilindrike me lartesi 30cm dhe diameter 15cm pas 28 ditesh i trajtuar ne kushte temperature dhe lageshtie standarte.

Betoni i gatshëm

Sipas DIN EN 206-1. Betoni i gatshëm është përcaktuar në specifikime si beton i prodhuar nga ndërmarrje tregtare dhe të dërguara tek blerësi në gjendje plastike. Betoni i gatshëm duhet përdorur nëse:
Fabrika ka kapacitete të mjaftueshme dhe pajisje transportimi për të dërguar betonin në normën e dëshiruar.
Intervali ndërmjet ngarkesave për zbrazje nuk i kalon 30 minuta.
Koha e shkuar ndërmjet hedhjes së ujit ne përpërzierje me çimenton dhe agregatet, ose çimentos me përbërësit, dhe vendosjes së betonit në pozicionin përfundimtar në forma, nuk duhet të kalojë me shume se një orë.
Betoni i gatshëm duhet të përzihet dhe dërgohet sipas një nga mënyrat e mëposhtme:

Përzierje qendrore

Përzierja qendrore duhet bërë duke përzier betonin plotësisht në një mikser të palëvizshëm në fabrikë dhe betoni i përzier të transportohet në vendndodhjen e punës me një betoniere ose me një mjet përzierës që punon gjte transportit.

Përzierje tranzite

Përzierja transite duhet bërë në një betoniere. Përzierësit dhe tundësit duhen drejtuar brenda limiteve të kapacitetit dhe shpejtësisë së rrotullimit të përcaktuar nga prodhuesi, dhe duhet të jenë të aftë të prodhojnë një përzierje homogjenë dhe me ngjyrë uniforme.

Çimento

Ne pergjithesi duhet të jetë çimento Portland, nëse nuk është percaktuar ndryshe. Çimento Portland duhet të jetë në përputhje me (DIN 1164) ose (EN-2). Kontraktuesi është i detyruar që

për çdo ngarkesë çimentoje të sjellë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standardeve.

Uji

Uji duhet të jetë i freskët, i pastër jo agresiv ndaj perberesve te betonit. Uji qe do te perdoret ne prodhimin e betonit duhet te jete i paster nga substancat qe demtojne ate si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe subtsanca te tjera organike. Ne pergjithesi, uji i tubacioneve te furnizimit te popullsise (uji i pishem) rekomandohet per perdorim ne prodhimin e betonit.

Agregatet

Agregatet për betonin duhet të jenë në përputhje me standardet ISO apo standarde të barasvlefshme. Klasa duhet jetë e tillë që të prodhojë beton me përmasa dhe dendësi te caktuar sipas kerkesave te projektit dhe që të jetë i gatshem per tu perdorur. Madhesia e agregateve te holle dhe te trashe percaktohet ne varesi te klases se perzgjedhur te betonit. Per rastein e betonit te kerkuar ne projekt nuk duhet te kaloje madhesine 22mm.

4.5.3 Depozitimi i materialeve

Depozitimi i materialeve qe do te perdoren per prodhimin e betonit duhet te plotesoje kushtet e meposhtme:
çimentoja dhe perberesit duhet te depozitohen ne ate menyre qe te ruhen nga perzierja me materiale te tjera, te cilat nuk jane te pershtatshme per prodhimin e betonit dhe e demtojne cilesine e tij.
çimentoja duhet te depozitohet ne ambjente pa lageshtire dhe qe nuk lejojne lagien e saj nga uji dhe shirat.
Aditivet
Përzierësit shtese për betonin duhet të jenë sipas DIN EN 206-1. Suplementet shtese per përzierje duhet të jenë nga i njëjti prodhues i përzierësve shtese, ose duhet të jenë certifikuar për të qenë të pajtueshëm me të githë elementet perberes te betonit per te arritur rezistencat e kerkuara.

4.5.4 Armatura

Sipas ENV 10080 armatura duhet të jetë çelik i vjaskuar me rezistence 500 N/mm² dhe me diametër minimumi 6mm. (BSt 500 S gjermane sipas DIN 488).
Karakteristikat dhe perberja e celikut te armatures per strukturat betonarme duhet te kontrollohen paraprakisht sipas certifikates se prodhimit.
Testet e provave ne terheqje dhe perkulje duhet te realizohen paraprakisht per te kontrolluar cilesine e celikut e krahasuar me certifikaten e prodhimit.

PJESA 3 - ZBATIMI

4.6 KALLEPET

Kallepet realizohen prej druri ose ne raste te vecanta metalike.
Duhet te kushtohet kujdes ne percaktimin dhe projektimin e elementeve te kallepeve sipas pozicionit. Kallepet standart per realizimin e strukturave jane elementet me gjatesi 0.9, 2.70m etj. per elementet vertikale te brendshem dhe te jashtem.
Perforcusesit e kallepeve duhet te pozicionohen dhe te percaktohen lidhjet midis tyre sipas standarteve evropiane ne lidhje universale ose jo universale, cepat e brendshem dhe te jashtem me permasa minimale 0.3m, pajantimet dhe konsolat.

Kallepet duhet te jene në vijë të drejtë dhe te niveluara. Para derdhjes së betonit, kallepet të lyhen ne sipërfaqet e kontaktit të formave me një përbërës që formon një shtresë e cila siguron heqjen e kallepeve pa demtuar betonin. Betoni për themelet dhe kolonat fundore mund të vendoset në gërmime pa kallepe, pas inspektimeve dhe miratimit të Mbikëqyrësit. Gjerësia e gërmimit do të jetë një minimum prej 30cm më e madhe se permasimi i kallepeve.
Kontraktori duhet të jetë përgjegjës për projektimin e kallëpeve dhe duhet të furnizojë dhe të rregullojë të gjithë kallëpet, bashkë me skelat shoqëruese, lëndë druri, mbështetjen, përforcimin, etj., që kërkohen për vendosjen e betonit. Gjate perdorimit te skelerise se drurit, sipërfaqja e kallëpit, kur vjen në kontakt me betonin e njomë duhet bërë me dru të vjetruar në mënyrën e duhur, me trashësi të mjaftueshme që ti rezistojë betonit të njomë ndërkohë që ai vendoset dhe derdhet, pa asnjë keqformim.

4.7 ARMATURA

Armatura duhet të pozicionohet në kallepe dhe të vendoset ne menyre qe te krijoje mundesine e realizimit te shtreses mbrojtese te betonit.

Shufrat e armatures do te mbeshteten ne distancatore metalike. Për soletat ne nivelin e mbeshtetjes ne toke shufrat ose rrjeta metalike duhet të mbështetet mbi blloqe betoni të parafabrikuar, të vendosura në intervale të kërkuar nga madhësia e armatures që do të përdoret, për të ruajtur armaturen dhe per te realizuar shtresen mbrojtese në lartësinë minimale te specifikuar mbi nënshtresën e themeleve. Armatura duhet të pozicionohet duke përdorur tela lidhës dhe duhet të vendoset në mënyrë të sigurt dhe të lidhet në çdo bashkim me tela bari me diametër 1,6mm. Fundet e telave lidhës duhet të jenë larg formës. Saldimi i shufrave të kryqëzuara nuk do të lejohet por vetëm nëse nuk autorizohet në mënyrë specifike nga Mbikëqyrësi.

4.8 ANKORIMI I ARMATURES

Ankorimi i armatures duhet të jetë 40_50 here diametrin e shufres nëse nuk ka një përcaktim ndryshe ne projekt.
Sipas ENV 10080 armatura duhet të jetë çelik i vjaskuar me rezistence 500 N/mm² dhe me diametër minimumi 6mm. (BSt 500 S gjermane sipas DIN 488).

4.9 SHTRESA MBROJTESE E BETONIT

Minimumi i shtresës përforcuese të betonit duhet të jetë:

Themelet pllake dhe plinta	50mm
Elementet strukturale trare kolona	30mm
Soleta	20mm
Mure	25_ 30mm

Vendosja e Materialeve të Ndryshme Të vendosen dhe ankorohen në vend bulonat, "kemishat" e tubave, tuba dhe materialet te tjera para se të derdhet betoni. Të lidhen bulonat ankorues dhe të kontrollohet vendndodhja dhe lartësia.

4.10 BETONIMI

4.10.1 Betoni duhet të derdhet në mënyrë monolite.

Betoni i gatshem në betoniera ose makineri do të jetë i pranueshëm nëse permbushen kerkesat e

meposhtme:
Betoni i parapërgatitur qe vjen nga nyjet e betonit do të furnizohet nga prodhuesi me fatura dublikate në çdo dërgesë betoni për në kantier, një për Mbikëqyrësin dhe një për Kontraktorin.

Ne fatura shenohen: Lloji dhe klasa e çimentos ,Sasia e çimentos për metër kub të betonit Madhësia maksimale e përbërësve,Përmbajtja totale e ujit e shprehur me raportin Ujë/Çimento Identifikimi i Kamionit,Volumi i kamionit të betonit ,Koha e ngarkesës Betoni duhet te derdhet ne vend brenda 90 minutave të prodhimit nëse temperatura e ajrit është më pak se 30 gradë Celsius, të ulet koha e derdhjes ne vend në 60 minuta nëse temperatura e ajrit është më e lartë se 30 gradë Celsius. Uji shtesë mund të hidhet tek betoni nëse raporti maksimal ujë-çimento nuk kalohet.

Të mos derdhet betoni nëse:

a) kushtet atmosferike nuk jane te pershtatshme, ne rastet e temperaturave ekstreme te larta ose te ulta
b) në zona të pambuluara gjatë periudhes se reshjeve

Para se të derdhet betoni në vend, të hiqen papastërtitë, mbetjet e ndërtimit, uji, dëbora dhe akulli brenda kallepeve. Betoni nuk duhet të lejohet të bjerë i lirë nga sillosa, nese betonimi behet i tille, nga një lartësi më e madhe se 3m.
Rekomandohet qe prodhimi dhe hedhja e betonit ne objekt te mos realizohet ne kushte te veshtira atmosferike.
Të mundësohet betonimi deri ne 10 gradë Celsius si minimum i temperaturës se ambjentit gjate betonimit. Ndalohet prodhimi dhe hedhja e betonit ne rast se bie shi i rrembyeshem, pasi ndikon ne klasen e rezistences se betonit.
Ne rastet e temperaturave te ulta nen 4°C rekomandohet te mos kryhet betonimi por ne qofte se kjo eshte e domosdoshme, atehere duhte te merren masa qe gjate proçesit te prodhimit te betonit, te shtohet solucioni ndaj ngricave ne masen e nevojshme qe rekomandohet nga prodhuesi i solucionit.
Prodhimi dhe perpunimi i betonit ne temperatura te larta mund te ndikoje negativisht ne procesin e ngurtesimit te betonit.
Të mundësohet temperatura 32 gradë Celsius si temperaturë maksimale motit gjate betonimit.
Trajtimi i betonit te fresket
Trajtimi i betonit ne veper fillon ne momentin qe betoni hidhet nga betonpompa ose sillosi me vibrimin ne pozicione te vibratorit qe rrezja e mbulimit te mbivendoset ne zonat e trajtuara te struktures.
Betoni duhet të trajtohet gjatë hedhjes ne veper në mënyrë që të krijojnë kushte per ngurtesim pa te plasura per efekt te tkurrjes se hershme te betonit. Per kete, gjate fillimit te ngurtesimit e ne vazhdim betoni i fresket duhet te laget ne menyre qe reaksionet kimike te ngurtesimit te zhvillohen ne prezencen e ujit dhe nxehtesia qe ato clirojne gjate ngurtesimit te betonit te mos krijoje fenomenin e gjakrrjedhes se betonit te shoqeruar me plasaritje qe ne fazen e hershme te jetes se tij.
Betoni i freskët nuk duhet të ekspozohet ndaj goditjeve, dridhjeve dhe temperaturave shume te ulta ose te larta.
Menjëherë pas vendosjes, shtresat e betonit duhet të vibrohen duke përdorur vibratorë të brendshëm betoni të mundësuar dhe të lëvizshëm me dore, shufra dhe ngjeshje. Goditjet nga jashtë ose forma të tjera të lëkundjes nga jashtë të formave nuk lejohen. Vibratorët nuk duhet të përdoren për të transportuar betonin brenda formave.
Vibratorët e brendshëm të zhytur në beton duhet të ruajnë një frekuencë minimale prej jo më pak se 8000 lëkundjesh në minutë. Zgjatja e lëkundjeve do të jetë nga 5 deri në 15 sekonda.
Vibratorët duhet të aplikohen në pikat e baraslarguara prej 45cm te vendosur ne forme shahu.
Nëse fugat janë të nevojshme, pozicioni i tyre duhet te diskutohet me Mbikëqyrësin.

Pas betonimit te mundësohet aplikimi i vazhdueshëm dhe i njëtrajtshëm i spërkatjes me ujë në të gjithë periudhën e trajtimit. Trajtimi duhet të jetë aplikimi i drejt për drejtë i ujit.
Të përmbytet sipërfaqja me ujë pasi betoni të jetë forcuar mjaftueshëm në mënyrë që të mos dëmtohet siperfaqja e elementeve. Të aplikohet spërkatja me ujë për një minimum prej dy ose tre herë në ditë dhe aq herë sa diktojnë kushtet atmosferike të ambientit dhe të lejohet trajtimi i betonit me këtë metodë për nje periudhë minimale shtatë ditore.

Defektet

Të riparohen siperfaqet pas hejes se kallepeve duke shmangur gërryerjet dhe gropëzat, më të mëdha se 2cm2 ose 6mm në thellësi, ose zona të tjera të tilla të zbuluara. Të realizohen cepat pingul me sipërfaqen dhe të riparohen me llac cimento qe nuk tkurret. Të riparohen brimat e lidhjeve dhe defekte kur hiqen kallepet. Deformimet nuk duhet të ndryshojnë më shumë se tolerancat e lejueshme që janë përcaktuar. Sipërfaqet e ekspozuara duhet të jenë të njëtrajtshme.

Trajtimi dhe ruajtja

Të ruhet betoni nga veprimi dëmtues i diellit, shiut, ujit që rrjedh, ngricave, dëmtimeve mekanike, shenjave të gomave dhe njollave të vajit.
Kallepet mund të hiqen deri 48 orë pas derdhjes së betonit.
Të parandalohet trafiku më këmbë ose me makina me makineri gërryese për jo më pak se 72 orë pasi të kenë përfunduar betonimi.
Kontrolli i cilesise se betonimit, testimi i betonit
Kontraktori duhet të bëjë marrëveshjet e nevojshme për testimin e betonit të forcuar dhe të freskët në përputhje me dispozitat e EN 206 dhe duhet të furnizojë me gjithë aparateturat, fuqinë punëtore, materialet dhe transportin e nevojshëm.
Të realizohen kampionet e betonit të freskët ne forma kubike standarte për të kryer testet e rezistences se betonit.

Te kontrollohet konsistenca e betonit para hedhjes ne veper.
Testet e konsistences se betonit duhet te kryhen:

a) Ne fillimin e hedhjes së betonit,
b) Kur pergatiten mostrat e testimit
c) Për çdo grup ose çdo 10m^3 beton.

Të bëhen një minimum prej pesë kubesh për testim me përmasat 150/150/150mm për testimin ne shtypje te betonit. Mostrat duhet te jene te zhytura ne uje. Të testohen kubat fillimisht pas 8 ditësh dhe të rruhen kuba rezervë.
Kubat e betonit për testet e shtypjes duhet te merren jo më pak se njëherë për cdo 30 m^3 betoni. Jo më shumë se 10% të kubave të testuar lejohet te tregojnë se betoni i derdhur nuk përmbush kërkesat për specifikim ose aty ku është faktuar se cilësia është nën kerkesat e duhura duhet te raportohet. Kosto e testeve të tilla duhet të mbartet nga Kontraktori.
Betoni duhet te plotesoje kerkesat per rezistencen e nese kjo nuk duhet te zevendesohet me beton të ri pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues.

Rezultatet e Testeve

Të paraqiten rezultatet e testeve si pjesë e "Raportimeve Ditore të Mbikëqyrësit" përveç se rezultati i Testeve në shtypje duhet të raportohet.

4.10.2 Heqja e kallepeve

Kallepet nuk duhet të hiqen para se betoni të jete ngurtesuar mjaftueshëm për të mbajtur peshën e vet dhe ndonjë ngarkesë tjeter që vendoset mbi të. Ky kusht duhet kerkon që kallepet të qëndrojnë në vend, pas hedhjes së betonit si me poshte.
Alikimi i "eproxy resina" per lidhjen e betonit te vjeter me betonin e ri
Eproxy resina eshte materiali kimik qe mundeson lidhjen e betonit të ri me atë ekzistues.

Sipërfaqja e kontaktit duhet të ashpersohët. Duhet të hiqet pjesa sipërfaqesore e elementeve ekzistues. Sipërfaqja e kontaktit të betonit të ri, me atë ekzistues, lyhet me penel me "Eproxy resina". Lyerja duhet të jetë e kujdesshme dhe e njëtrajtshme. Nuk lejohet lënia e zonave pa lyer me lidhes. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për të mbushur mirë me lidhës zonat e poreve. Lyerja mund të bëhet edhe me sprucim, me anët e pajisjet e posaçme.

Pas lyerjes së sipërfaqes së kontaktit duhet që brenda disa minutave te percaktuara ne instruksionin e perdorimit, bëhet derdhja e betonit të ri.

Jashtë kohes se kerkuar nuk lejohet betonimi pasi lidhësi është mpiksur dhe ai jo vetëm që nuk ndihmon proçesin e lidhjes së betonit të ri me atë ekzistues, por e pengon atë.

4.10.3 Muratura

Muratura realizohet me tulla te plota per muret mbajtes dhe tulla me birra per muret ndares. Ne strukturat ekzistuese muratura ndarese do te realizohet me mure gipsi per te lehtesuar ngarkesen e strukturave.

Specifikimi per tullat

Tulla si element i ndertimit duhet te plotesoje kushtet e meposhtme per ndertimet antisizmike:

- Rezistenca ne shtypje duhet te jete: per tulle te plote 75kg/cm²; per tulle me vrima 80kg/cm
- Rezistenca ne prerje e cila duhet te jete per te gjitha tullat me vrima 20kg/cm².
- Perqindja e boshlleqeve e cila duhet te jete: per tullen e plote 0-25%; per te gjitha tullat me vrima 25-45%.
- Trashesia e pareteve perimetrale dhe te brendshem per tullat e plota te mos jete me e vogel se 20mm dhe per te gjitha tullat me vrima, trashesia e pareteve perimetrale te mos jete me e vogel se 15mm dhe e pareteve te brendshem jo me e vogel se 9mm.
- Siperfaqja e nje vrime te mos jete me e madhe se 4.5cm².
- Ujethithja ne perqindje duhet te jete nga 5-20%. Specifikimi per llacin e muratures

4.10.4 Tipet e llaçeve

Llaçi per muret per 1m³ llaç realizohen me keto perberje:

- Llaç bastard me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me rere ne raporte 1:0.8:8. Gelqere e shuar ne 110lt, çimento 300, 150 kg, rere 1.29m³.
- Llaç bastard marka 25 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.5:5.5. Gelqere e shuar ne 92lt, çimento 300, 212 kg, rere 1.22m³.
- Llaç bastard marka 15 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.8:8. Gelqere e shuar ne 105lt, çimento 300, 144 kg, rere 1.03m³.
- Llaç bastard marka 25 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento: gelqere: rere ne raporte 1:0.5:5.5. Gelqere e shuar ne 87lt, çimento 300, 206 kg, rere 1.01m³.
- Llaç-çimento marka 1:2 me rere te lare e formuar me çimento, rere ne raport 1:2 cimento 400, 527kg, rere 0.89kg.

Specifikimi per muraturen

Mur me tulla te plota 25cm / 40 cm / 55 cm
Muratura me tulla te plota mbajtese ne lartesi deri 3m, realizohet me llaç bastard
M-25 sipas receptures te sipermendur me permbajtje per m^3: tulla te plota, llaç bastard 0.25 m^3, çimento 400 dhe uje per çdo trashesi muri duke perfshire çdo detaj dhe kerkese per qoshet, parmaket, skelat e sherbimit, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj. Per muraturen e katit perdhe, siperfaqja e xokolit duhet te jete e niveluar me nje shtrese llaç çimento 1:2 me trashesi jo me te vogel se 2cm.

Mur me tulla te lehtesuara
Murature me tulla te lehtesuara ne lartesi deri 3m, realizohen me llaç bastard M-25 me permbajtje per m^3: tulla te lehtesuara, llaç bastard 0.29 m^3, çimento 400 dhe uje per çdo trashesi duke perfshire çdo detaj dhe kerkese per dhembet e lidhjes, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit ose skelerine, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj. Per muraturen e katit perdhe siperfaqja e xokolatures duhet te jete e niveluar me nje shtrese llaç çimento 1:2 me trashesi jo me te vogel se 2cm.

Mur ndares 12cm
Murature me tulle te plota me trashesi 12cm dhe llaç bastard m-25 me permbajtje per m^3: tulla te plota, llaç bastard 0.19m^3, çimento 400 dhe uje

4.10.5 Strukturat metalike

Prodhimi i çelikut duhet te jete bere nga kompani te liçensuara qe duhet te garantojne cilesine si dhe te dhenat e tjera te celikut (perberja kimike, karakteristikat fizikomekanike,etj) .
Celiku qe perdoret per konstruksionet mbajtese duhet t'u pergjigjet kerkesave te standarteve dhe kushteve teknike dhe te kete garanci persa i perket kufirit te rrjedhshmerise dhe permbajtjes maksimale te squfurit dhe fosforit; kurse per konstruksionet e salduara ka kerkesa per permbajtjen maksimale te karbonit.
Prerja, saldimi si dhe lidhje e elementeve prej çeliku behet ne kanierin e firmes kontraktuese dhe ata transportohen ne kantier ose keto punime mund te behen ne vendin e punes (ne objekt).
Sidoqofte, duhet qe punimet para montimit te elementeve te kontrollohen nga supervizori dhe duhet te protokollohen.
Pergatitja per saldim perfshin ate qe detajet para se te saldohen, te kene marre formen e tyre perfundimtare. Po ashtu, buzet dhe siperfaqet e pjeseve qe do te saldohen duhet te pergatiten sipas kerkesave te proçedures se saldimit dhe formave qe jepen ne pasqyrat 6, 7, 8 te KTZ 206-80 ose ne normat perkatese europiane.
Pas saldimit, detajet duhet te trajtohen termikisht per te zvogeluar nderjet e brendshme, per te menjanuar te plasurat dhe per te permisuar vetite fizikomekanike. Gjate zbatimit te punimeve per saldimin e çeliqeve duhet te mbahet dokumentacioni teknik me te dhena per çertifikaten e materialeve te perdorura, ditarin e punimeve, etj.
Lidhja me bullona
Elementet prej çeliku mund te lidhen/bashkohen edhe me ane te bulonave.
Lidhja me bulona duhet t'u pergjigjet normave dhe standardeve bashkohore (EC3 ose ndonje standardi ekuivalent).
Kualiteti i bulonave luan gjithashtu nje rol te rendesishem dhe keto te fundit po ashtu, duhet t'u pergjigjen normave te siperpermendura. Eshte me rendesi qe bulonat t'i plotesojne kushtet e rezistences se llogaritjes te bashkimeve me bulona. Lloji i gjendjes se tensionuar dhe grupi i bashkimit, te cilat duhet te permbushin kushtet e nevojshme te kerkuara nga normat/ standardet

per:

- Terheqja
- Prerja
- Shtypja

Gjate zbatimit te punimeve per lidhjen me bulona te çeliqeve duhet te mbahet dokumentacioni teknik me te dhena per çertifikatat e materialeve te perdorura, ditarin e punimeve, etj.

Ngritja

Ngritja e elementeve prej çeliku behet sipas planeve te pergatitura nga arkitekti/ inxhinieri. Inxhinieri duhet te supervizoje punen e ngritjes se elementeve metalike ose konstruksioneve metalike.

Mbrojtja nga agjentet atmosferike Mbrojtja e çelikut behet ne dy menyra:

Duke e lyer çelikun me disa shtresa, te cilat e mbrojne ate prej korrozionit. Kjo behet duke e lyer, zhytur ose sperkatur me shtresa. Njera shtrese eshte baza, kurse shtresa tjeter perdoret edhe si dekorim i elementit dhe mund te kete ngjyra te ndryshme. Siperfaqet ne te cilat do te vendosen keto shtresa, duhet qe me pare te perpunohen dhe te jene te lira nga vaji, pluhuri apo ndryshku.

Shtrese prej metali. Kjo mbrojtje eshte e perhershme. çeliku duhet zhytet ne zink te nxehte (450°C) dhe siperfaqja e tij te jete e lire prej pluhurit, vajit si dhe ndryshkut. Permbi te, mund vendoset ndonje shtrese tjeter si dekorim i elementit prej çeliku.

Ndalohet rreptesisht lyerja e çeliqeve per betonim me vajra.

4.10.6 Punimet e ndertimit

Punimet e ndertimit qe do te kryhen duhet te monitorohen nga Mbikqyresi i punimeve. Konkretisht duhet te monitorohen punimet e meposhtme:

- Prishja dhe ndertimi i mureve ne godinen ekzistuese.
- Realizimi i arkitrareve ne muret mbajtese qe mundesojne hapjen e carjeve per te realizuar skemen e shfrytezimit te spitalit. Ne projekt jane dhene dy mundesi per realizimin e tyre si arkitare metalike dhe arkitrare betonarme te parapergatitur. Kontraktori mund te perdore secilin tip. Arkitraret metalike jane me te lehte per montim dhe vendosje por duhet te realizohen e te kontrollohen me rigorozitet nga inxhinieri i kantjerit dhe Mbikqyresi i punimeve.
- Ndertimi i maternitetit te ri. Struktura eshte realizuar prej betoni te armuar.
- Ambjentet teknike realizohen me struktura betonarme.
- Soleta e ambjenteve teknike te gazit medikal realizohet me konstruksion me trare metalike dhe betonarme.
- Ura lidhese midis ambjenteve me strukture metalike.
- Realizimi i struktures se ashensorit panoramik.
- Te gjitha punimet e permendura jane punime thelbesore qe lidhen me strukturen mbajtese te secilit objekt konkret. Monitorimi nga ana e inxhinierit te zbatimit dhe Mbikqyresit te punimeve duhet te kryhet ne kerkesa te forta te zbatimit te projektit dhe kushteve teknike.

4.11 MAKINERI DHE PAISJE

Për shkak se objekti është strukturë spitalore në funksion, dhe një pjesë e repartit të urgjencës do të vazhdojë aktivitetin gjatë punimeve, të gjitha pajisjet që do të përdoren për këtë proces pune duhet të plotësojnë këto kërkesa teknike:

1. Makineritë e Përgatitjes dhe Transportit

Betonieret (Auto-betonieret): Për transportin e betonit të lëngshëm nga fabrika në kantier.

Pompat e Betonit: Nëse objekti ka distancë nga rruga ose është në lartësi, përdoren pompa statike ose auto-pompa (me krah) për të dërguar betonin saktësisht te kallepet.

Betoniere kantieri 0.25m3 elektrike per prodhimin e sasirave te vogela te betonit ne kantier.

2. Sistemet e Kallepave (Formwork)

Për të krijuar formën "U" muret e strehës, nevojiten:

Kallepe Metalike ose Panela Druri (Doka): Për të mbajtur betonin deri në tharje.

Skelat dhe Mbështetëset (Pop-shits): Për të siguruar që kallepet të mos lëvizin nga pesha e betonit.

3. Makineritë e Ngjeshjes (Vibratorët)

Ky është hapi më kritik për të shmangur vrimat e ajrit në beton.

Vibratorët thellesie me korent : Janë sonda që futen brenda betonit të freskët për ta ngjeshur atë.

Vibratorët Sipërfaqësorë: Përdoren për pllakat e dyshemeve.

4. Makineritë e Nivelimi (Për dysheme të lëmuara)

Nëse mbi beton do të shtrohet më vonë PU Flooring (siç diskutuam), sipërfaqja duhet të jetë shumë e rrafshët.

Helikopterët e Betonit (Power Trowels): Përdoren kur betoni fillon të ngurtësohet për ta lëmuar sipërfaqen në maksimum. Ekzistojnë manualë (për hapësira të vogla si streha) dhe me operator sipër (për sipërfaqe të mëdha si hoteli).

Lazer Screed: Makineri të udhëhequra me lazer për nivelim perfekt të kuotave të dyshemesë.

5 PUNIMET STRUKTURA METALIKE
PJESA I – E PËRGJITHSHME

5.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtyre specifikimeve në sasinë e marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë.
Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare
Normat dhe Standardet Evropiane
DIN V ENV 1993 Përcaktimi i Strukturave Metalike
DIN EN 10025 Produktet e kthyera me të nxehtë të strukturave metalike

5.2 PARAQITJET

Paraqisni si më poshtë:

5.2.1 Vizatimet Teknike

Para se të ngrihen strukturat metalike paraqitni vizatimet teknike për miratim. Riprodhimet e skicave të kontratave si vizatime teknike nuk janë të pranueshme.

Mundësoni, llojin, shkallën, përmasat dhe detajet e trarëve dhe arkitrarëve horizontalë, duke përfshirë përforcimin, aksesorët dhe ankorimet. Për më tepër mundësoni diagramet e mbledhjeve, prerjet dhe format e llojet e hekurave. Të mos shkallëzohen dimensionet nga vizatimet strukturore për të përcaktuar gjatësitë e hekurave përforcues.

5.2.2 Certifikatat e Përputhshmërisë

Paraqitni certifikimet e mëposhtme të prodhuesit:
Punimet e Çelikut Dadot dhe vidat
Materiali i Lyerjes së Sipërfaqes Elektrodat dhe

5.2.3 Kontrolli i Cilësisë

Inspektorët e saldimeve duhet të jenë të certifikuar nga Standardet e duhura Shqiptare ose baraz vlefta e tyre në normat e BE në bazë të miratimit nga Mbikëqyrës ose përfaqësues te tij.

- Te kryhet inspektimin dhe testimi i prerjeve të vëna nga prodhuesi në se seksionet e çelikut në vendndodhje të ndryshme.
- Testime jo shkatërruese të lidhjeve me saldim:

Te kryhen testime jo shkatërruese të lidhjeve me saldim si më poshtë:

- 1.10% të lidhjeve të momentit që përshijnë saldimet filetë, me inspektime magnetike.
- Të gjitha lidhjet e momentit dhe të gjitha lidhjet nën presion të drejt për drejtë duke përdorur saldimet me depërtim të thellë, nëpërmjet testimeve me ultrasaund.
- Kur momentet transferohen ose me saldime filetë ose me ato me depërtim në pllakat fundore në bashkimet "T", “U” dhe “L”, të shikohet metali bazë për çarjet laminarie ose me thyerje, me testime me ultrasaund.
- Për instalimin e tolerancave duhet të aplikohen standardet Shqiptare dhe ato të BE.

PJESA 2 - PRODUKTET

5.3 MATERIALET E ÇELIKUT

- Materialet e reja duhet të jepen në përputhje me standardet e referuara, të fuqisë dhe cilësisë së shënuar në skicat strukturore.
- Kanalet e formuara me të ftohte:
- Të prodhohen në bazë të normave Shqiptare dhe atyre të BE.
- Bulonat ankorues: në standardet Shqiptare dhe normat e BE.
- Kunjat e salduar për pllakat e vendosura duhet të jenë në përputhje me standardet Shqiptare dhe Normat e BE.
- Kontraktori duhet të sigurojëpërputhshmëri për mbrojtjen ndaj zjarrit me spërkatje para se të aplikohet mbushësi.
- Bulonat e fuqishëm duhet të përdoren në bazë të kodeve Shqiptare dhe atyre të BE dhe gjithashtu në bazë të shënimeve në skica.

5.4 LYERJA

I gjithë çeliku strukturor duhet të jetë i galvanizuar në thellësi e nxehtësi siç tregohet kurdoherë në skica.

5.5 MBROJTJA NDAJ ZJARRIT

I gjithë çeliku strukturor duhet të jetë i mbrojtur ndaj zjarrit për të arritur gamën e mbrojtjes ndaj zjarri prej 1 ore. Metoda e mbrojtjes ndaj zjarrit duhet të jetë e përputhshme me atë përfundimtar të miratuar nga Mbikëqyrësi ose përfaqësuesi i tij.

- Çeliku Strukturor

Çeliku strukturor (për trarët, arkitrarët dhe trarët horizontal) duhet të përzgjidhet në bazë të EN 10025

DADOT, VIDAT DHE RONDELAT

Dadot EN 24014, EN 24016, EN 24017 dhe EN 24018

Vidat EN 24032, EN 24034, ISO 7413

Rondelat ISO 7089, ISO 7090, ISO 7091

GALVANIZIMI: Galvanizimi pas prodhimit duke përdorur një shtresë zinku me spërkatje termale (metalizimi)

PJESA 3 - ZBATIMI

5.6 INSTALIMI

Pas pozicionimit fundor të pjesëve të çelikut, të mundësohet mbështetja fundore të trarëve të çelikut, të mundësohet mbështetje e plotë nën pllakat baze dhe ato fundore duke përdorur fino që nuk shtypet. Të vendoset nën çelikun strukturor siç tregohet në skica një lloj spesor i miratuar, i cili i ka dimensionet në skica. Pas pozicionimit përfundimtar të shtyllave të çelikut, të mundësohet mbështetje e plotë nën bazament dhe pllakat bazë duke përdorur fino e cila nuk shtypet. Të vendoset fino e cila nuk shtypet në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

5.7 LIDHJET

Të mos shtrëngohen bulonat ankorues të vendosur në beton me trapan. Të shtypen, ose shtrembërohen ose të shpohen brima për bulonat. Bulonat, dadot, dhe rondelat duhet të jenë të pastra dhe të lubrifikohen menjëherë para instalimit.

5.7.1 BULONAT

Bulonat duhet të shtrëngohen deri sa të jenë “shtrënguar mjaft". "Shtrënguar mjaft" është shtrëngimi i cili ekziston kur elementët në një bashkim janë tërësisht në kontakt. Nëse kontakti i sigurt i nyjave dhe pllakave nuk mund të arrihet me disa shtrëngime e rrotullime të çelësave, ose me përpjekje e plotë të një punëtori i cili përdor veglat për shtrëngim, të kontaktohet Mbikëqyrësi për udhëzime të mëtejshme.
Të testohen një minimum prej 3 lidhjesh bulona vidë dhe rondele.

5.8 SALDIMI

Të përdoret saldimi me hark dhe me çelik me elektrodë me pak hidrogjen. Të mos lehtesohet tensioni nga saldimet e ekspozuara por të pastrohen siç tregohet. Të mundësohen saldatorë me eksperiencë, e operatorë saldatricesh. Heqja e saldimeve të përkohshme, pjatave të cilat kalojnë saldimin dhe rripat mbështetës e testet e tyre duhet të përzgjidhen nga Mbikëqyrësi. Nëse më shumë se 20% i saldimeve të bëra nga një saldator përmbajnë defekte të treguara nga testimet, atëherë të gjitha saldimet e kryera nga ai saldator duhet të testohen nga testimet ultrasonike ose radiografike në bazë të miratimit të Mbikëqyrësit.

5.9 MAKINERI DHE PAISJE

Për shkak se objekti është strukturë spitalore në funksion, dhe një pjesë e repartit të urgjencës do të vazhdojë aktivitetin gjatë punimeve, të gjitha pajisjet që do të përdoren për këtë proces pune duhet të plotësojnë këto kërkesa teknike:

1. Prerja dhe Përgatitja e Materialit

Përpara se të montohet struktura, profilet metalike (tubat katrorë, dekabet, ose traversat) duhet të priten me saktësi:
Sharrë Shirit (Band Saw): Për prerjen e profileve të rënda metalike në kënde të sakta.
Prerëset me Plazma ose Lazer: Ideale për prerjen e llamarinës së kuqe (sheet metal) sipas formave të kërkuara për veshje ose detaje dekorative.
Makinat Shpuese (Magnetic Drills): Për hapjen e vrimave ku do të vendosen bulonat e montimit.
2. Makineritë e Saldimit (Bashkimi Strukturor)
Saldimi strukturor kërkon fuqi dhe qëndrueshmëri të lartë:
Saldimi MIG/MAG (GMAW): Më i përdoruri në industri për strukturat metalike. Përdor një tel që furnizohet automatikisht dhe gaz mbrojtës. Është shumë i shpejtë dhe efikas.
Saldimi me Elektroda (SMAW/Stick): Ideale për punime në kantier (jashtë), pasi nuk ndikohet nga era dhe është shumë i fuqishëm për trashësi të mëdha.
Saldimi TIG (GTAW): Përdoret për saldime shumë precize dhe estetike, sidomos në metale si inoksi apo alumini.
2. Montimi në Kantier
Vinçat dhe Eskavatorët me krah teleskopik: Për ngritjen e trarëve dhe kolonave në vendin e caktuar.

6 ASHENSORËT

PJESA I – E PËRGJITHSHME

6.1 REFERENCAT

Ligjet dhe normat e aplikueshme Shqiptare

Ashensorët që do të vendosen duhen të kenë specifikat e mëposhtme:
- Të jenë të çertifikuar sipas standartit europian EN 81-20/50
- Sistemi i levizjes : Elektrik (Elektromekanik)
- Vendosja e motorit : Mbi shina , brenda kafazi
- Peshembajtja : Jo me pak se 450 kg
- Kapaciteti : Jo me pak se 6 persona
- Kabina : Material inoks, ndriçimi led i bardhe dhe me aspirim
- Hapja/mbyllja e dyerve + kat automatik teleskopik
- Komandimi i levizjes: Me butona
- Ndalesa: Rregjistrim ne varesi te kateve te nderteses
- Gjendja e ashensorëve të rinj

Kërkesa të tjera

Në momentin e dorezimit, ashensorët të jenë të pajisur me:
- Çertifikatë e regjistrimit të ashensorit nga ISHMT , me shpenzimet e subjektit ofertues.
- Garancia 5 vjet.
- Mirëmbajtja 6 muaj
- Ashensori të përmbushin normat dhe standartet e CE & (standartit europian EN 81-20/50).

PJESA 2 - PRODUKTET

6.2 PËRBËJNË ASHENSORIN ELEKTRIK

6.2.1 Kabina

Është pjesa në të cilën vendosen njerëzit dhe mallrat gjatë lëvizjes vertikale. Është e përbërë nga korniza, në të cilën janë të vendosura muret e kabinës, anash janë të vendosur sistemi i udhëzuesve dhe kapësve të sigurisë, nën të apo anash saj është sistemi i lidhjes me litarët bartës dhe sistemi i kontrollit të shpejtësisë dhe ndërprerësi.

Paneli komandimit te ashensorit
- Fuqia e menaxhuar: 4 - 20 KW,
- shpejtesia max: deri ne 3 m/s,
- ngasja: me inverter VVVF me qark te mbyllur,
- funksionimi: kolektiv, simplex, dupleks ose multipleks ,
- lidhje seriale,
- pajisje emergente per thimin ne dysheme me rihapje i dyerve,
- funksionimi manual elektrik nga paneli,
- ndalimet: deri ne 13 kate ,
- hyrjet: deri ne 1 dere,
- motori i dyerve: 230Vac njefazor,

- sinjalizimi i pozicionit dhjetor me paralel pozitiv te perbashket (12Vdc),ABCD,
- Qarku komutues 48 Vdc,
- sipas standartot EN 81-20/50,
- kursim energjie: fikja e inverterit pas nj kohe te programueshme pasiviteti,
- Emergence ne rastetin e shkeputjes se esnergjis elektrike,
- Sistemi i manovres se ngecjes se personave i aksesueshem nga paneli,
- Sistemi telefonit i lidhur me GSM ne raste emergences,
- Sistemi i kontrollit te kuaderit i lidhur online (kusht te ket internet te aksesueshem).

6.2.2 Butonat e gabines

Butoniere e brendeshme komandues prej pllake inox e palosur me permasa: min 300 x 2000 mm (trashësia 1,5 mm) e paisur me drite emergjence, sistem GSM ne rast emergjence, sistem vokal dhe butona antivandal, butonat komandues me shënim të kateve, butoni alarm, butoni për hapjen e derës, butoni për mbylljen e derës, butoni për komunikim apo telefoni, butoni për mbingarkesë, dorëzat, ndricim led, ventilator.

Kabina e Ashensorit
Kabina duhet të lëvizë në mënyrë komode, pa lëkundje, pa frenime të ashpra dhe pa nisje të ashpra, që mund të shkaktojnë shqetësime të udhëtarët. Kabina duhet të këtë ndriçim të mjaftueshëm. Kabina është e ndërtuar nga profili i çelikut për varje 1:1 më pajisje frenues. Në kornizë të kabinës janë të vendosura 4 papuçe rrëshqitëse më pajisjen për lyerje automatike. Në pajisjen frenuese është i vendosur ndërprerësi sigurues automatik. Pajisja kapëse frenuese është e atestuar dhe testi është i dërguar më pajisje. Në kuadër të pajisjes gjendet ndërprerësi elektrik i cili në raste të çrregullimeve (avarive) të ndryshme jep urdhër për ndalje të elektromotorit. Në kulmin e kabinës është kutia drejtuese për levizje në të dy drejtimet më ndërprerës "STOP" dhe prizën dypolare më kontakt të mbrojtur. Anët anësore të kabinës së ashensorit janë të kufizuara me anësore të cilat janë në tërë gjatësinë dhe janë të plota.
Saktësia e qëndrimit të kabinës duhet të jetë maksimalisht 5 [mm], pa marrë parasysh ngarkesën.

6.2.3 Tavani i kabinës së ashensorit

Sipas Standardit EN81-20/50, tavani i kabinës është me qëndrueshmëri të mjaftueshme që të mbajë
peshën e personit gjatë mirëmbajtjes - për 1000 [N] në një sipërfaqe prej 0.20x0.20 [m], pa deformim të përhershëm. Varësisht prej rëndësisë së ashensorit, në tavanin e kabinës, duhet të bëhet hapja për dalje emergjente për rastet e jashtëzakonshme.
Kulmi i kabinës së ashensorit është më qëndrueshmëri të mjaftueshme dhe pa kurrfarë rreziku e mban peshën e personit i cili e kontrollon dhe mirëmban ashensorin. Është i llogaritur ashtu që të mban rënien e një pjese, vegle apo ngjashëm gjegjësisht ngarkesën më ngarkesë më së paku 3 [kN]. Në kulmin e kabinës është vendosur rrethoja mbrojtëse.
Te ashensorët e udhëtarëve, sipas rregullave në kabinë duhet të vendoset pasqyra.
Funksioni i pasqyrës është më tepër psikologjik. Kabina nëpërmjet pasqyrës vizuelisht duket më e madhe, gjë që krijon ndjenjën pozitive për udhëtarë. Pasqyra mund të plotësoj një mur të tërë ose të vendoset vetëm në pjesën e sipërme të dorezës. Zgjidhja më e mirë është që pasqyra të mbuloj pjesën e sipërme nga doreza e deri në tavan.

6.2.4 Kutia komanduese

Kutia komanduese vendoset në afërsi të hyrjes ashtu që skaji i poshtëm të gjendet në lartësi prej 0.9 m, kurse i epërmi në lartësi deri 1.7 m mbi dysheme. Të ashensorët në të cilët është e mundshme edhe hyrja me karroca nga njerëzit me nevoja të veçanta, skaji i poshtëm i kutisë vendoset në lartësi prej 0.9 m, kurse i epërmi 1.2 m. Që kutitë komanduese të vendosen në këtë hapësirë ato rregullohen sikur dy rendore, tri dhe katër rendore.

Në murin e katit është vendos kutia komanduese elektrike e cila duhet te plotesoj normativat sipas

standarteve EN81/20 , En81/50, te kete sistem emergjence totale dhe te ket kontroll me lidhje online te sistemit. Dhoma e makinerisë se ashensorit duhet të jetë e ndritshme, e terur, zjarrduruese e izoluar mirë termikisht dhe nga zhurma. Humbjet e nxehtësisë së të gjitha pajisjeve në dhomën e makinerive mund të jenë 14000 [kJ/h].

Temperatura në dhomën e makinerisë nuk guxon të jetë më e vogël se +5 [oC], kurse në ngarkesat më të mëdha nuk guxon të tejkalon +40 [oC].

Pllaka bartëse në dhomën e makinerisë duhet të jetë e fortë dhe e llogaritur me të gjitha bingarkesat e ashensorit.

Në pllakën bartëse të dhomës së makinerive duhet të jenë hapësirat për litarë dhe instalimet elektrike.

Këto hapësira janë të rrethuara më korniza metalike më lartësi 50 [mm], si dhe më mbrojtës për mjete të punës dhe të tjera në kafaz.

Dera e dhomës duhet të jetë metalike dhe zjarrduruese për hapje nga jashtë, më bravë në qelës.

Gjerësia e pastër e derës duhet të jetë min.: 0,75 [m]

Lartësia e pastër e derës duhet të jetë min.: 1,80 [m]

Dhoma duhet të ketë ndriçim më intensitet minimale 200 [Lx] e matur në dysheme. Kutia komanduese është e pajisur më të gjithë ndërprerësit elektrik dhe pajisjet tjera përcjellëse drejtuese dhe komanduese.

Para kutisë komanduese duhet të sigurohet hapësirë më e madhe prej 0,7 [m].

Në dysheme në kutin komanduese duhet vendosur një tepih prej gome i atestuar për mbrojtje nga tensioni i rrezikshëm i prekjes.

6.2.5 Sinjalizimi.

Sinjalizimi në stacionin kryesor

- Treguesi matricor i pozitës së kabinës,
- Shigjeta drejtuese e drejtimit të vozitjes së mëtutjeshme, dhe
- Sinjali optik që vërteton pranimin e thirrjes.

Sinjalizimi në stacionet tjera

- Treguesi matricor i pozitës së kabinës,
- Shigjeta drejtuese e drejtimit të vozitjes së mëtutjeshme, dhe
- Sinjali optik që vërteton pranimin e thirrjes.

Sinjalizimi në kabinë

- Treguesi matricor i pozitës së kabinës,
- Sinjali optik që vërteton shtypjen e urdhëresës për vozitje,
- Treguesi optik i drejtimit të vozitjes,
- Alarmi sinjalizues më zë, dhe
- Drita emergjente.

6.2.6 Dhoma e makinerisë

Dhoma e makinerisë është e vendosur në pikën më të lartë të fundme të kafazit. Vendi i dhomës së makinerisë zakonisht përcaktohet ne lejen dhe ne projektin e ndërtimit.
Në këtë rast duhet të bëhet në vendin e përcaktuar nga projektuesi. Përndryshe duhet të realizohet një vizitë në objekt nga tekniku për të përcaktuar zgjidhjen me të mirë të mundshme për rastin tuaj. Në dhomë janë të vendosura pajisjet për ngasjen e ashensorit.
Pajisja ngasëse përbëhet nga:
- Elektromotori,
- Reduktori,
- Freni,
- Makaraja punuese,
- Makaraja drejtuese dhe
- Rregullatori i shpejtësisë.

Është e vendosur mbi kafaz. Dhoma e makinerisë duhet të jetë e ndriçuar më dritë elektrike dhe e
ventiluar. Në derën hyrëse të dhomës së makinerisë në pjesën e jashtme duhet të jetë i vendosur mbishkrimi: "RREZIK PËR JETË – NGASJA E ASHENSORIT NGA PERSONAT E PA AUTORIZUAR, JU NDALOHET HYRJA". Në hyrje të dhomës së makinerisë është ndërprerësi kryesorë me të cilin ndërpritet furnizimi me rrymë elektrike të ashensorit. Në pjesën e dukshme të dhomës së makinerisë së ashensorit në afërsi të grupit drejtues duhet të jetë i vendosur mbishkrimi "PARA ÇDO PUNE Ç'KYÇE NDËRPRESIN KRYESORË ELEKTRIK TË ASHENSORIT". Dhoma e makinerisë së ashensorit është një hapësirë e veçantë e mbyllur me mure, dysheme e punuar nga materiali ndërtimor zjarrdurues. Temperatura në dhomën e makinerive duhet të sillet nga 5 deri 40 [0C]. Në dhomën e makinerisë të ashensorit nuk guxon të ndërtohet kurrfarë instalimi përveç atij që shërben për ngasje dhe përdorim të ashensorit. Dhoma e makinerisë është realizuar me dyer te forta metalike të cilat hapen nga ana e jashtme e dhomës. Dyert duhet të kenë cilindrin e bravës dhe qelës për hapje nga jashtë, dhe dorezën për hapje nga brenda pa qelës.

6.2.7 Shinat

Janë pajisje metalike nëpër të cilën lëviz kabina apo kundërpesha. Kabina dhe kundërpesha nëpër të cilat lëviz kabina apo kundërpesha. Kabina dhe kundërpesha e ashensorit gjatë tërë rrugës lëvizin nëpër shina udhëzuese. Shinat udhëzuese janë të ndërtuara nga profili i çelikut, të ngurta dhe të palëvizshme. Janë të vendosura në pozicion vertikal. Shinat janë të llogaritura ashtu që mund t'i bartin të gjitha ngarkesat e lëvizjes së kabinës dhe kundërpeshës të ashensorit, si dhe ngarkesat të cilat lajmërohen gjatë frenimit të kabinës me ndihmën e pajisjes për frenim të dhunshëm. Numri i shinave është qift. Shinat e kabinës dhe kundërpeshës janë të përforcuara për pjesë bartëse në kafaz, me ndihmën e konzolave të çelikut.
b – gjerësia ë kokës; h – lartësia e kokës; H – lartësia e shinës; B – gjerësia e shinës. Shinat sipas EN 81-20/50 (70x65x9mm dhe 50x50x5mm)

6.2.8 Litarët/kavo

Çeliku Kavo Çeliku si element bartës i ashensorit, paraqet pjesën kryesore të ashensorëve si nga funksioni ashtu edhe nga aspekti i sigurisë. Përdorën litarët e çeliktë, ku fijet e veçanta të litarit kanë fortësi prej 1300- 1800 N/mm2 . Kavo Çeliku llogariten duke e marrë parasysh koeficientin e sigurisë 12. Kavo Çeliku e mekanizmit për ngritjen e kabinës së ashensorit, sigurojnë bartjen dhe shndërrimin e lëvizjes rrotulluese në lëvizje drejtvizore – vertikale të kabinës gjegjësisht

kundërpeshës, nga makaraja në drejtim të kabinës dhe kundërpeshës, me humbje të vogla të fuqisë në pajisjet për udhëzimin e litarëve dhe makarave.
Përveç kësaj, litarët luajnë rol kryesor sepse bartin ngarkesën në të gjitha regjimet punuese të lëvizjes, si dhe në rastin kur ashensori nuk është në lëvizje, për këtë është shumë me rëndësi që të shfrytëzohet në mënyrë të drejt litari gjatë punës së tij dhe në kohë të ta caktuar të bëhet kontrolli i tij për shkak të mundësive të konsumimit nga forca e fërkimit. Litarët duhet ti plotësojë standardet e parapara dhe normat e caktuara sepse jeta e udhëtarëve varet nga pajisjet e ashensorit sidomos nga litarët. Duhet me qenë të atestuar nga prodhuesi i cili garanton kualitet të lartë për litarët e zgjedhur sipas standardit. Litarët e çeliktë të ashensorëve ndryshojnë sipas mënyrës së thurjes. Në varshmëri nga numri i fijeve të cilat thurë, kemi:
- Litarë me thurje të njëfishtë,
- Litarë me thurje të dyfishtë dhe
- Litarë me thurje të trefishtë.

PJESA 3 - ZBATIMI

6.3 INSTALIMI

Qëllimi kësaj procedure është që të vendosë rregulla dhe të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të drejtë rrugën që ndiqet për regjistrimin për herë të parë të Ashensorit pranë ISHMTsë nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) dhe pajisjes të Personit Përgjegjës me Çertifikatën e Regjistrimit.

Fusha e zbatimit
Kjo procedurë zbatohet vetëm kur regjistrohet për herë të prë ashensori dhe hartohet çertifikata.
Përgjegjësitë
Sektori i Produkteve Mekanike dhe Drejtori i Mbikëqyrjes së Produkteve janë përgjegjës për zbatimin e kësaj procedure.
Referimet
- Ligji nr.10489 Ligji Nr.10489/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore"
- VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim";
- VKM Nr. 192, datë 04.04.2018, "Për miratimin e rregullit teknik 'Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara'";
- VKM nr. 643 datë 02.10.2019 " Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1056, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik 'Për sigurinë e ashensorëve në përdorim'";
- VKM nr 36 , datë 20.01.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut".

Rregullat e regjistrimit të ashensorëve për herë të parë pranë ishmt-së t Ashensorëve të rinjë.
Referuar pikës 4.1. të VKM nr.1056 VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik"Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", dokumentat që duhet të dorëzohen nga subjektet për regjistrimin e ashensorit për herë të parë pranë ISHMT-së duhet të përfshijnë:
a) Formularin e regjistrimit të plotësuar;
b) Kopje të deklaratës së konformitetit të ashensorit dhe të komponentëve të tij të sigurisë.
Dokumentat e dorëzuar nga subjekti shoqërohen me një kërkesë (format i unifikuar për të gjithë) për regjistrim ashnsori/ët. Dokumentat verifikohen nga grupi i inspektorëve të Sektorit të produkteve mekanike dhe përpilohet një Memo, që pas miratimit nga Përgjegjësi i Sektorit të

Produkteve Mekanike,dorëzohet Drejtorit të DMP. Drejtori i DMP i dërgon Kryeinspektorit kërkesën për miratimin për pajisjen me çertifikatë të regjistrimit të ashensorit për subjektin/personin përgjegjës që ka bërë aplikimin.
Çertifikata e Regjistrimit të Ashensorit hartohet brenda një periudhe kohore jo më shumë se 60 ditë kalendarike nga data e protokollimit të kërkesës për regjistrim pranë ISHMT-së.
Formulari i regjistrimit
Formulari i regjistrimit është përpiluar në përputhje me pikat e përcaktuara në Piken 4.2 të VKM Nr. 1056, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", miratuar me Urdhër të Kryeinspektorit. Formularin e Regjistrimit çdo subjekt/person përgjegjës mund ta shkarkojë nga web-site i ISHMT-së: www.ishmt.gov.al ose mund ta gjejë pranë zyrave të ISHMT-së.
Çertifikata e regjistrimit
Në modelin e unifikuar të çertifikatës pasqyrohen:
1. Logo dhe adresa e ISHMT;
2. Numri unik i regjistrimit të ashensorit (me 6 shifra 000000) i shoqëruar me inicialin e shkurtur të emrit të bashkisë (shembull TR 000015)
3. Data efektive e dhënies së Çertifikatës
4. Numri serial i ashensorit të regjistruar;
5. Vendndodhja e ashensorit (adresa e specifikuar me detaje);
6. Marka e ashensorit;
7. Qëllimi i përdorimit;
8. Personi Përgjegjës
9. NIPT
10. Numri i identifikimit të Organit të Miratuar (OM);
11. Lloji i ekzaminimit.

6.4 MAKINERI DHE PAISJE

Për instalimin e një ashensori në spital, procesi është edhe më rigoroz sesa në ndërtesat e zakonshme, pasi ashensorët spitalorë (bed elevators) janë më të mëdhenj, më të rëndë dhe kërkojnë saktësi absolute për lëvizjen e qetë të pacientëve.

1. Pajisjet e Ngritjes dhe Pozicionimit (Lifting)
    - Vinç 4 m, me shpejtësi të ngritjes jo më pak se 2.8 m/min, dhe shpejtësi motori 3 Kw.
    - Motokarroc me zinxhir, të pajisur me pirun ngritës të përparmë për transportin e ngarkesave të rënda, e pajisur me kontenier hidraulik me kapacitet të ngarkimit 600 kg.

2. Veglat e Montimit Strukturor
    - Makinat Shpuese Magnetike (Mag Drills): Për të hapur vrimat në traret e çelikut të godinës ku do të fiksohen mbajtëset e ashensorit.
    - Saldatrice Inverter: Për saldimin e strukturave mbështetëse.
    - Niveluesit Lazer Profesionistë (Cross-line Lasers): Përdoren për të vendosur shinat udhëzuese (guide rails) në mënyrë perfekte vertikale.
    - Kalibra Matës (Rail Gauges): Për të matur distancën e saktë midis dy shinave në çdo pikë të pusit.

7 MURATURA

PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

7.1 REFERENCAT

Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi në masën që janë marrë si referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm me përcaktimin bazë.

Ligjet dhe Rregullat e Aplikueshme Shqiptare

Normat dhe StandardetEvropiane Puna me Blloqe/Tulla

DIN EN 771-1 Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 1: Murature me njesi tulle Argjile
DIN EN 771-2 Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 2: Murature me njesi tulle Silikate prej kalciumi
DIN EN 771-3 Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 3: Murature me njësi me Përbërës Betoni (me agregat të dendur dhe të lehtë)
DIN EN 771-5 Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 5: Murature me njesi guresh te fabrikuar
DIN EN 771-6 Specifikimet për njësitë me tulla-Pjesa 6: Murature me njesi gurësh natyrorë
DIN EN 998-1 Specifikimet për llacin ne ndertim - Pjesa 1: suvatimi dhe shtresa finale e llaçit DIN EN 998-2 Specifikimet për Llaçin ne ndertim- Pjesa 2: Llaçi ne murature
DIN EN 1015-1 Metodat për testimin e llaçit ne ndërtim - Pjesa 1: Përcaktimi i madhësisë së shpërndarjes së grimcave (nëpërmjet analizës me sitë)
DIN EN 1015-11 Metodat për testimin e llaçit ne ndërtim - Pjesa 11: Përcaktimi i forces ne perkulje dhe shtypje të llaçit të forcuar

Elemente ndihmes

DIN EN 845-1 Specifikim për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 1: Lidhjet, brezat, varëset dhe kllapat
DIN EN 845-2 Specifikimet për përbërësit lidhës në ndërtim - Pjesa 2: Arkitrarët
DIN EN 845-3 Specifikimetpër përbërësit lidhës në ndërtim -Pjesa 3: rrjete metalike për përforcim

7.2 SIGURIMI I CILËSISË

Mos ndryshoni burimin ose furnitorin e materialeve pasi ka filluar fabrikimi i tullave. Tullat duhet të prodhohen njëherësh dhe nga i njëjti grup. Të përzihen të gjitha tullat për të prodhuar një pamje uniforme kur të instalohen. Një shtresëzim ose lidhje e dukshme e ngjyrave të shkaktuara nga miksimi i gabuar i tullave nuk është i pranueshëm.

7.3 DËRGIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

Të dërgohen materialet e çimentuara në kantier duke përdorur kontenierët e pacopëzuar, qartësisht i shënuar me emrat dhe marka e prodhuesve. Të ruhen materialet e çimentos në godina të thata ku nuk ka ndërhyrje të motit dhe të tregohet kujdes që të mos lejohen materiale të huaja që të futen aty dhe të parandalohet dëmtimi nga uji dhe lagështira. Të ruhen materialet ndërtimore nga dëmtimet dhe përveç rërës të mbahen të thatë deri në momentin e përdorimit. Të mbulohet rëra për të parandaluar futjen e ujit dhe të materialeve të cilat përmbajnë ngrica apo akulli. Të ruhen materialet që janë të dëmtueshëm nga lagështia nga shiu dhe uji në tokë.

7.4 PLANIFIKIMI

Të koordinohet puna në ndërtim me punën e punimet e tjera për të mundësuar artikujt e ndërtuar dhe për të shmangur prerjet dhe rregullimet /firot.

7.5 LIDHJA

Të parashikohet mbështetja dhe skelat e nevojshme për ndërtimin e muraturës. Të ndërtohen lidhëset për të rezistuar presionin e erës siç kërkohet nga kode vendore të ndërtimit.

7.6 KËRKESAT SIZMIKE

Të parashikohet përforcim sizmik. Përqindja minimale totale për muret konstruktive duhet të jetë 0.20% dhe muret ndarëse /jo-strukturore të jenë 0.15%. Trarët lidhës kërkohen në shtresën shkelëse, në pjesën e sipërme dhe të poshtme të hapjeve në tarraca dhe nivele katesh, si dhe mbi muret e parapeteve.

PJESA 2 – PRODUKTET

7.7 TULLAT

7.7.1 Specifikime të Tullave Prej Argjile

Tulla si element ndërtues duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme për ndërtimet kundër lëkundjeve sizmike:
Rezistenca gjatë shtypjes, që do të jetë për tullat 75 kg/cm²; për tullat me brima 80 kg/cm²; për tullat e kuqe për tavane 150 kg/cm².Rezistenca gjatë prerjes, e cila duhet të jetë: për tullat me brima 20 kg/cm².Përqindjet ndër hapësirat të cilat duhet të jenë: për tullat 0-25%; dhe për tullat me brime 25-45%.Trashësia e perimetrit dhe e parapetit të brendshëm për tullat nuk do të jetë më e ulët se 20mm dhe për të gjitha tullat me brima; trashësia e parametrit të parapetit nuk do të jetë më e ulët se 15mm dhe e brumit të brendshëm jo më e ulët se 9mm. Sipërfaqja e një brime duhet të jetë maksimumi 4.5 cm². Hygrofiliteti në përqindje do të jetë nga 15-20%.

7.7.2 Tullat me brima - Mure Të Brendshme

Dimensionet mesatare të tullës do të jenë si të treguara në skica. Tullat me brima do të jenë në përputhje me DIN EN 771

7.7.3 Tullat me brima – Mure Të Jashtme

Dimensionet mesatare të tullës do të jenë si të treguara në skica. Tullat me brima do të jenë në përputhje me DIN EN 771

7.7.4 Blloqe Betoni Autoklave /Me Peshë Të Lehtë

Tullat prej betoni: njësitë me peshë të lehtë me dimensione modulare dhe të trajtuara me ajër ujë ose avull. Tullat prej betoni duhet të përputhen me muraturat prej betoni, në karakteristika ngjyre dhe sipërfaqeje.

7.8 LLAÇI

7.8.1 Cilësitë e Llaçit

Llaçi për ndërtim: Në doza për 1 M³ do të kryhet me :

Llaç gëlqeror të llojit 15 me rërë lumi (me porozitet 40% dhe përmbajtje uji të duhur që ngrihet në volum deri në 20%) të përzier në proporcion me çimenton: gëlqere: rërë = 1: 0, 8: 8. 110 lt gëlqere të hidratuar, 150 kg çimento (lloji 300), 1.29 m^3 rërë.

Llaç gëlqeror të llojit 25 me rërë lumi (me porozitet 40% dhe përmbajtje uji të duhur që ngrihet në volum deri në 20%) të përzier në proporcion me çimenton: gëlqere: rërë = 1: 0,5: 5,5. 92 lt gëlqere të hidratuar, 212 kg çimento (lloji 300), 1,22 m^3 rërë.

Llaç gëlqeror të llojit 15 me rërë të pastër (që ka një porozitet prej 35%) të përzierë në marrëdhënie me çimenton: gëlqeren: rërën = 1: 0,8: 8. 105 lt gëlqere të hidratuar, 144 kg çimento (lloji 300), 1,03m^3 rërë.

Llaçi gëlqeror i llojit 25 me rërë lumi (të ketë një porozitet prej 35%) të përzierë në proporcion me çimenton: gëlqeren: rërën = 1:0,5:5,5. 87 lt gëlqere të hidratuar, 206 kg çimento (lloji 300), 1,01m^3 rërë.

Llaçi gëlqeror i llojit 1:2 me rërë të pastër (të ketë një porozitet prej 35%) të përzierë në proporcion me çimenton: rërën = 1:2. 527 kg çimento (lloji 400), 0,89m^3 rërë.
Uji: i pastër, i pijshëm dhe pa substanca të cilat mund të prekin në mënyrë që të dëmtojnë llaçin.

7.9 FINO (LLAÇI I HOLLË)

Rënia ndërmjet 200 dhe 280 mm. Të parashikohet fuqia minimale e finos prej 13,800 kPa 2000 psi në 28 ditë.

7.9.1 Përzierjet

Të mos përdoret ngjitja me ajër, materialet kundër ngrirjes, ose ngjitjet me klorin (përbërës klorine).

7.10 AKSESORËT E MURATURES

7.10.1 Përforcimi i Fugave Horizontal

DIN EN 845-3 prodhuar nga tel hekuri të tërhequr në të ftohtë. Teli nuk duhet të jetë galvanizuar me të nxehtë pas prodhimit. Përforcimi në këtë mënyrë do të jetë me lidhje me dy ose me shumë tela në gjatësi që saldohen me një tel diagonal, ose me llojin e shkallëzimit me tela perpendikular prej jo më shumë se 400mm. Të mundësohen seksione të sheshta me gjatësi prej 3m dhe cepa të paraformuar dhe kthesa në formë T prej përreth 800mm gjatësi. Gjerësia totale do të jetë përreth 50mm më pak se sa trashësia formale e murit.

7.10.2 Ankorimet dhe Lidhjet e Mureve

Të mundësohen përcaktimet e miratuara të çelikut, ankorave në formë nyje, të sheshta, bisht dallëndysheje jo më të lehta se sa 16 gjerësi dhe 22mm, me fundet kthyer lart deri në 6mm. Teli: jo me i lehtë se sa 6 gjerësi, 22mm me telin e lidhur dhe të mbyllur si lidhje.

7.10.3 Shufrat Përforcuese

Të mundësohen kllapat të cilat parandalojnë zhvendosjen e përforcimit gjatë ndërtimit.

7.10.4 Qoshet Metalike të Mureve

Të mundësohet një nga llojet e mëposhtme
Qoshet metalike të veshura me bakër: 0.2kg 7 ouns, me një fletë bakri elektrolitike, të lyer në mënyrë të njëjtë nga të dyja anët me acid, dhe kundër alkalineve, dhe me përbërës bitumoni. Të aplikohet veshja e për një peshë prej jo më pak se 1.8 kg për metër katror 6 auns për këmbë

katrore (përreth 0.9 kg për metër katror 3 auns për këmbë katrore nësecilën anë).
Bakri mbi çelik për qoshet metalike: Bakri, minimumi 450 g për një peshë prej 16 auns; çeliku me trashësinë 4 mm. Të mundësohet me deformimet e fabrikës të cilat në mënyrë mekanike lidhin qoshet ndaj lëvizjeve horizontale në të gjitha drejtimet.
Qoshet metalike me membranë të përforcuar: një element prej poliestre në thelb me një shtresë fibre prej xhami e ngjitur në njërën anë. Membrana duhet të jetë e pa kalueshme nga lagështia, përkulshëm, dhe të mos preket nga alkalin kaustike.

7.11 KONTROLLI I BURIMIT TE CILESISE

7.11.1 Testet Fluoreshente

Të kryhen testes fluoreshente në njësitë e ndërtimit të cilat do të ekspozohen ndaj kushteve atmosferike. Të vendosen teste mjaftueshëm larg përpara se të fillohet puna ndërtimore për të lejuar ritestimet nëse është e nevojshme.

7.11.2 Përllogaritja e Fuqisë

Të përllogariten fuqitë përbërëse të sistemeve të ndërtimit. Të vihen në dispozicion llogaritjet dhe njësitë e çertifikimit dhe fuqia e llaçit.

PJESA 3 -ZBATIMI

7.12 PËRGATITJA

Para se të fillohet puna, duhet të verifikohen kushtet e aplikuara.

7.12.1 Ruajtja

Njollat ruajnë sipërfaqet e ekspozuara nga llaçi dhe njollat e tjera. Kur të vendosen fugat e llaçit, të hiqet llaçi nga sipërfaqet e ekspozuara me furça fibroze dhe lopata druri. Të ruhet baza e mureve nga njollat e spërkatjes duke mbuluar tokën aty pranë me rërë, tallash ose polietilen.
Ngarkesat: të mos aplikohet ngarkesa të njëllojta për të paktën 12 orë ose ngarkesa të përqendruara për të paktën 72 orë pasi ndërtimi me tulla të ketë mbaruar.
Të mundësohet mbështetja e përkohshme sipas nevojës.

7.12.2 Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqet në çdo murature duhet të jenë të drejta, të pastra dhe të mos kenë substanca të huaja në momentin kur aplikohet llaçi.

7.13 KONTROLLI I CILËSISË NË TERREN

Fuqia Dhe Cilësitë e Llaçit

DINEN 1015-11, për 3 ditë radhazi, dhe çdo ditë të tretë nga ai moment.

7.14 CILËSIA E PUNËS

Të mbahet plumbçi i ndërtimit dhe niveli. Të sigurohet dhe përdoret matësi gjatë të gjithë punës. Ndryshimet në ngjitjen apo mbështetjen pasi ka filluar puna nuk do të lejohen. Të mos ngrihet një pjesë e murit para një pjese tjetër. Të shpejtohet puna e pambaruar për të arritur nivelimin e mureve. Dhëmbëzimi nuk do të lejohet. Mos merrni përsipër një seksion muri para të tjerëve. Të ndërtohen strukturat e dyerve dhe dritareve, hapjet, ankorimet, tubacionet ndërsa vazhdon

ndërtimi me tulla. Ti kushtohet kujdes ndërtimit me tulla në mënyrë që të shmangen thyerjet, copëzimet dhe ciflimet e anëve ose të pjesëve ballore. Shpimi, prerja, mbushja për të mundësuar punën e të tjerëve duhet të kryhet nga mekanikët e ndërtimit me tulla. Të priten tullat me sharrat e tyre për punën e ekspozuar. Punimet strukturore me çelik, vida, futje të ndryshme metalike të specifikuar diku tjetër duhet të vendoset në pozicionin e duhur ndërsa vazhdon puna. Të jepen ndjekësit e dimensioneve të miratuara dhe të qëllimeve të tjera ku tregohet dhe aty ku është e nevojshme.
Mbulimet e mureve të ekspozuara dhe ndarjet të cilat nuk punohen me membranë rezistente ndaj ujit të siguruar në vend dhe të shtrirë poshtë të paktën 600mm në të dyja anët.

7.15 PËRZIERJA E LLAÇIT

Të maten materialet e llaçit në kontenierë prej 0,0283 m^3 për të ruajtur kontrollin dhe saktësinë e proporcioneve. Përzieni llaçin në përzierës mekanik për jo më pak se 3 ose jo më shumë se 5 minuta pasi të gjithë përbërësit janë vendosur në mënyrë që të prodhohet një përzierje e njëtrajtshme. Të shtohet uji në mënyrë graduale për të prodhuar një përmbajtje të punueshme.
Të mos mbushet përzierësi përtej kapacitetit të dhënë. Të ripunohet llaçi i cili është ngurtësuar për arsye të tharjes së ujit duke shtuar ujë për të marrë një dendësi të punueshme. Të mos ripërdoret llaçi i cili nuk është vendosur në pozicionin përfundimtar brenda afatit kohor prej 2.5 orësh nga përzierja.
Të mos përdoren përbërësit kundër ngrirjes, kripërat dhe ose substancat e tjera për të ulur pikën e ngrirjes së llaçit.
Llaçi: të përzihet llaçi në përputhje me DIN EN 998-2 për të pasur llojin e llaçit të kërkuar. Kur çimento e ndërtimit mundësohet, ti përmbahet udhëzimeve të printuara të prodhuesit të çimentos.
Fino: të mundësohet fino në hapësirat e finos më pak se 50mm në çdo dimension horizontal ose në të cilën hapësira ndërmjet përforcuesit dhe ndërtimit me tulla është më pak se 20mm.

7.16 FUGAT E LLAÇIT

Fugat e llaçit duhet të aplikohen në trashësi të njëtrajtshme prej 10mm vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Lidhjet e ekspozuara pak të futura të rrumbullakëta ose me një bashkues tjetër të përshtatshëm kur llaçi është forcuar. Për bashkimet horizontale, bashkuesit duhet të jenë të paktën 300mm të gjatë për punën me tulla dhe 600mm të gjatë për punën me beton. Bashkuesit do të jenë pak më të mëdhenj se sa gjerësia e bashkimit në mënyrë që kontakti total të kryhet nëpërmjet cepave të njësive, duke shtypur dhe mbyllur sipërfaqen e bashkimeve. Të pastrohen bashkimet për të hequr llaçin e tepërt dhe të lirë. Bashkimet horizontale duhet të jenë të niveluara; bashkimet vertikale duhet të maten me plumbç dhe të rregullohen nga lart poshtë murit me një tolerancë plus minus 10mm në 10m.

7.17 TOLERANCAT

Muratura duhet të jetë brenda kufizimeve të mëposhtme:
Faqja ballore e tullave : 1mm nga faqja e tullës më të afërt.
Faqja ballore muraturës së betonit: 2mm nga faqja e njësisë më të afërt. Ndryshimet në trashësinë e murit: Plus ose minus 6mm.

7.18 PUNIMET ME TULLA

Të përzgjidhet dhe vendosen tullat në të tillë mënyrë që të ekspozohet ana më e mirë.

7.18.1 Testimi

Përveçse në kohë të ftohtë, të testohet argjila ose tullat në kantier, para se të vendosen në mënyrë të tillë: Dukë përdorur një laps prej dylli, të vizatohet një rreth në madhësinë e një monedhe në pesë tulla të përzgjedhura rastësisht.

Hidhni 20 pika uji nga një pikatore në sipërfaqe brenda rrethit tek secila tullë. Nëse koha mesatare që uji është tërësisht përthithur në të pestat tulla është më pak se 1-1.5 minuta, tullat e lagura të përfaqësuara nga pesë tullat e testuara.
Të sigurohet që çdo tullë është e njomë, por sipërfaqja të jetë e thatë kur të vendosen. Gjatë kohës së ftohtë, të mbahen materialet e ndërtimit të thata deri sa të vendosen.
Bashkimet e thata ose të ngjitura nuk do të lejohen.

7.18.2 Përdorimi

Nëse nuk tregohet ose specifikohet ndryshe, të vendosen tullat në rresht dhe në lidhje të një pas njëshme. Të mbushen tërësisht bashkimet ndërmjet tullave me llaç. Të formohen bashkime të shtratit të trasha me llaç të cilat janë më pak se trashësia e murit; të vendoset llaçi në këtë shtrat në formë piramide ose brazde. Të formohen bashkimet në fillim duke aplikuar një trashësi të plotë llaçi në tullat që do të vendosen. Lëvizja e bashkimeve kryesore nuk do të lejohet. Të vendosen tullat me llaçin në secilin bashkim të njësive për tu vendosur në vend. Të vendosen tullat me kujdes pa shqetësuar ato të cilat janë vendosur më parë.

7.18.3 Murature e Jashtme Me Tulla me Brima (38 Cm)

Të vendoset muratura me tulla me mbrima me një trashësi konstante ose të ndryshme në lartësinë prej 3m. Për punime te jashtme, në tullat e parafabrikuara duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat për të përfunduar punën në mënyrë të saktë. Në shtratin e katit të poshtëm duhet të vendoset një shtresë llaci çimentoje (e llojit 1:2), 2 cm trashësi minimale. Përzgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, cilësie dhe me cepa të pa dëmtuar dhe funde me sipërfaqe të ekspozuar. Të vendosen njësite e plumbces, paralele dhe me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

Murature e Jashtme Me Tulla me Brima (25 Cm)

Tulla me bira per murature te jashme 38 cm

Tulle prej argjile me bira, me trashësi 38 cm; duke përfshirë, arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skeleri

Të vendoset muratura me tulla me mbrima me një trashësi konstante ose të ndryshme në lartësinë prej 3m. Për punime te jashtme, në tullat e parafabrikuara duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat për të përfunduar punën në mënyrë të saktë. Në shtratin e katit të poshtëm duhet të vendoset një shtresë llaci çimentoje (e llojit 1:2), 2 cm trashësi minimale. Përzgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, cilësie dhe me cepa të pa dëmtuar dhe funde me sipërfaqe të ekspozuar. Të vendosen njësite e plumbces, paralele dhe me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

7.18.4 Tulle me Bira (20 Cm) per Murature te Brendshme dhe te Jashtme

- Tulle prej argjile me bira, me trashësi 25 cm; duke përfshirë, arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skeleri
- Tulla me bira per murature te jashme 25 cm

Muratura me tulle me bira (6 ndarje) me një trashësi prej 20 cm dhe llaci gëlqeror duke përfshirë hapjet vertikale, cepat, skelat dhe ndonjë gjë tjetër për të përfunduar ndërtimin me tulla. Në shtratin e katit perdhe duhet të jetë i niveluar me një shtresë llac çimentoje 1:2, 2cm trashësia minimale. Të përzgjidhen njësitë për njëtrajtshmëri dhe madhësi, përmbajtjen, barazimin dhe cepat e pa dëmtuar dhe fundet e sipërfaqeve të pa ekspozuara. Të vendosen njësite e plumbces në mënyrë paralele me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

- Murature e Brendshme Me Tulla me Brima (25 Cm)
- Parapet me tulla me brima me një trashësi prej 20 cm
- Murature me tulla me brima 20 cm

Të vendoset muratura me tulle me bira 25cm duke përfshirë materialin për hapjet vertikale, cepat, skelat dhe të gjitha kërkesat e tjera për të përfunduar punën në një mënyrë të duhur. Në shtratin e katit të parë duhet të nivelohet një shtresë llac çimentoje 1:2, me 2cm trashësi minimale. Zgjidhni njësitë për njëtrajtshmëri, madhësi, pastërti dhe me cepa të pa dëmtuara, e me bashkime të duhura me njëtrashësi maksimale prej 10mm. Të ruhen sipërfaqet e ekspozuara të pastra dhe pa defekte.

- Murature e Brendshme Me Tulla me Brima (12 cm)
- Tulla me bira per murature te brendshme 25 cm
- Tulle argjile me brima, me trashësi 25cm; duke përfshirë arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skelat

Të vendosen muratura me tulle me brima me trashësi prej 12cm dhe duke përfshirë materialin për cepat, hapjet vertikale, skelat dhe ndonjë kërkesë tjetër për të përfunduar punën në mënyrën e duhur. Në shtratin e katit të poshtëm, duhet të nivelohet një shtresë llaci çimentoje 1:2, me trashësi minimale prej 2cm. Të përzgjidhen njësitë për njëtrajtshmëri madhësie, përmbajtjeje dhe me cepa të pa dëmtuara per sipërfaqe të ekspozuara. Të vendosen njësite e plumbces në mënyrë paralele me fugat e duhura me trashesi maksimale 10 mm. Te mirembahen siperfaqet e ekspozuara , te pastra, pa dëmtime ose defekte.

- Tulla me bira per murature te brendshme 12 cm
- Tulle argjile me brima, me trashësinë 12cm; duke përfshirë arkitrarët, brezat e siperm dhe te poshtem, lidhjet e betonit dhe skelat

7.19 BASHKIMI DHE ANKORIMI

Nëse nuk tregohet ndryshe, ndarjet te shtrihen ne drejtimin dysheme-tavan. Te lidhen ose ankorohen strukturalisht muret dhe ndarjet nga njëri tjetri. Në mënyrë të sigurt të ankorohen muret e jashtëm jo mbajtës dhe ndarjet e brendshme me strukturat e betonit në një mënyrë që të jepet qëndrueshmëria laterale ndërsa lejohet shmangia e pa kushtëzuar e ndërtimit mbi të. Të vendosen tërësisht ankorimet në bashkimet me llac.

Ndërthurjet e mureve të cilët nuk mbajnë peshën e godinës dhe mureve ndarës me ndarje ose mure të tjera: të lidhen me rrjete teli lidhese ne intervalet vertikale prej jo me shumë se 60cm ose me tulla që ndërthuren.

Muret të cilat perballin elemente betoni: të lidhet muratura me betonin me ankora të llojit rrjetë të vendosura ose futura në beton. Të pozicionohen ankorime jo më shumë se 300mm Vertikalisht dhe jo më shumë se 600mm horizontalisht.

7.20 LLAMARINAT

Te behet zgjatimi i llamarines 6mm jashtë faqes së jashtme të mureve, lart në lidhje bashkuese jo më pak se 150 mm, të shtypet cepi i jashtëm për të formuar pikoren. Qoshet e siguruar krijojnë një lidhje permanente siç tregohet. Të mundësohen llamarinat në gjatësi sa më praktike. Fundet të mos mbarojnë jo më pak se 35mm nga nyja ndërthurëse dhe 100mm për llojet e tjera. Të izolohen fundet në bazë të nevojës për të siguruar mos depërtimin e ujit. Të parashikohen ndalesa në fund të qosheve te llamarines, aty ku muratura me tulla bashkohet me betonin dhe aty ku qoshet e llamarines përfundojnë brenda muratures.

7.21 VRIMAT PËR LARGIMIN E UJIT

Kurdoherë pergjate llamarinave ne mure, të mundësohen vrimat për largimin e ujit nga llamarina, jashtë. Vrimat për largimin e ujit duhet te hapen 600mm pergjate fugave.

7.22 PËRFORCIMET E FUGAVE HORIZONTALE

Të mundësohen përforcimet në dy shtresat sipër dhe poshtë hapjeve në mure dhe ndarjeve të njësive të betonit. Përforcimi duhet të jetë i vazhdueshëm përveç se në lidhjet e kontrollit dhe ato të zgjerimit. Përforcimi sipër dhe poshtë hapjeve duhet të shtrihet jo më pak se 600mm përtej secilës anë të hapjeve. Të jepen bashkësitë e salduara në formë L-je dhe në formë T-je për të përshtatur përforcimin e drejtë, tek cepat dhe bashkimet e mureve dhe ndarjeve. Të mundësohet mbulimi me llac për rrjeten të paktën 16mm për anët e jashtme të murit dhe 12mm për anën e brendshme të murit.

7.23 NJESI BETONI, ARKITRARËT DHE TRARË LIDHËS

Të mundësohen njësi të veçanta, të mbushen qelizat plotësisht me fino ose beton, dhe të jepen jo më pak se dy shufra përforcuese Nr5, vetëm nëse nuk tregohet ndryshe. Përforcimi do të ndërthurë një minimum prej 40 bar në prerjet e diametrit. Njësitë e ndërtuara me beton të dhëna për arkitrarët dhe trarët lidhes duhet të kenë sipërfaqe të ekspozuara të materialit të njëjtë dhe përmbajtje si njësitë ngjitur të ndërtimit. Arkitrarët duhet të jenë të drejta dhe të kenë të paktën 200mm aftesi mbajtëse në secilën anë. Njësi të tilla duhet të përdoren në zona ku të paktën tre radhë tullash mund të vendosen mbi njësi.

7.24 FUGAT E KONTROLLIT

Hekuri duhet të jetë i ndërprerë tek fugat per lidhje te ndermjetme traresh . Hekuri duhet të vazhdojë pergjate fuges për të gjithe traret lidhës strukturore. Të jepet aty ku tregohet njësi murature betoni-njësi murature me tulla. Bashkimet duhet të ndodhin në mënyrë të drejt për drejtë ose kundër njëri tjetrit në marrëdhënie me murin dhe duhet të mbushen sipas specifikimeve në norma dhe referenca ose nga një gomë sintetike ose ngjitës plastik .

7.25 FUGAT E EKSPANSIONIT

Të jepen aty ku tregohet në muret prej tulle. Të mbushen fugat ne menyre permanente me mbushës fleksibel dhe ngjitës.

7.26 VENDOSA E FINOS

Të vendoset fino nga ana e brendshme e mureve, vetëm nëse nuk miratohet ndryshe. Të ruhen parvazet, cepat, daljet dhe ndonjë sipërfaqe tjetër nga fino e rënë në tokë. Të hiqet fino nga sipërfaqe të tilla menjëherë. Fino duhet të përzihet mirë për të parandaluar ndarjen dhe të jetë mjaftueshëm e lëngshme për të rrjedhur në fuga dhe pergjate përforcimeve pa lënë hapësira.

7.26.1 FORMAT DHE MBËSHTETESET

Dyshemetë PVC, siperfaqet dhe/ose te forta, të mbuluara me rere dhe te pastruara, do të mbrohen deri në mbërritjen e klientit së bashku me materialet si (pllaka, takot e drurit, tallashi etj.) të cilat janë vendosur për të shmangur dëmtimin e sipërfaqes së dyshemesë së shtruar.

Para dorëzimit, dyshemetë duhet të lahen pastrohen dhe thahen me produkte të veçanta në përputhje me udhëzimet që ka dhënë fabrika për larjen dhe pastrimin e produktit. Detergjente me përqendrim të lartë ose hollues që nuk janë aprovuar nga fabrika ose Mbikëqyrësi, nuk duhet të përdoren mbi dysheme.

Dyshemetë të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj shiut ngricës ose nxehtësisë nga rrezatimi diellor do të mbrohen në mënyrë të përshtatshme. Çdo lloj shtrimi kërkon kohë të mjaftueshme për tu bërë gati të shkelet vendosja/shtrimi i sipërfaqes së tij duhet të marrë kohën e duhur dhe jo të përshpejtohet por brenda limiteve kohore të përcaktuara që mos të ketë ndikim në fortësinë dhe cilësinë e përgjithshme të shtrimit. Në rastet që përshkruhet në projekt ose në përputhje me pragun, zona të ndryshueshme në lartësi të dyshemesë etj, kulmet dhe cepat e dyshemesë dhe/ose shkarkimet, duhen mbrojtur nga rreziqet e dëmtimit të instalimeve, ngjitjeve të përshtatshme të PVC- së, të gomës, çelikut normal apo atij special, bronzit dhe gurit që të kenë karakteristikat e përshtatshme për të rezistuar nga trafiku i pritur.

Shtrimi me materiale dhe veglat e tjera për inertet dhe materialin lidhës duhet të bëhet për të përfituar kohën dhe cilësinë e kërkuar. Mallrat dhe veglat e tjera duhet të kenë një sipërfaqetë thatë, dhe fortësinë dhe nivelimin e duhur (sipas sipërfaqes që duhet të punojnë), të jenë kompakte pa plasaritje në sipërfaqe dhe të jenë të qëndrueshme në të gjithë sipërfaqen e tyre. Dyshemeja duhet të ketë ngjyrë uniforme në varësi të ngjyrës së kërkuar, si dhe me kualitetin e kërkuar, pa defekte dhe ciflosje për gjatë gjithë shtrirjes së saj. Sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e rrafshët në mënyrë perfekte.

Mbulimi i murit dhe çdo mbrojtje tjetër duhet bërë me materiale rastësore ose në përputhje me ato që ka thënë Mbikëqyrësi i punimeve. Vëmendje e veçantë ti kushtohet vendosjes së elementëve mbështetës /binarëve që janë pas strukturës që të puthiten fiks me njëri tjetrin, linjat e bashkimeve/vidhosjeve duhen puthiten drejtë. Shtresa përfundimtare duhet të bëhet me elementë special si plinte, shirita dhe korniza. Pas përfundimit të punës mbulesat e murit duhet të pastrohen dhe lahen.

11.3 KUSHTET MJEDISORE

Te mos aplikohet shtrimi i pllakave në një ambient apo zonë me temperaturë minimale nga 10 gradë celsius e sipër. Te mbahet temperatura e ambientit mbi 10° C ndërkohë që punohet dhe për të paktën 3 ditë pasi te jete përfunduar shtrimi. Te mos përdoret kollë ose ngjitës në zona jo të mbuluara.

Nëse kushtet e motit janë veçanërisht të vështira, ose kur konsiderohen si të papërshtatshme për punë, kontraktori duhet te vazhdojë shtrimin dhe duke mbrojtur dyshemenë me litarë, peceta, mushama etj. dhe nëse ato nuk janë të mjaftueshme, pezullimi i punës duhet të bëhet me aprovim

të mbikëqyrësit.
Në kushtet e klimës së nxehtë shtrimi duhet të mbahet i njomë/ lagësht për të shmangur tharjen e përshpejtuar të shtresës nën pllaka/ llaçit dhe kollës. Procedurat dhe metodologjia e punës duhet të koordinohet dhe aprovohet nga mbikëqyrësi (inxhinieri zbatues), teprica e sasisë të ujit mund të shkaktojë shpërbërjen e llaçit/ kollës dhe për pasojë rezistencës e shtresës, me një kohë të përcaktuar të shkëputjes së pllakave. Gjatë shtrimit të dyshemesë , shtresa e llacit nuk lejohet të rrise përqindjen e ujit dhe llaçit për të shmangur fenomenin e tharjes së përshpejtuar.

11.4 MATERIAL SHTESE

Te furnizohet me një shtesë prej 2% të çdo tipi pllake të përdorur .

PJESA 2 – PRODUKTET DHE MATERIALET

11.5 BETON I LEHTESUAR

Nënshtresat e dyshemese duhet të furnizohen dhe instalohen në përputhje me praktikat më të mira dhe të shoqëruara nga të dhënat përkatëse që çertifikojnë të dhënat teknike dhe karakteristikën e performancës. Shtrimi i llaçit do të realizohet në dy shtresa. E para do të jete beton i lehtesuar i tipit CT-C20-F4, në varësi të trashësisë që do te vendoset mes soletes, shtreses finale te llaçit të përbërë nga nje produkt dy komponent që ka lidhës çimentoje dhe hollues. Përzierja duhet bërë me makinerinë e duhur. Dozat duhet të jetë 300 kg/m³ lidhës çimentoje dhe 2 l/m kolle duke mundësuar një llaç me një forcë ngjeshëse për 28 ditëtë 1 N/mm^2.

11.6 LLAÇ Ç IMENTO DHE LLAÇ Ç IMENTO ME RERE

Shtresa e dytë do të jetë: shtrese llaçi nivelues e llojit çimento dhe rërë, trashesia variabel. Llaçi do të copëzohet gjatë hapjeve në mure ose çfarë do lloj platforme, duke futur një pllakëz ndarëse në llaç, gjatë shtrimit ose pas forcimit /mpiksjes. Pas mpiksjes, llaçi i duhet të ketë një forcë ngjeshje dhe përkuljeje pas 28 ditëve prej 20 dhe 45 N /mm^2.

11.7 BARRIERAT AVULLIZOLUESE

Barrierat e avullit duhet të jenë fletë polietileni, të trasha 0.50 mm, përshkueshmëria ndaj avujve "s" më e madhe se 2-100m, mos suksesi në thithje 450%. Fletët do të pozicionohen ndërmjet shtresës së parë dhe të dytë të betonit te lehtesuar. Shtresat përftohen nga grimcat e virgjëra, me ngjyrë neutrale ose të bardhë, me densitet Kg/dm3 0.95, tharja e shtresës sipas procedurave të mëposhtme:

- Me 20 cm mbivendosje dhe 10 cm e mbledhur lart në pjesët vertikale,
- Me 5 cm mbivendosje, e mbyllur me shirit ngjitës fugash 8 cm të gjerë, 10 cm e mbledhur në pjesët vertikale.

Lidhjet me të gjitha pjeset e perfshira te bashkruara përmjet shiritit te fugave te perdoren edhe në muret vertikale.

11.7.1 Trashësia e izolimit

Duhet të ofrohet për të mundësuar rezistencën termale. Trashësia duhet të bazohet sipas faktorit "R"për izolim për një kohë të gjatë. Izolimi i platformave të hekurit duhet të jete i kenaqshem si faktor i specifikuar R por edhe trashësinë minimale për shtrimi të publikuar në literaturën e fabrikës. Trashësia duhet të jetë jo më pak se 30 mm.

11.8 PLLAKAT

11.8.1 Ngjyrat dhe modelet

Ngjyra e pllakave dhe modelet duhet të zgjidhen nga kampionet e ngjyrave standarde të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet e treguara si reference të emrit të fabrikës dhe emëruesit shërbejnë si identifikim ngjyrash për atë fabrikë por nuk kufizojnë produkte të ngjashme dhe ngjyrat e modelet të një fabrike tjetër.

11.8.2 Dyshemetë prej qeramike – pllakat Gres

Të gjitha pllakat e përdorura duhet të jenë ato të cilat janë miratuar gjatë vështrimit të mostrave /modeleve. Përzierja e pllakave në mure apo dysheme të blera nga një fabrikë tjetër nuk lejohet. Të gjitha pllakat e dyshemesë duhet të jenë kundra rrëshqitjes. Pllakat s'duhet të kenë përmbajtje plumbi, siç klasifikohet në grupin B1 në përputhje me UNI EN 87 dhe që përmbushin parametrat e standardeve të UNI EN 176, te cilat konsistojne në një masë të vetme qoftë edhe kompakte (e ngjeshur) e parreshkitshme ose e trajtuar në sipërfaqe, e nxjerrë nga presimi i ftohtë ose i ngrohtë automatik i pastës që del nga mpiksi i kaolitinës. Materialet inerte ose me përbëres çeliku duhet të jenë shumë të vogla në permbajtje.
Temperatura e pjekjes 1200°C
Përthithja e H2O ≤ 0,05% UNI EN 99
Fuqia e perkuljes 45-55 N/mm2 UNI EN 100 Fortësia e sipërfaqes7/8 Mohs UNI EN 101
Rezistenca ndaj sulmeve kimike në përputhje me UNI EN 106 Rezistenca ndaj ngricave në përputhje me UNI EN 202
Rezistence termale dhe ndaj tronditjes në përputhje me UNI EN 104 Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj rrezeve UV në përputhje me DIN 51094 Rezistence ndaj gërryerjes së thellë 125-140 mm3 UNI EN 100
Kundra zjarrit

Të dhënat teknike

KLASIFIKIMI SIPAS RREGULLORES CEN GRUPI B1 EN 176					
Paraqitja		**Rregullat/mënyra e matjes**	**Masa e matje**	**UNI EN 176**	**Vlerat minimale**
Përthithja e ujit%		**UNI EN 99**	**%**	**≤ 0,5**	**≤ 0,05**
Dimensionet(A)	**Gjatësi dhe gjerësi (B)**	**UNI 98 EN**	**%**	**± 0,6**	**± 0,3**
	Trashësia	**UNI 98 EN**	**%**	**± 0,5**	**± 3,0**
	Fuqia kulmeve	**UNI 98 EN**	**%**	**± 0,5**	**± 0,3**
	kuadratimi	**UNI 98 EN**	**%**	**± 0,6**	**± 0,3**
	rrafshësia (C)	**UNI 98 EN**	**%**	**± 0,5**	**± 0,2**
Fuqia e lakimit		**UNI 100 EN**	**N/mm²**	**≥ 27**	**45-55**
Ngarkesa e thyerjes	**cm 20x20 trashësimm 8,5**	**UNI 100 EN**	**Kg**	**Nuk nevojitet**	**200-220**
	cm 20x20 trashësimm	**UNI EN**	**Kg**	**Nuk nevojitet**	**420-460**
	cm 20x20 trashësimm 15	**UNI 100 EN**	**Kg**	**Nuk nevojitet**	**680-720**
Rezistenca ndaj gërryerjes në thellësi		**UNI102 EN**	**mm³**	**≤ 205**	**125-140 mm**
Fuqia e sipërfaqes		**UNI101 EN**	**MOHS shkalla**	**≥ 6**	**7/8**
Koeficenti i përçimit termal të njëtrajtshëm		**UNI 103 EN**	**Mk⁻¹**	**≤ 9**	**6,5**
Rezistencë ndaj tronditjeve termale		**UNI 103 EN**		**Asnjë moster s duhet**	**Përmbush**

				te kete alternative tjeter	
Rezistencë ndaj sulmeve kimike	Përdorimi shtëpiak i produkteve kimike	UNI 106 EN		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbus h
	Bojak pishinës të	UNI 106 EN		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbus h
	Rezistencë ndaj acideve dhe bazikëve.	UNI 106 EN		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbus h
Rezistencë ndaj ngricave		EN 202		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush
Qëndrueshmëria e ngjyrës përkundrejt dritës		DIN 51094		Asnjë moster s duhet te kete alternative tjeter	Përmbush

A. Format referues cm 30x30
B. Pranueshmëria në % format e devijuara sipas atyre që prodhon fabrika
C. Qendra e harkimit, ka lidhje me përllogaritjen diagonale te përmasave të fabrikës Shtrimi

Shtrimi i pllakave duhet të jetë i tillë që të ruaj dhe vetë karakteristikat që potencialisht mund të japi vet produkti i shtrimit. Te pastrohen gjithë njollat ose mbeturinat, pluhurat që mund të ketë sipërfaqja gjithashtu te laget me pas. Kujdes duhet treguar gjatë pergatitjes së llacit që do të shtrohet (të mos kalojë trashësinë maksimale nga 3-5 cm).
Ndërsa ajo minimale si në vazhdim: Rërë e larë (Ø maks3 mm) - 1 mc, Çimento- 325 200 Kg, Ujë- 80÷100 lt.

Përmbajtja e ujit e cila ka të bëjë me minimalen por mund të ndryshojë në varësi të temperaturës, lagështisë së rërës, sasia e holluesve kimik që i janë shtuar llaçit. Te perzihet perberja në një pajisje tjetër mekanike(betoniere) për të arritur përzierjen perfekte dhe te perdoret në një kohë shumë të shkurtër që të perftohet kapaciteti lidhës i tij. Është e udhës të kufizohet hapja e tepërt e kollës në mënyrë që pllaka e porcelanit apo gurit të ngjisin në kollë të njomë.

Te përdoren pajisje vibruese në mënyrë që kolla të bëhet më kompakte dhe të nxjerrë jashtë sasinë e tepërt të ajrit. Te spërkatet me çimento 325 në sasinë e 5-7 kg për m2dhe te laget para se të vendosen pllakat,në mënyrë për të rritur ngjitjen midis pllakës dhe llaçit. Nuk është e nevojshme të lagësh pllakën e porcelanit sepse nuk është se ka aq shumë porozitet, por një zhytje e shpejtë e pllakës mund të bëj punë dhe largon pluhurin prej saj.

Te shtrohen pllakat ngjitur cep me cep, nëse shtrohet një ambjent i ngushtë ose te përdoren kryqe ndarës per bojakun ne sipërfaqe me të gjëra; metoda e dytë është më e preferueshme në rast riparimi të strukturës dhe lejon një tolerancë të lehtë midis pllakave gjithashtu mundëson vendosjen në linjë të pllakave me anë të distancuesve në formë kryqi.

Te shtypi pllakat me një çekiç ose vibrator të veçantë prej gome, qëllimi është ngjeshja e llaçit/kollës për të rritur kontaktin midis llaçit dhe pllakës dhe që të lejojë daljen e tepricës së ujit apo llaçit/kollës. Ky proces vlen në rast se e ngremë pllakën dhe 80 deri 90 % e sasisë të llaçit/kollës ngelet në pllakë. Te sigurohet që çekiçi i gomës të jetë gjithmonë i pastër për të mos lënë shenja apo dëmtime atje ku ka prekur sipërfaqen e pllakës.

Te pergatitet bojaku me materiale organike me bazë çimentoje, për shembull: përzierje të rrëshirës dhe holluesve të tjerë si dhe solucione ngjitëse. Bojaku duhet të pastrohet më së miri midis zgavrave të pllakave pas 3-4 orësh.

Pastrimi i veshjes ne pllaka, nga bojaku dhe kolla duhet të bëhet në përputhje me kërkesat që parashtron prodhuesi i pllakave para se ai të ngurtësohet përgjithmonë, një ndërhyrje e vonuar

për pastrimin e bojakut mund të kërkojë përdorimin e solucioneve dhe acideve duke krijuar efektet e tyre të avujve të cilat mund të dëmtojnë bojakun ose çdo objekt metalik të kromuar që ndodhet aty afër. Sipërfaqet eferveshente për tu tharë nga uji ose nga mbetjet aksidentale të njollave të llaçit mund të hiqen pasi fenomeni të ketë përfunduar, përdor me kujdes acide organike me përqendrim të ulët dhe pasi të jetë lagur fillimisht me ujë të pastër me ane të një sfungjeri. Fugat e ekspansionit duhet të përfshihet, shtrihen pjesërisht në nënshtresa, për sipërfaqe që nuk i kalojnë 30 metra2 si dhe përveç nyejve të tjera strukturore. Lëvizjet e vogla që kanë lidhjet me nyjet mbështetëse ekzistuese të mund të bëhen me anë të ndërthurjes së materialit elastik që lejon ndryshime pa krijuar rrezikun e thyerjeve me apo pa të çara, kusht që lëvizjet mos të tejkalojnë një të pestën e pllakave. Valëzime si për 2 mm për metër linear në gjatësi nuk do të lejohen. Me përdorimin e ngjitëseve të përshtatshëm pllaka mund të vendoset në sipërfaqe të veçanta të tilla si suva, plastike, metalike, druri, panele fibre, mbi pllakat ekzistuese ose në të gjitha rastet në të cilat sipërfaqja e strukturës është paksa poroze dhe ku nuk na siguron pikat tradicionale të ngjitjes/saldimit. Sasia e mjaftueshme e kollës/stukos do jetë në varësi të llojit të nënshtresës, llojit të kornizës dhe që mund të kërkojë 2,5-4 kg/m² për veshje muri dhe 4-5 kg /m² për dysheme; një konsum i tillë është shumë më i ulët se një veshje tradicionale e cila merr rreth 25-40 kg/ llaç /kollë. Vlerësimi i gjendjes së nën dyshemesë e cila duhet të jetë krejtësisht e sheshtë pa pluhur duke vlerësuar këndet e mureve, shkallën e teksturës së tyre.

Te parandalohet përdorimi i solucioneve /stukos për nivelim si për mure dhe për dysheme në rast se sipërfaqja shtrimit nuk është mjaftueshëm ne vendosje të rrafshët. Shtrimi duhet të bëhet në strukturat të paktën dy muaj para dorëzimit duke llogaritur tkurrjen e betonit 300-500 mikronë/metër. Te hiqen dhe pastrohen të gjitha gjurmët e mbeturinave dhe pluhurit nga sipërfaqja me anë të një furçe të bollshme/ fuqishme dhe me anë të lagies në mënyrë të njëtrajtshme me ujë dhe te lihet të thahet me anë të mjeteve përthithëse të ujit ose me anë të tharëseve nëpërmjet nxehjes së ambientit. Zgjerimi dhe ngurtësimi i nyejve bashkuese duhet të realizohet përgjatë gjithë gjatësisë së mureve rrethues dhe strukturave të larta nëpërmjet përdorimit të një materiali të fortë që shtrëngohet me përmasa 0,6-1,2 cm trashësi dhe lartësi të përshtatshme. Gjithashtu tkurrja e bashkueseve duhet të kryhet me qëllim që shtrimi mos ti kalojë 16m² secili, në ambiente të jashtme dhe 25m² ambiente të brendshme.

11.8.3 Dysheme betoni dhe shtrim me pllaka betoni

Pllaka betoni vete-shtrenguese, me trashësi 50 mm, me siperfaqe kuarci dhe rezistente per shtrim dyshemesh industriale perbere prej një konglomerat betoni me cilesi te garantuar, klasa e ekspozimit XC1- XC2 dhe rezistence minimale minimum Rck 30, të përforcuar me rrjetë e përbërë nga shufra çeliku me diametër 6 mm dhe FeB44k rrjetë 20x20 cm. Veshja ka një sipërfaqe rezistuese e cila është e përbërë nga agregate minerali të kuarcit të korundumit, lloje të veçanta solucioni, oksiduesish dhe ngjyruesish të klasifikimit 5 kg/m² (ngjyra sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit).
Gjithashtu kjo dysheme duhet të ofrojë një koefiçent fërkimi të caktuar, si dhe duhet të përmbush e standardet e ndërtimit për eliminimin e barrierave arkitekturore në godina, hapësira publike dhe vende shërbimesh komunitare.
Ky proces do të përfshijë pjerresite, të prerjeve të thella dhe fugave të PVC-së të cilat formojnë një 4x4 m element dhe sidoqoftë të mos i tejkalojë 20m^2, shtrirjen e shiritave izolues të polistirenit prej 10mm, ne muret perimetrale me mbrojtjen e nevojshme deri në 1 m lartësi, vendosjen e ulluqeve prej çeliku në përputhje me pragjet, hedhjen e rërës përfundimtare, lyerjen me detergjentet e përshtatshëm, si dhe ndërtimin e sistemit dhe kanalit të kullimit të ujërave .

11.8.4 Dyesheme Epokside

Me këtë sistem është e mundur të lyhen dysheme, të cilat përftojnë rezistencë të lartë kimike, papërshkueshmëri ndaj vajrave dhe elementëve agresive, rezistencë ndaj lavazheve të vazhdueshme dhe ndaj lëvizjeve të karrocave apo mjeteve të tjera lëvizëse. Dyshemetë epokside kanë pamje të bukur estetike dhe bëhen të parrëshqitshme.

Aplikimi bëhet në dysheme industriale me trafik normal ose të rënduar, si: magazina, ambiente teknike, zona të depozitimit të mallrave, parking dhe garazhe të mbuluara, në zonat e këmbësoreve dhe në zonat me trafike të rënduar të mjeteve lëvizëse, në laboratorë, etj.
Këto dysheme rezistojnë ndaj:
acideve minerale të holluar, si: acid kloridrik, nitrik, fosforik dhe sulfurik, alkaleve, hidroksidit të natriumit me përqëndrim 50% dhe detergjentëve të përdorur për pastrimin e dyshemeve me përqëndrim 20-30% sheqerit, edhe ne kontakt të vazhdueshëm vajrave minerale dhe karburanteve
Para aplikimit, siperfaqja duhet të jetë e rrafshuar, e lëmuar dhe e pastruar mirë. Më pas të shtrohet me rul.

11.8.5 Veshje e Mureve

- Pllaka majolike te glazuara ose gres qeramike, klasi standard
- Dimensionet nominale pamjes 300 x 150 mm, 13 mm trashësia, asnjë opsion tjeter
- Ofrohet në vende si: WC
- Montimi i pllakave për përdorim në zona me lagështi
- Përfshi gjithë aksesorët specifikë (këndoret, bojaku, distancuesit kryq, etj)

Për sipërfaqe të tilla si stukime, panele gipsi, panele gipsi te parapergatitura, tallash i presuar, çimento, suva, beton i parapërgatitur etj, duhet aplikuar një ngjitës i qëndrueshëm. Duhet bërë një trajtim paraprak i sipërfaqes me prajmer izolues, i cili duhet parashikuar para aplikimit te kollës në suva apo sipërfaqes së stukuar. Për përzierjen e përbërsave të ndryshëm të ndiqen udhëzimet e fabrikës; në rastin e ngjitesit me baze çimentoje të miksuar me uje të pastër në masën 25-30% të peshës, për të përftuar një miks homogjen kokrriza. Të qendrojë për rreth 10-15 minuta pastaj të trazohet sërish. Të shpërndahet ngjitesi me anë të një shpatulle me profilet e përshtatshme për shpërndarje të paktën në 80-90% të sipërfaqes së pllakës.
Në rast përdorimi të ngjitesit me dy komponent poleritani pllaka duhet të jetë komplet e thatë; nëse përdorni ngjitës me bazë çimentoje nuk ka nevojë të laget pllaka para shtrimit (vetëm lajini ato në ujë të pastër kur janë tepër të pluhurosura).
Të shpërndahet ngjitesi në një sipërfaqe të vogël (rreth 2 m^2 për çdo shtrim) dhe pastaj të vendoset pllaka në stuko akoma të freskët duke përdorur një mall të mirë. Në rastin kur stuko/ngjitësi ka formuar një cipë të lehtë të hiqet nëpërmjet përdorimit të spatulës. Të vendosen pllakat cep më cep gjatë shtrimit të hapësirave të ngushta si dhe distancuesit e duhur në formë kryqi sipas hapësirës.
Defekte të vogla të shtrimit, si dhëmbë apo distancues jo të barabartë mund të korrigjohen brenda kohës së mpiksjes së ngjitësit. Të vendoset bojaku ndërmjet hapësirave të pllakave me trashësinë e duhur.

11.8.6 Pajisjet e prerjes së pllakave

Të mundësohet prerësi i duhur i pllakave për punë. Të ofrohet sipas udhëzimeve për të kompletuar dhe përfunduar shtrimin e pllakave. Të mundësohen bulona dhe tako druri, përveç rasteve kur tako e drurit mund të ndikojnë në sipërfaqen e pllakave të murit. Këndet e brendshme duhet të jenë kuadratike dhe këndet e jashtme të rrumbullakosen duke përdorur pajisjen e duhur prerëse.

11.8.7 Agregatet

Rëra për pergatitjen e llaçit s'duhet të kalojë sitën 16.

11.8.8 Çimento portland

E bardhë për ngjitje dhe gri për përdorim tjetër.

11.8.9 Shiritat ndarës prej metali

Me majë të rëndë të llojit terrazzo, prej bronzi ose aliazh zinku, rreth 2mm me 6mm trashesi dhe thellësi të barabartë me trashësinë e pllakave plus vendosjen në bazament.

11.8.10Plintuset-pragjet

Mermer i fortë dhe i bollshëm për shtrim brenda minimumit 25mm i trashë për shtrim dhe 13mm i trashë për shtrime të holla, vetëm nëse nuk udhëzoheni ndryshe. Rrumbullakosja e këndeve bëhet për fluks shkeljeje. Ndërsa ai i gomuar për ekspozim të jashtëm. Pjerrësia e skajeve vertikale maksimalisht deri në 13mm në lartësi, ose sipas udhëzimeve.

11.8.11Llaçi dhe mbushësi

Llaçi për vendosjen e pllakave

Llaç me çimento portlandi
Set i thatë të llaçit me çimento protlandi i përzier që në fabrikë.

Ngjitës organike –përdorimi i ngjitesit organik është i limituar në aplikimet e murit

11.8.12Mbushësi

Çimento portlandi;
Rërë e çimentuar portlandi; Kuader per pllaka dhe mbushje; Që nuk lënë njolla;
Neutrale ndaj mjedisit.

11.9 VINILI

11.9.1 Ngjyrat dhe modelet

Ngjyrat e vinilit dhe modelet duhet të zgjidhen sipas katalogut dhe standarteve të fabrikës. Ngjyrat dhe modelet tregojnë referencën për identifikimin fabrikës që e ka prodhuar, modelin, emrin e prodhuesit dhe nuk kane kufizim për të mos marrë ngjyra apo borja vinili dhe produkte të ngjashme

11.9.2 Shtrimi i dyshemeve me PVC

Dysheme PVC anti-statike Homogjene
Shtrimi i dyshemesë me pvc duhet të bëhet me rregulloret e tanishme dhe udhëzimet e mbikëqyrësit të punimeve. Shtrimi i dyshemesë sipas markimit të çetifikimit Evropian CE (EN 14041), duhet të kryhet nëpërmjet një gome anti-statike homogjenë ose nga shtresë dopio të presuar PVC- të kalandruar (EN 649), për higjenizim dhe jetëgjatesi të madhe.
Dyshemeja duhet të ofrohet me një trashi totale minimumi t=2.00 mm (EN 428), me një grup T të rezistencës ndaj gërryerjeve (EN 660-2). Shumë rezistente ndaj trafikut, jo poroze dhe e vulosur me poliuretan të pastër. Kjo dysheme nuk do të ketë nevojë për dyllosje dhe mirëmbahet lehtësisht. Falë kualitetit të lartë të materialeve dhe sipërfaqes që mund të rinovohet pas një

pastrimi të thatë. Vetitë jo rrëshqitëse të dyshemesë janë konform standardeve EN 13893 (≥0,3 μas që kërkohen nga markimi CE), R9 në përputhje me normat DIN 51130, reagimi ndaj zjarrit (EN 13501-1) Bfl s1 e ngjitur në mbështetëse kundra zjarrit dhe fiziologjikisht anti statike sipas (EN 1815) <2KV. Material i natyrës kompakte do të ofrojë karakteristika kundër bakteriale në përputhje me normat (DIN EN ISO 846-A/C. Shtresat dhe dyshemeja nuk do të saldohet me shtratin me të njëjtën ngjyrë apo kualitet me qëllim pasjen e një sipërfaqe monolitike që përfshin edhe bashkimin me faqet e murit të jenë tërësisht kundra ujit.
Dyshemeja duhet të jetë prodhuar nga fabrikat e çertifikuara sipas standardeve ISO 9001 dhe ISO 14001 dhe duhet të ketë këto vlera standardesh.

Mbetje gjurmësh	EN 443	Përreth 0.03 mm
Ngrohje nëndysheme	EN ISO 717/2	Përmbushë - max27°C
Rezistencë ndaj kimikateve	EN 423	Mirë
Qëndrueshmëri të dimensionit	EN 434	≤ 0,40% për fletët
		≤ 0,25% për pjata
Përmirësim akustik	EN 140-8	d dB
Përçim termal	EN 12667/DIN 52612	përreth. 0.01 m2/KW
Siguri ndaj dritës	EN ISO 105-B02	≥ 6
Dhome të pastër testimi	ASTM F51/00	Klasi A

Dyshemeja duhet të ngjitet me një ngjitës të veçantë me bazamentin e dyshemesë, të jetë kompakte, e thatë, pa plasaritje dhe e izoluar nga lagështia. Përdorimi i ngjitesve dhe adeziveve duhet të bëhet në përputhje me llojet e përdorimit sipas kërkesave të prodhuesve. Me qëllim përftimin e një shtrese uniforme të dyshemesë do të shtrohen një seri shtresash, me shtresa të kundërta në jo më pak se 24 orë pas përshtatjes në një temperaturë jo më të ulët se 18° Celsius. Dyshemeja nuk do të lahet përveç se me ndihmën e detergjenteve që nuk kërkojnë përdorimin e rrëshirës metalike.

Dysheme PVC statike Homogjene
Shtrimi i dyshemesë për tu çertifikuar me vulën CE (EN 14041), duhet të kryhet nëpërmjet përdorimit të gomës jo statike homogjenë nga shtresë dopio të presuar PVC të kalandruar (EN 649), me një shtresë të veçantë (karboni të zi), ngjyra zgjidhet prej Mbikëqyrësit të punimeve. Falë aftësive ndaluese-statike të dorezës së zezë dyshemeja do të lejojë vendosjen e shtresave me një stuko/ngjitës normal(stuko/ngjitës elektro-përçues në kuti ose enë).
Dyshemeja duhet të pajiset me një trashësi totale minimale prej 2.00 mm (EN 428), në 200 fletë cm(EN 426) me një rezistencë kundër gërryerjes të grupit P (EN 660). Shumë rezistente ndaj trafikut, jo-poroz dhe vulosur me poliuretan të pastër. Dyshemeja e tillë nuk ka nevojë të kërkojë rrëshinim dhe mund të mirëmbahet lehtësisht. Në sajë të cilësisë së lartë të lëndëve të para sipërfaqja duhet të jetë e riparueshme vetëm duke kryer një lustrim të thatë. Aftësitë jo-rrëshqitëse të dyshemesë do të jenë në përputhje me EN 13893 (≥0,3 μ siç kërkohet nga standardin CE), R9 në përputhje me normat DIN 51130, reagimi ndaj zjarrit (EN 13501-1) BFL s1 ngjitur në mbështetjen jo statike kundra zjarrit(EN 1815) <2KV. Natyra kompakte e materialit do të sigurojë karakteristika kundër bakteriale në përputhje me DIN EN ISO 846-A / C. Aftësitë e përçimit të energjisë elektrike do të jenë në përputhje me IEC 61340dhe me një rezistence sipas EN 1081 të barabartë me R1≤108 om, gjithashtu në përputhje me IEC 61340-4-1 dhe R≤108 om dhesipas miratimit të metodës SD PS- 2472 me një vlerë prej 106 ≤R≤108 Om. Shtresat dhe

dyshemeja nuk do të saldohet me shtratin me të njëjtën ngjyrë apo kualitet me qëllim pasjen e një sipërfaqe monolitike që përfshin edhe bashkimin me faqet e murit të jenë tërësisht kundra ujit. Dyshemeja duhet të jetë prodhuar nga fabrikat e certifikuarasipasstandardeve ISO 9001dheISO 14001dhe duhet të ketë këto vlera standardesh:

Elektrike Izolimi	VDE 100, pjesë 600	R1 ≥5C104 Om
Gjurme Mbetjesh	EN 443 EN ISO 717/2	përreth. 0.03 MM I adaptuar – maks27°C
Ngrohja e dyshemesë		
Rezistenca ndaj kimikateve	EN 423	Me rezistencë të mirë
Qëndrueshmëri dimensionale	EN 434	≤ 0,40% përtopat ≤ 0,25% përpjata
Përmirësimi i akustikës	EN 140-8	4 Db
Mbrojtja nga ndriçimi	EN ISO 105-B02	≥ 6

Dyshemeja duhet të ngjitet me një ngjitës të veçantë me bazamentin e dyshemesë, të jetë kompakte, e thatë, pa plasaritje dhe e izoluar nga lagështia. Përdorimi i ngjitesve dhe adeziveve duhet të bëhet në përputhje me llojet e përdorimit sipas kërkesave të prodhuesve. Me qëllim përftimin e një shtrese uniforme të dyshemesë, do të shtrohen një seri shtresash, me shtresa të kundërta në jo më pak se 24 orë pas aklimatizimit në një temperaturë jo më të ulët se 18° Celsius. Dyshemeja nuk do të lahet përveç se me ndihmën e detergjenteve që nuk kërkojnë përdorimin e rrëshirës metalike.

11.9.3 Veshja e mureve me PVC

Muret duhet të vishen duke përdorur shtrese PVC-je të ngjeshur me gomë dhe të printuar jo më pak se 0.12 mm (EN 429) veshja e siperfaqes, ngjyrat sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit të punimeve. Shtresa/veshja duhet të mundësojënjë trashësi totale prej 1-2 mm (EN 428), 200 cm shtresat (EN 259). Reagim ndaj zjarrit (EN 13501-1) B-s2 d0 ngjitur në A1 or A2 në mbështetëse dhe panele gipsi. Natyra kompakte e materialit ofron karakteristika kundër bakteriale në përputhje me DIN EN ISO 846-A/C. Mbulesat e murit duhet prodhohen nga fabrikat e certifikuara sipas standardeve ISO 9001 dhe ISO 14001 dhe duhet të kenë këto vlera standardesh;

Rezistence ndaj kimikateve	EN 423	E mirë
Përmirësim akustik	NF EN ISO 354	0.05 (H)
Mbrojtje ndaj dritës	EN ISO 105-B02	≥ 6
Qëndrueshmëria dimensionale	EN 434	≤2 mm
Rezistencë ndaj zjarrit	EN 13501	B-s2 d0

Shtresa e murit duhet të ngjitet me ngjitës të veçantë me siperfaqen e murit, të jetë kompakte e thatë pa plasaritje dhe e izoluar nga lagështia. Përdorimi i ngjitesve dhe adeziveve duhet të bëhet në përputhje me llojet e përdorimit sipas kërkesave të prodhuesve. Me qëllim përftimin e një shtrese uniforme të dyshemesë do të shtrohen një seri shtresash, me shtresa të kundërta në jo më pak se 24 orë pas përshtatjes në një temperaturë jo më të ulët se 18° Celsius. Dyshemeja nuk do të lahet përveç se me ndihmën e detergjenteve që nuk kërkojnë përdorimin e rrëshirës metalike.

11.10MAKINERI DHE PAISJE

1. Makineritë Automatike të Saldimit per instalimin e Vinilit të jete në përputhje me direktivat kryesore evropiane dhe ndërkombëtare:

Pajtueshmëria me Direktivat e BE-së: Produkti plotëson kërkesat e Direktivës së Makinerive (2006/42/EC), Direktivës EMC për pajtueshmërinë elektromagnetike (2014/30/EU), Direktivën e Tensionit të Ulët (2014/35/EU) dhe Direktivën RoHS (2011/65/EU). Eshte shume e rendesishme qe ngjitja te behet sipas standartit dhe siguris se larte duke qene se eshte ambient spitalor dhe ajo automatizon procesin e saldimit, duke kontrolluar temperaturën dhe shpejtësinë në mënyrë konstante, gjë që garanton që vija e bashkimit të jetë 100% e mbyllur ndaj baktereve dhe lëngjeve.

2. Pajisjet e Dorës me Ajër të Nxhetë (për detaje dhe këndë)

Përdoren për vende ku makineritë e mëdha nuk arrijnë, si këndet e dhomave, rreth kolonave ose ngjitja e coklave (vasketa spitalore).

3. Pajisjet Ndihmëse (Veglat e dorës)

Përveç makinerive elektrike, nevojiten edhe disa vegla manuale për të përfunduar procesin:
Gropëzuesi (Groover): Përdoret për të hapur një kanal të vogël në formë "U" ose "V" në vendin ku bashkohen dy fletët e vinilit, përpara se të fillojë saldimi.
Thika për prerjen e fijes (Skiving Knife): Pasi fia e saldimit është shkrirë dhe ka ftohur pak, kjo thikë përdoret për të prerë tepricën e fijes në nivelin e dyshemesë, në mënyrë që sipërfaqja të jetë krejtësisht e lëmuar.
Guri mprehës dhe udhëzuesi i prerjes: Për të siguruar që prerja e fijes të bëhet në dy faza (prerja e parë kur është e nxehtë dhe e dyta kur është ftohur plotësisht) për të shmangur gropëzimet.

11.10.1Përbërja e vinilit

Dysheme PVC anti-statike homogjene
Përbërja e produktit në përqindje sipas peshës është me 54% përbërës natyral dhe 25.5% produkte të ricikluara. Materiali duhet të jetë 100% i riciklueshëm. Për cilesine e ajrit brenda godinave ai duhet të ketë një përçim >10 g/mc (pas28 ditësh vendosje).
Dysheme PVC statike homogjene
Përbërja e produktit në përqindje sipas peshës është me 51% përbërës natyral dhe 25.5% produkte të ricikluara. Materiali duhet të jetë 100% i riciklueshëm. Për cilësinë e ajrit brenda banesave ai do të ketë një përçim >10 g/mc (pas28 ditësh vendosje)
Veshja e mureve
Përbërja e produktit në përqindje sipas peshës është me 31% përbërës natyral. Materiali duhet të jetë 100% i riciklueshëm. Për cilësinë e ajrit brenda banesave ai do të ketë një përçim>10 g/mc (pas28 ditësh vendosje)

11.10.2Plintuset - pragjet

Vendosja e PVC-së me skaje gome të përforcuar përsëri me polimerie dhe materiale koherente në një dysheme të zgjedhur. E bashkuar me dyshemene dhe e ngjitur në mur. Ajo siguron pastrimin e lehtë dhe higjienik. Disponohet në të gjitha ngjyrat , për të gjitha produktet. Rezistente ndaj tronditjeve dhe kundra ujit. Kompakte. 60/80/100 x 100 x 2400 mmm

11.11RIFINITURA E SHKALLEVE

11.11.1Shkalle te Jashtme betoni e veshur me Granil/Mermer

Shkallë e jashtme betoni veshur me granil
Dozimi për një m^2 me një trashësi prej 1 cm i dyshemesë me granil të derdhur është: 13 kg çimento të tipit 400, 0.002 m^3 granil dhe ujë, duke përfshirë kallëpet, përforcimin dhe çdo

detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Shkallë e jashtme betoni veshur me mermer

Për veshjen e shkallëve të betonit me mermer duhet të parashikohen këto punë: Në fillim duhet që shkallët e betonit të pastrohen mirë si dhe të rrafshohet vendi. Pastaj duhet që shkalla prej betoni të lyhet me qumësht çimentoje, i cili e lehtëson ngjitjen e pllakave të mermerit. Ngjitja e pllakave të mermerit bëhet ose duke përdorur llaç ose në rast se shkallët e betonit janë të rrafshta, atëherë mundet që këto të ngjiten edhe me kollë. Ngjitja e pllakave të mermerit nuk ndryshon nga ngjitja e pllakave në mur

11.11.2Dysheme/Shkalle te brendshme me Pllaka Mermeri t=2/3cm, te cilesise se pare permasa sipas V.T., te tipit te zgjedhur, perfshire :

- ngjitja pllakave realizohet me llaç,
- prerjen me preres pllakash dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur ndermjet tyre dhe te stukuara me boiake çimentoje ne fugatura,
- larjen dhe pastrimin,
- çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

11.11.3Korimanot Metalike

Korimanot në ndërtime kanë funksione të ndryshme për të plotësuar. Ata duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë të ecurit në shkallë. Po ashtu, korimanot luajnë një rol të veçantë në pamjen dhe bukurinë arkitektonike të një ndërtimi. Duhet që korimonat të jenë të larta 100 cm. Në raste kur gjatësia e shkallëve është më e madhe se 12 m korimonat duhet të jenë 110 cm të larta. Masa prej 100/110 cm varet edhe prej siperfaqes të sheshpushimit. Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëvë, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Në rastet kur shkallët janë më të gjëra se 100 cm, atëherë duhet që përveç korimaneve, vendosen në muret e anës tjetër të shkallëve, parmakë për të siguruar një ecje të sigurt. Parmakët nëpër shkallë nuk duhet të jenë më të ulëta se 75 cm dhe jo më të larta se 110 cm.

11.12PLLAKAT

11.12.1Kontrolli

Te mos aplikohet shtrimi i pllakave para se të kete përfunduar dhe të jenë testuar punimet hidraulike, elektrike ato të ventilimit dhe të ngrohjes, si dhe të jenë montuar vaskat, dushet si dhe te jete testuar me pare sistemi izolimit.

11.12.2Përgatitja

Përgatitja e shtresave

Te mos aplikohet shtrimi i pllakave të dyshemesë në vendet ku do të shtrohen pllaka muri deri sa ato të jenë shtruar. Shtresa duhet të zgjidhet që të përshtatet me shtresën e nëntokës.

Shresat në dysheme betoni.

Te përgatitet me llaç shtrati ku do shtrohen pllakat, para se të vendoset ngjitesi i pllakave.Te mbushen zonat e dyshemesë që nuk janë në nivel. Te vendosen distancues kryq kur ata nevojiten.

Përgatitja e përzierjes së llaçit

Te matet sasia e materialeve për pergatitjen e llaçit në enë të kontrolluar për tu siguruar që masat

e materialeve janë të mbajtura dhe kontrolluara siç duhet - matja e materialeve me anë të lopatës nuk është e lejueshme. Nëse nuk specifikohet ndryshe përzierja e llaçit sipas sasive të matura me anë të volumit bëhet në përzierësin mekanik të miratuar ose në kutitë e llaçit. Kontrolli i sasisë të ujit duhet të bëhet në masë dhe uniformitet.

Depozitat e kripës në mure

Depozitimet e kripës nga thellësia duhet të hiqen nëpërmjet një furçe të ashpër jo metalike pasi muri është thare sic duhet.

11.13 VENDOSJA / SHTRIMI

11.13.1 Pllakat e dyshemesë

Llaçi i çimentos portland: te nivelohet ose te pergatitet shtresa sipas udhezimeve. Pllakat nuk duhet të vendosen në llac çimentoje me një lagështi më të madhe se 2%.

11.13.2 Pllakat e murit

Sipërfaqes e murit që do ti vendosen pllaka qeramike pasi ti jetë vënë shtresa e llaçit, e cila duhet të ketë kënde të drejta, te jete e niveluar dhe të mos i kalojë 2.5 mm deformim për metër në një plan të rrafshët. Te perdoret llaç çimentoje portlandi ose tjetër lloj ngjitesi organike.

11.13.3 Fugat

Te behet nje nivelim, paralel , me plumbce, nivelues ne nje rresht. Te vendoset lidhese fundore dhe ato në qendër dhe midis pllakave nëse është e mundur, për aq kohë sa është e zbatueshme. Te vendosen pllakat e drejta me lidhesa të drejtë dhe ato të prera me bashkues të prerë. Lidhesit drejtues duhet të ndjekin dhe vendosen vetëm mbi shtresen e llaçit.

11.13.4 Gjerësia e fugave

Fugat duhet të jenë uniform për shtrimin e pllakave me një minimum prerje por duke ruajtur standardin që të mos lejoje ngatërrimin midis shtresave dhe të mozaikut qeramik të pllakave.Te krijohen fuga si me poshtë,:
Vendosja e pllakave: siç përcaktohet për distancën e vendosjes.
Pllakë qeramike e pa rreshkitshme : siç përcaktohet në
hapesirat ndarëse. Pllaka guri: 6 mm minimumi dhe gjerësi
maksimale 10 mm
Veglat dhe njësitë prerëse; në përputhje me llojin dhe madhësinë e pllakave.

11.13.5 Mbushesit dhe fugat

Te parashikohen fuga ekspansioni dhe kontrolli gjate shtrimit.
Te aplikohen fuga ekspansioni dhe kontrolli gjate shtrimit si me poshte:
Te vendoset mbushes fuge me performancë ose materiale mbushese në thellësi të fugave për të siguruar izolim dhe lidhje te mire.
Para mbushjeve, fugat duhet te jene te hapura dhe te pastra, të përdoren letra apo materiale te tjera për të mos lejuar bllokimin e tyre.
Pasi mbushja e pllakës te jete tërësisht e thatë, te hiqet letra ose materiali tjetër si mbushës të përkohshëm; te pastrohen nyjet me një furçe të pastër dhe ose të mbushen me material izolues.

11.13.6Shiritat ndarës metalik

Te vendosen shirita ndarës metalik në shtratin e llaçit ndërkohë që shtrati është në gjendje plastike. Te vendosen ndarëset sipas udhezimit, në drejtimin e duhur, me linjë të pashkëputur, rrafsh me sipërfaqen dhe papërfunduar të dyshemesë. Te vendosen shirita ndares atje ku pllakat e dyshemese kufizohen me tipe te tjera shtrimi, përveç se hapesirave ku jane parashikuar pragjet e dyerve.

11.13.7Pragjet

Te vendosen kulmet me pamje nga prerjet në të dy krahët e hapjes. Te vendosen pragjet në shtratin e çimentos në mënyrë të përshtatshme me llaçin e dyshemesë.

11.13.8Fiksimi i nyejve bashkuese

Fuga midis pllakave të dyshemesë ose te mureve dhe fiksimi i tyre (psh.në banjë) duhet të jete e pa depertueshme nga uji, si dhe elastike, nqs nuk specifikohet ndryshe. Piletat e dyshemeve duhet te rrethhen nga pllakat dhe te kene nje pjerresi te lehte.

11.13.9Fugat elastike

Fugat e elasticitetit duhet të vendosen në të gjitha pikat ku tubat kalojnë, nëntokë apo poshtë materialeve të tjera. Gjithashtu fuga e elasticitetit duhet parashikuar edhe atje ku kthehen tubat. Kulmet e fugave duhet te ngjiten ne te gjitha pikat duke perdorur shirit adeziv. Nyjet duhet të jenë të pastra nga depozitimet e mbushesit. Mbushjet ne fugat elastike duhet të përputhen me pllakat dhe me materialet që e rrethojnë. Në raste shkallësh nyjet elastike duhet të parashikohen midis pllakave te shkalleve dhe plinusave.

11.13.10 Ngjitja poshte fiksuesve

Te parashikohet ngjitje poshte vaskave dhe pllakave te dusheve.

11.13.11 Veshja ne zonat me lageshti

Gjate veshjes me pllaka ne zonat me lageshtire, duhet treguar kujdes qe te mos lihen boshlleqe ne shtresat ku do te vendosen.

11.13.12 Gjeometria e motivit të shtrimit

Në përgjithësi shtrimi i pllakave do të përcaktohet paralelisht me shtrimin e mureve, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe. Aty ku eshte e mundur, fugat e pllakave te dyshemese duhet te jene te vazhduesme me fugat e mureve. Kontraktuesi duhet të konfirmojë synimet e tij me Mbikëqyrësin e punimeve para fillimit të shtrimit të pllakave. Në qoftë se pllakat janë të lugeta nga poshtë atëherë duhet te konsiderojmë që gjithe të tjerat te kenë marrë të njëjtin drejtim

11.13.13 Përdorimi i copave të prera të pllakave

Vetëm copat më të mëdha se gjysma e madhësisë së pllakave kryesore mund të përdoren. Përdorimi i copëzave të vogla si mbushje të pllakave duhet të shmanget.

11.13.14 Fugat e ekspansionit

Fugat e ekspansionit duhet të vendosen çdo 4 metra.

11.13.15 Prerja e cepave

Të gjithë cepat e dukshëm ne pllakat e mureve duhet te priten me element preres, vetem nëse cepat kanë specifikë pllake te lemuar.

11.14PASTRIMI

Pas përfundimit të shtrimit çdo njëra dhomë duhet të pastrohet dhe lahet me furçë, të gjitha mbeturinat duhet të hiqen.
Larja me acid duhet të bëhet në pllakat që janë të pa lëmuara dhe duhet bërë jo më vonë se 14 ditë pas vendosjes së pllakave.

11.15MBROJTJA

Gjatë shtrimit të pllakave të gjitha fugat duhen ruajtur që të mos u futet llaci etj, Te mbulohen sipërfaqet e përfunduara me pllaka me leter 1.45 kg për m^2për të ruajtur dyshemenë nga shenjat e shkeljes.

Te vendosen shirita (pllaka druri) përsipër vendit ku shkelet më se shumti ne dyshemetë e korridoreve që duhet të përdoren nga punonjësit. Te mbulohen me derrasa, pragjet prej mermeri Te mbrohen cepat e veshur, këndet e jashtme me anë të shiritave në qoshe (pllaka druri)për kalimin e punëtorëve.

PJESA 3 – ZBATIMI - PVC

11.16NGJITJA

Dyshemetë e përshtatshme për shtrimme me pvc të karakterizuar nga sipërfaqe të lëmuara. Shtrimi nëpërmjet përdorimit të ngjitësit është metodologjia më e zakonshme e shtrimit dhe siguron karakteristikat e vlefshme teknike së bashku me një shpejtësi shtrimi. Ky lloj shtrimi është i kufizuar kur nënshtresa ka tendence lagështie të lartë (duke pasur parasysh kufirin maksimal të pranueshëmtë lagështisë prej 2% në shtratin e dyshemesë që do shtrohet), si dhe në përgjithësi kur shtresa është e shkrifët , me pluhur ose kur mund të krijojë plasaritje.

11.17LLAÇI

Ajo duhet të vendoset në një plan të sheshtë të fortë, rezistente ndaj goditjeve pa plasaritje me lartësinë e duhur e thatë dhe e pastër; trashësia minimale e kërkuar është midis 4 dhe 6 cm.
Në rast të sistemeve hidraulike ose kalimit te sistemeve te tjera, elementët do të përfshihen në të paktën 6 cm trashësi të shtresës, te vendoset rrjete përforcuese prej çeliku. Gjithashtu një shtresë polietileni duhet të vendoset poshtë shtresës izoluese që per te lejuar perdorimin sa me te pak gjendjes se lengshme te çimentos dhe të funksionojë si barrierë për avujt që ngrihen.

Parametrat qëkërkon shtresa izoluese		
Lloji i mbështetjes	**Izolim betoni**	**Sipërfaqe e rrafshët**
Toleranca e sheshtë : **2,0 m anë të drejtë** **0,2 manë të drejtë**	 **7,0 mm** **2,0 mm**	 **Niveli i tolerancës** **C.C.B.A. 68**
Gjendja e mbështetjes mbi sipërfaqe	**E rregullt dhe fine**	**Pozicioni i nivelit duhet respektua**

Punimet shtesë		**Përfundimi i rrjetës**
Performaca të garantohet nga ekzekutuesi i punimeve	**Trashësia mesatarecopëzat**	**Copëz e hollë e prerë pas përfundimit**
Lagështia e lënë	**MAKS 2%**	**MAKS 2%**
Tolerancat e **pllakave 2,0 m anë** **të drejtë** **0,2 m anë të drejtë**	 **7,0 mm** **2,0 mm**	 **5,0 mm** **1,0 mm**

11.18NIVELIMI

Në mënyrë që të reduktohen dallimet në lartësi, ashpërsi te tepruar të sipërfaqes se llacit , se pari nevojitet nivelimi i shtreses. Para se te nivelohet te pastrohet teresisht siperfaqja. Produktet për nivelim mund të pergatiten në vendin e ndërtimit, nga përzierja e çimentos, stukove me bazë akrilike, agregateve me një madhësi grimce shumë të ulët, ose furnizimit me pluhura të gatshme të përziera. Aplikimi i nivelimit për disa milimetra pergjate shtreses te behet nepermjet spatules, në mënyrë që të marrë një sipërfaqe të përshtatshme stukoje. 24 orë pas nivelimit sipërfaqja duhet fërkuar me rërë, për të hequr çdo ashpërsi të vogël të mbetur dhe pastaj pastrimi me produkte pastrimi. Gjithmonë pastrimi me vakuum duhet të bëhet në përputhje me udhëzimet e fabrikës.

11.19NGJITËSIT

Ngjitës te ndryshem mund të përdoren sipas kushteve të përdorimit dhe zonat e ndërtimit. Akrilik i holluar në ujë

Akrilik i holluar në ujë përbëhet nga një polimer akrilik i holluar në ujë. Ai mund të ndërpritet nga avullimi i ujit që ato përmbajnë, për këtë arsye ata kanë nevojë për porozitet. I përshtatshëm vetëm për përdorim te brendshem, mbi llac cimento , ekspozuar ne trafik të lehtë dhe aplikim te tepruar uji

Ngjites epoksid bi-komponent

Përbërëset nga një polimeringjitës (pjesa A) i cili stabilizohet kur përzihet me një katalizator (pjesa B). Ajo ndërpret reaksionet kimike mes dy përbërësve. E përshtatshme për perdorim të brendshem mbi llac cimento, ekspozuar ne trafik mesatar /te rende

Poliuretan bi-komponent

Përbërë nga një polimeri poliuretani (pjesa A) që stabilizohet/rregullohet kur të përzihet me një katalizator (Pjesa B). Ai ndërpret nga reaksionet kimike mes dy përbërësve. I përshtatshëm si për aplikimet te brendshme dhe të jashtme, mbi shtresa te natyrave te ndryshme, ekspozuar ne trafik te renduar.

Polikloroprene gome sintetike (neoprenë)

I bërë nga tretësira e neoprenit. Ajo ngurtësohet nga avullimi i holluesit dhe absorbimi nëpërmjet materialeve poroze. Duke pasur parasysh vendosjen e tyre të shpejtë, këto ngjitës (të duhet të jenë të veshura në të dy sipërfaqet për tu lidhur bashkë) mund të përdoret për shtrimin e aksesorëve (plintusat, veshjet e shkalleve etj).

Përdorimi i ngjitësit

Për përgatitjen dhe zbatimin e ngjitëseve të ndryshme, ndiqni me kujdes udhëzimet e prodhuesit. Shtrimi i ngjitësit duhet të bëhet me anë të shtresave në mënyrë të rregullt, me përdorimin e shpatullës së dhëmbëzuar dhe sipas udhëzimeve të mëposhtme të prodhuesit të ngjitësit.

Shpatulla duhet të zëvendësohet sa më shpejt në momentin që dhëmbët fillojnë të veshin cipën.

11.20 VENDOSJA

Shtrimi i ngjitësit/stukos duhet të kryhet nga operatorët e specializuar, në përputhje me hapat e mëposhtme: vendosja e materialit (parket dhe ngjitëse/stuko) në dhomë të paktën 48 orë para shtrimit, temperatura e brendshme nuk duhet të jetë me pak se 15 ° C,
te sillen ne kend te drejete linjat brenda dhomes, si dhe te venosen udhezues,
te aplikohet shtrimi i thate (pa ngjitës/stuko) të shtresave të dyshemesë të paktën 24 orë para shtrimit nëpërmjet 1.0 cm të mbuluar,
për të kontrolluar uniformitetin ngjyrën dhe paraqitjen e
dyshemesë, te priten mbivendosjet e kulmeve,
te mblidhen rolete deri ne
gjysem, te vendoset
ngjitës,
te shtrohen rolete duke u trokitur lehte nga qendra tek skajet për të hequr
bulëzat e ajrit, te perseritet veprimi per gjysmen tjeter te rolese,
pas shtrimit të sigurohet kontakt sa më i mirë me shtresën e
dyshemesë, te ushtrohet peshe gjate shtrimit te stukos

12 RIFINITURA E TAVANEVE

PJESA 1 – TË PËRGJITHSHME

12.1 REFERENCA

Publikimet e Listuara me poshtë formojnë një pjese të specifikimeve dhe referencave shtesë Publikimet që referohen në këtë tekst janë vetëm ato themelore.
Zbatimi i normave dhe ligjeve shqiptare Normat dhe standartetEvropian

DIN 1748	Ndërtimi i xhamave – produktet speciale bazë - Pjesa 1: xhama borosilikatë Xhami në godina – Produktet speciale bazë- Pjesa 2: Qeramika e xhamit
DIN 18168-1	Kundër tavanet dhe tavanet veshjet e tavaneve të lehta
DIN 4102	Sjellja ndaj zjarrit të materialeve të ndërtimit dhe elementët – Klasifikimi i materialeve të ndërtimit–Kërkesat dhe testimi
DIN EN 485-1	Pllakat dhe fletët e aluminit dhe produkteve të tij; kushtet teknike të dhëna
DIN EN 1396	Alumini dhe materialet prej alumini – fletët e lyera për përdorim të përgjithshëm - Specifikimet
ISO 1461	Artikujt e çelikut të prodhuara me galvanizim të nxehtë– Specifikimet dhe metodat e testimit
VDI 3755	Izolimi dhe thithja e zhurmave tek tavanet e varur

12.2 PARAQITJET

Te paraqiten si me poshte:

Vizatime teknike Të dhënat Mostrat/modelet
Sistemi i amortizimit
Te paraqitet sistemi i kapjes dhe metodat e lidhjes dhe bashkimit si dhe planet e tavanit.
Nga dy shembuj për çdo të njësi kapse, tekstura dhe ngjyra përfundimtare.
Certifikatat
Zjarr durueshmeria
Raportet dhe certifikatat e testimeve

12.3 DORËZIMI DHE MAGAZINIMI

Njësitë e dorëzimit të dërgesave nga fabrika origjinale duhet të jenë në kontenier të pa hapura së bashku me emrin dhe llojin të shënuar dhe të dukshëm plotësisht. Te mirembahen me kujdes materialet dhe te ruhen ne te thate. Vetëm 24 orë para vendosjes materialet duhet të dalin nga magazina dhe të vendosen në të njëjtën temperaturë dhe lagështi si hapësira ku do të instalohen.
Mostrat e materialeve të përcaktuara do të furnizohen në llojet e parashikuara nga projekti të shoqëruara nga dokumenti që vërteton se ata plotësojnë kërkesat. Para se të porositen materialet, mostrat duhet të miratohen.
Për 24 orë para, gjatë, dhe 24 orë pas instalimit të njësive ruaj temperaturën dhe lagështinë relativetipikesi kushte shërbimi. Puna e përfunduar brendasi suvatimin, betone dhe tarraca duhet të përfundojë dhe të jetë e thatë para instalimit. Lagështia relative duhet të jetë më pak se 80%. Punimet e tjera Mekanike, elektrike, mbi vijën tavanit duhet të kenë përfunduar dhe miratuar para fillimit të instalimit të tavanit.

PJESA 2 - PRODUKTET

12.4 TAVANET E VARUR

Pllake gispsi standarte
Pllakat e gipsit për tavanin do të jetë e përbërë nga pllaka të sheshtë parafabrikuara, të mbushura me kompleksin të stabilizuar gipsi të përzier, të veshura në të dy anët me fletë të veçanta kartoni. Ajo duhet tëketë Karakteristikat qëduhet të plotësojnë kërkesat. Këto lloje të tavaneve të rreme duhet të jenë fikse të montuara me anë të vida vetë shpimi në një strukturë të përbërë nga profilet metalike korniza dopio, të varura në trarët e tavanit, sipas specifikimeve të projektimit, ose nëpërmjet kllapave të varura. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fundit të nyejve midis paneleve dhe në mes të paneleve, si dhe mureve të dhomës. Pas instalimit, sipërfaqja duhet të jetë krejtësisht e rrafshët.

Për aplikimet e jashtme borde/pllaka të veçanta të papërshkueshmenga uji do të përdoren, me një bërthamë rezistuese ndaj ujit dhe veshje të papërshkueshme nga uji, rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe ta ketë përthithjen e ujit jo me të ulët (<3%) për ndërtimin e mureve, tavaneve dhemureve ndarëse medendësi të lartë,jashtë shtëpisë aponë mjedise ku lagështia është e lartë (pishina, SPA ...),rezistente ndaj mykut, rezistente ndaj prishjes. Karakteristika të tjera do të jenë:

- Rezistence (EN15283-1): ngarkesa e thyerjes gjatësore> 500 N, thyerja nga ngarkesa transversale> 250 N,
- Rezistenca në ngjeshje ≥ 10 MPa,
- Sistemi akustik në përputhje me gjeometrinë e sistemit,
- Rezistence ndaj zjarrit (EN13501-1): Euroclass A2-s1, d0,
- Pesha: 10,8 kg / m^2,

- Përçueshmëri termike (EN125224): λ 0,25 Ë/mK,
- Rezistenca termike: R 0,05 m2K / Ë,
- Përballimi maksimal i ujit pas 2 ore zhytje totale: <3% peshës së pllakës,
- Përshkueshmëria nga avujt e ujit: 220 g / m2 / ditë,
- Rezistencanga Faktori avull (EN12572): μ = 11

Variacionet dimensionale deri 20°C nga 65% deri 90% RH (EN318): gjatësor 0,15 mm/m, transversal 0,11 mm/m
Rezistencë ndaj temperaturave të ulëta: pa u krisur
Rezistenca ndaj mykut: 10/10 (rezistenca maksimale sipas ASTM D3273).

Fiber minerale
Tavani i varur pozicionohet në lartësi deri në 3 m, e arritur nëpërmjet furnizimit dhe instalimit të pllakave fibër minerale 60x60 ose 30x120 cm, trashësi 15 mm, klasa 1, dekoruar me pamje të dukshme, përfunduar në fabrikë me një shtresë dhe i lyer me dy duar bojë akrilik të bardhë, nuk përmban asbest është pjekur në furrë në temperaturë të lartësë bashku me strukturën mbështetëse të fshehur, duke përfshirëedhe mbështetës të strukturës, kapëset përdhe varjen nëtavan dhe çdo pajisje tjetër të nevojshme.
Llojet e ndryshme të elementeve modulare duhet të përdoren sipas kushteve të ndryshme të përdorimit: për shërbime mjekësore dhe zona lidhëse - A2-s1, d0 rezistence ndaj zjarrit të klasës (EN13501-1), Rei 120, thithjen akustike αë 0,95 (EN ISO 11654), përçueshmëri termike λ 0040 W / mK (EN 12667), rezistenca ndaj lagështisë deri në 95% RH, sterilit të klasit dhoma 4 (ISO 14644-1);
për dhomat e gjumit, trajtimin dhe zonat e punës të stafit - A2-s1, d0 rezistence ndaj zjarrit të klasës (EN13501-1), Rei 120, thithjen akustike αë 0,65 (EN ISO 11654), përcjellshmërisë termike λ 0,052-0,057 W / mK (EN 12667), rezistenca lagështisë deri në 95% RH, sterile dhomë të klasës 4 (ISO 14644-1); për dhoma teknike - A2-S1, d0 zjarri rezistenca klasës (EN13501-1), thithjen akustike αë 0,65 (EN ISO 11654), përçueshmëri termike λ 0,052-0,057 Ë / mK (EN 12667), rezistenca e lagështisë deri në 95% RH; për korridoret dhe zonat e pritjes - A2-s1, d0 ose C-s1, d0 rezistence ndaj zjarrit të klasës (EN13501-1), thithjen akustike αë 0,65 (EN ISO 11654), përçueshmëri termike λ 0,052-0,057 Ë / mK (EN 12667) lagështisë deri në 95% RH; për banjë, laboratorë dhe mjedise me lagështi shtëpie - A2-s1, d0 zjarri rezistenca klasë (EN13501-1), REI 120, thithjen akustike αë 0,90 (EN ISO 11654), përçueshmëri termike λ 0040 W / mK (EN 12667), lagështirës deri në 100% RH, sterile të klasit dhomës 3 (ISO 14644-1)

12.4.1 Sistemet e kapjes

Kërkesat e mëposhtme:
Lloji: rrjeta e ekspozuar në çelik ose Alumin të galvanizuar. Klasifikimi Strukturor: Punime te lehta
Rifinitura: Sipërfaqet e ekspozuara nga pamja duhet të jenë uniforme në gjerësi dhe të lyera me ngjyrë të bardhë
Aksesorët: të mundësohen anët standarde të prodhuesit për mure ose përfundimet.
Mundësia e arritjes: Panelet jo më pak se 600 me 600 mm në madhësi brenda një rrjete prej 24 me 32 mm dhe që të mundësojnë akses të drejt për drejtë mbi tavan. Të gjitha panelet brenda rrjetës duhet të jenë të lëvizshme nëpërmjet hapjeve të paneleve.

Varëset dhe pjesët e varura
Çelik i thurur, alumin i lyer me zink ose kadmium, shufra hekuri të sheshta me brima të vendosura në to për rregullimin e lartësisë nëpërmjet vidave, shufra hekuri të sheshta ose të rrumbullakëta.

Çelik i lyer e zink në profilet “C” dhe“U”, i cili përmbush rregulloren EN 10142, me fuqi në zgjatim 270 N / mm, i klasifikimit cilësi e 1 re, lloji i profilit FeP02 G. Lyerja e zink përmbush fuzionin e parë sipas UNI 5753- 84, me Zn 98% cilësia (UNI 2013). Të gjitha sipërfaqet janë të ruajtura nga acidi kromik dhe nga pasivizimi, vaisja në profile, 72 orë rezistencë ndaj spërkatjes me cipë, trashësi çeliku 0.6 to 0.8 - 1.0 mm me toleranca të kontrolluara.
Telat 2.7 mm në diametër me çelik ta galvanizuar më një shtresë të lehtë zinku komercial.

12.4.2 Materialet

Njësitë e kapjes pezull

Vendosja e paneleve sipas konfigurimit (vetem per ambjente te thata)
Të mundësohen panelet e gipsit të prodhuara nga materiale prej azbestosi 600 mm të gjera, 15 cm të trasha, me anë të smusuara
Kërkesat e mëposhtme:
Lloji: standardi me gips pa azbestos. Te lyera. Ngjyra e bardhë Forma: kuadrate
Klasi: 1, i padjegshëm.
Reduktimi i zhurmave dhe koeficienti i tyre: Minimumi 0,60.
Madhësia normale: 600 me 600 mm.

Vendosja e paneleve sipas konfigurimit (vetem per ambjente me lageshti)
Të mundësohen panelet e gipsit të prodhuara nga materiale prej azbestosi 600mm të gjera, 15cm të trasha me anë të rrumbullakosura.
Kërkesat e mëposhtme:
Lloji:standardi me gips pa azbestos. Te lyera. Ngjyra e bardhë Forma: kuadrate
Klasi: 1, i padjegshëm.
Ulja e zhurmave dhe koeficienti i tyre: Minimumi 0,60. Madhësia normale: 600 me 600 mm.

Sistemet e Varura

Kërkesat e mëposhtme:
Lloji: rrjetë e ekspozuar me alumin të galvanizuar në çelik. Klasifikimi strukturor: Detyrë e lehtë
Përfundimi: Sipërfaqet e ekspozuara për të parë duhet të jetë e një gjerësie uniforme dhe me ngjyrë të bardhë.
Aksesorët: të mundësohen përbërësit standarde të prodhuesit për kapjet fundore.
Mundësimi: Panelet jo më pak se 600 me 600 mm në madhësi brenda një rrjete 24 me 32 mm e cila duhet të mundësojë eksesin në hapësirën mbi tavan. Të gjitha panelet brenda rrjetës duhet të jenë të çmontueshme nëpërmjet paneleve dhe aksesit në to.

Varëset dhe pjesët e varura

Çelik i thurur, veshje zinku ose kadmiumi ose kadmium
Telat 2.7 mm në diametër çelik i galvanizuar me një shtresë të hollë zinku.

PJESA 3 - EKZEKUTIMI

12.5 TAVANET E VARUR

12.5.1 Instalimi

Varëset

Të vendosen varëset 1200 mm në qendër të çdo drejtimi. Të vendosen varëset jashtë për çdo dhomë ose hapësirë. Të vendosen varëse të tera aty ku kërkohet për të mbështetur rrjetën rreth kolonave, grilave dhe daljeve të tjera të tavanit. Telat e prera mund të përdoren nëse teli i vendosur me të njëjtin kënd si teli i parëështë i instaluar dhe bashkuar me të njëjtën varëse. Asnjë varëse tjetër ose ngarkesa të tjera mund të varen nga poshtë rrjetës. Aty ku dritat mbahen nga tavani i varur, varëset duhet të jenë prej një minimumi 4 varësesh për dritë dhe të vendosura jo

më shumë se 150mm për çdo cep të dritës. Mbajtëset e drurit nuk duhet të zhyten në kapëset prej druri sepse ngulja e bazës është e ndaluar në mënyrë strikte. Varëset nuk duhet të vendosen tek sherbimet e ndërtesës si per shembull kanalinat e kabllove , tubat, puset etj. Në përgjithësi tavani duhet të jetë i instaluar ashtu siç lejon zgjerimi i kornizes.

Tavanet nën soleta betoni

Varëset e vendosura nën soletat e betonit të përforcuar duhet të instalohen në mënyrë që të mos dëmtojnë përforcimin. Përforcimi duhet të vendoset para instalimit. Varëset nuk duhet të vendosen nën trarë por anash tyre.

Pjesët e varura

Të ruhen te pastra kanalet kryesore dhe shinat nga kufizimet e mureve dhe ndarjeve. Të mundësohen të paktën dy shina kryesore për secilën hapësirë.

Devijimet

Devijimet maksimale te lejueshme e l/500 nuk duhet të kalohen, ku I është hapësira e varëseve.

Njësitë

Cepat e pllakave të tavanit duhet të jenë në kontakt të ngushtë me drejtimin e plotë metalik. Të mundësohen njësitë në mënyrë që ato të cilat janë më pak se 1/2 në gjerësi të mundësohet. Panelet duhet të instalohen në mënyrë që të hiqen me lehtësi.

Kapëset e përkohshme

Gjatë instalimit të lëvizjeve laterale të kornizave duhet parandaluar përdorimi i mberthesave te duhura.

Modulet e mureve ose anesoret

Të instalohen pajisjet murale në hapjet e tavaneve të varura dhe tek sipërfaqet vertikale. Anët ku muret ndërthuren ose intersektohen, te instalohen kendore. Të vendosen perforcuese te sigurta brenda 75mm nga fundet e çdo gjatësie dhe jo më shumë se 400mm në qendër ndërmjet lidhjeve fundore.

Ngjyrimi i Rregullt

Tavanet e përfunduara duhet të kenë ne siperfaqe tonalite të rregullta.

12.6 PASTRIMI I VAZHDUESHËM

12.6.1 Instalimi

Instalimi implikon përdorimin e një strukture metalike të përbërë prej një profili të lehtë metalik (≥ 0.6 mm) me profil të ftohtë dhe të ruajtur nga oksidimi nëpërmjet galvanizimit të nxehtë me zink. Profilet metalike janë të dy llojeve: - guidat "U" 30/15, 30/27, 25/25 të cilat duhen vendosur në mur. – Kolonat "C" 50/15, 50/27, 60/25 duhet të përfshihen në urat dhe të lidhen me pllakat e sipërme me kapëse të varura, me një distancë të barabartë në vartësi të klasit të ngarkesës së përllogaritur.

Kolonat "C" duhet të priten për një gjatësi të barabartë me distancën ndërmjet shufrave të shtuara me 15mm për të mundësuar vendosjen ne varëse.Kur dimensioni i gjatësisë së profilit nuk lejon mbulimin e të gjithë distancës ndërmjet mureve të kundërta, është e nevojshme të vazhdohet me një bashkim lidhës. Ai më pas duhet të kryhet duke përdorur bashkimet lineare dhe duke respektuar rregullat e mëposhtme: bashkimi duhet të jetë i ndërthurur dhe duhet të mundësojë të paktën një fuqi mekanike të njëjtë tek ai profil. Të vendosen kapëset brenda guidave dhe pastaj

të sigurohen tek sistemi i përzgjedhur i varjes. Animi duhet të kryhet pa i futur nga lart nga qendra vendore. Të kontrollohet sheshimi (crregullsitë duhet të jenë më pak se 5mm) dhe horizontalitetin e rrjetës (niveli i ndryshimit në respekt me sheshin e rrjetës duhet =t të jetë më pak se 3mm/m).

12.7 PASTRIMI

Të pastrohen njësitë e bëra pis ose të cilat i ka ndryshuar ngjyra pas instalimit. Të rregullohen gërvishtjet, gërryerjet, hapësirat dhe defektet e tjera tek sipërfaqet e lyera. Të hiqen njësitë e dëmtuara ose të cilat nuk janë instaluar siç duhet dhe të instalohen materiale të reja.

12.8 MATERIALET E MIRËMBAJTJES (MATERIALE REZERVE)

Të furnizohet një modul me tepërt për secilin nga 50 njësitë e instaluara.

13 LYERJA DHE VESHJET

PJESA 1 –E PËRGJITHSHME

13.1 REFERENCAT

Botimet e listuara më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi në masën e marrë si referencë.

- Normat dhe Ligjet e Aplikueshme Shqiptare
- Normat dhe Standardet Evropiane

13.2 PARAQITJET

Paraqitni si më poshtë Vizatimet Teknike

Të dhënat e Produktit

Për secilën lloj lyerje, mbushës, ose produkti tjetër të furnizuar, të paraqiten të dhënat e laboratorit të prodhuesit të bojës të cilat tregojnë se produkti është konform me kërkesat e marra si referencë

Shembujt

Udhëzimet e Prodhuesit Certifikatat

13.3 SIGURIMI I CILËSISË

13.3.1 Shembujt në Terren dhe Testet

Te merret kampioni i 0,5 litrash boje, rastësisht nga produktet e dhëna në kantier dhe t ato për të vërtetuar se produktet ose janëkonform specifikimeve të marra në referencë ose me zëvendësuesin e miratuar. Produktet të cilat nuk janë në përputhje do të largohen nga kantieri dhe do të zëvendësohen me produkte të reja të cilat janë konform specifikimeve të marra si referencë ose një zëvendësuesi të miratuar.

13.4 PAKETIMI, ETIKETIMI DHE RUAJTJA:

Bojërat duhet të jenë në kontenierë të mbyllur të cilët në mënyrë të lexueshme tregojnë numrin e specifikuar të kontratës, emërtimin e përcaktuar, numrin e specifikimit ose formulën, numrin e porcionit, ngjyrën, sasinë datën e prodhimit, numrin e formulimit të prodhuesit, udhëzimet e prodhuesit duke përfshirë ndonjë paralajmërim dhe kujdeset e veçanta, si edhe emrin dhe adresën e prodhuesit.

13.5 KUSHTET MJEDISORE

13.5.1 Lyerjet nga Jashtë

Të mos aplikohet boja në sipërfaqe në momentin kur ka mjegull, mot me shi ose dritë dielli të fortë të drejt për drejtë. Krijimi i hijeve me mbulesa etj do të lejohet vetëm me lejen e Mbikëqyrësit.

13.5.2 Lyerjet nga Brenda

Të aplikohen duart e bojës kur sipërfaqet për ty lyer të jenë të thata.

PJESA 2 - PRODUKTET

13.6 MATERIALET

Bojërat dhe sistemet e lyerjes duhet të jenë të përfunduara në mënyrë qëtë gjithë holluesit dhe bojërat e ndryshme të rekomanduara nga prodhuesi të jenë të përfshira në mënyrë që njësistem i plotë të mundësohet.

Ngjyrat duhet të merren nga Specifikimet Projektit ose të kenë dakordësinë e Mbikëqyrësit.

13.6.1 Boja e Parë, (Nga Jashtë) një dorë

Boja fillestare (nga Brenda), një dorë
Bojë uji, Akrilik më pluhur kuarci (nga
Jashtë) dy duar Bojë Uji Vinil (nga Brenda)
dy duar
Emulsion (nga Brenda) dy duar
Kundër ndryshkut, oksid i kuq plumbi në fara vaji të zier, dy
duar BojëEnamel, (enamel vaj-sintetik) për sipërfaqet
metalike, dy duar Holluesit në bazë tëspecifikimit nga
prodhuesi i bojës
Materialet e heqjes së bojës duhet të jenë pa FCKË

13.6.2 Bojëra Emulsioni

Bojërat e Emulsionit duhet të jenë pa vajra organik, prezervues toksik, algacidike, poroze dhe duhet të kenënjë përshkueshmëri të njëjtë me sd</= 0,02m.

PJESA 3 - EKZEKUTIMI

13.7 PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Të hiqen papastërtitë,copëzat, pjesët e hedhura, vaji, graso dhe ndonjë material tjetër i dëmshëm për performancën e bojës. Nënshtresa duhet të përgatitet për të garantuar cilësinë përfundimtare të bojës.

Defektet e vogla në dhomat me fino të lagësht duhet të mbushen vetëm me material jo mëbazëgipsi. Në rastet kur nënshtresa konsiderohet e papërshtatshme Mbikëqyrësi duhet të njoftohet menjëherë.

13.7.1 Përgatitja e sipërfaqeve metalike (duke përfshirë pjesët metalike të dyerve, dritareve etj.)

Sipërfaqet e Hekurit

Të fshihen të gjitha sipërfaqet. Pastrimi me ujë me presion mund të përdoret për të hequr shtresat e lira dhe ndonjë material tjetër pengues.

Sipërfaqet e galvanizuara vetëm me produkte të oksiduara Zinku: të pastrohen me hollues, avull, ose përzierje pastruese jo alkaline.

13.7.2 Alumini, Të tjera të Pa Galvanizuara, dhe Sipërfaqet jo prej Hekuri

Pastrimi i Sipërfaqes: të pastrohet holluesi dhe të lahet në përputhje me heqjen e mbetjeve nga materiale pastrimi jo alkaline. Sipërfaqet duhet të gërryhen.

13.7.3 Përgatitja e betonit dhe sipërfaqes së çimentuar

Betoni dhe Muratura

Të hiqen substancat e dëmshme si më poshtë: Papastërtitë, Graso dhe Vaji. Sipërfaqet me fino duhet të pastrohen me furça prej bakri para se të lyhen. Parregullsitë e finos duhet të hiqen para se të lyhen.

13.7.4 Pllakat e Gipsit, Fino dhe Stuko

Pastrimi i Sipërfaqes: Stuko dhe Fino duhet të jenë ta pastra dhe pa material të lira; pllakat e gipsit duhet të jenë të thata. Të hiqen papastërtitë dhe pluhuri duke pastruar me një furçë të lehtë duke fërkuar me një leckë të butë para aplikimit të dorës së parë.

13.7.5 Përgatitja e sipërfaqeve ekzistuese të lyera

Sipërfaqet ekzistuese të lyera duhet të përgatiten në mënyrë që lidhjet e duhura të kryhen. Boja e plasaritur duhet të hiqet ose gërryhet në mënyrë që defektet të mos jenë të dukshme pas lyerjes. Ngjitjet elastomerike duhet të lyhen dhe të mos hiqen. Bojëra me bazë vaji duhet të hiqen dhe të mos lyhet mbi to. Heqja e bojës me nxehtësi kërkon lejen e Mbikëqyrësit.

13.7.6 Pastrimi i Fasadës

Te kryhet nje test pastrimi, para fillimit te punimevene fasade. Punimet permanente duhet të jenë të përshtatshme dhe të ruajtura gjatë punimeve të pastrimit.

13.8 APLIKIMI

13.8.1 Aplikimi i shtresave

Të aplikohen materialet lyerëse në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Të punohen tërësisht materialet lyerëse në fuga, gropëza, dhe hapësirat e hapura. Të rregullohen lyerjet e dëmtuara para se të aplikohen duart e tjera. Zonat e brendshme duhet të pastrohen me fshesa dhe pa pluhur para se të dhe gjatë aplikimit të materialit dhe bojërave.
Koha e tharjes: të lejohet kohë ndërmjet aplikimit të duarve të bojës, në bazë të rekomandimit të prodhuesit të bojës, për të lejuar tharjen e plotë, dhe për të mos pasur problem ngjitjeje të dorës së fundit. Të mundësohet secila shtresë në kushtet specifike për të marrë dorën tjetër.

Duart e para dhe Duart e ndërmjetme:të mos lejohen duart e para ose duart e ndërmjetme të thahen për më shumë se 30 ditë, ose më gjatë se rekomandimi i prodhuesit, para se të aplikohen duart e tjera.

Të ndiqen rekomandimet e prodhuesit për përgatitjen e sipërfaqes nëse duart e para ose ato të ndërmjetme lejohen të thahen më shumë se çfarë rekomandohet nga prodhuesi për duart e bojës së mëpasshme. Çdo dorë boje duhet të mbulojë sipërfaqen e bojës së duarve të mëparshme plotësisht, dhe nuk duhet të ketë një ndryshim të dallueshëm në hijet e duarve të mëpasshme.
Sipërfaqet e Përfunduara: të mundësohen sipërfaqet e përfunduara pa rrjedhje, pika, gropëza, shenja furçash dhe ndryshime në ngjyra.

13.8.2 Pajisjet

Të aplikohen duart e bojës me furçat e miratuara, rrulat, ose pajisjet e spërkatjes vetëm nëse nuk specifikohet ndryshe. Të spërkaten zonat ku nuk arrijnëfurçat si për shembull tuat dhe pajisjet e tjera.

13.8.3 Hollimi i Bojës

Bojrat te zvogelohen ne kosistencen e duhur duke shtuar bojë të freskët, përveç se kur hollimi është i detyrueshëm për llojin e bojës së përdorur. Të merret leja me shkrim nga Mbikëqyrësi për përdorimin e holluesve. Leja me shkrim duhet të përshijë sasitë dhe llojet e holluesve për përdorim.

13.8.4 Sistemet e shtresezimit

Sistemet nga Nënshtresat:

Të aplikohen duart e bojës të cilat janëkonform specifikimeve përkatëse të listuara në pikat e mëposhtme: Sipërfaqet e Jashtme Metalike

Sipërfaqet e Brendshme Metalike Betoni i Jashtëm, Tullat e Betonit, Fino Betoni i Brendshëm, Ndërtimet e Betonit,Fino Sipërfaqet e Jashtme me Dru Sipërfaqet e Brendshme me Dru Trashësia Minimale e Bojës së Thatë:

Të aplikohen bojërat, duart e para, bojërat e vajit, enamel, nënshtresat dhe duart e tjera tek një minimum trashësie boje prej 0.0375mm në secilën dorë vetëm nëse nuk specifikohet ndryshe. Trashësia e duarve të bojës aty ku specifikohet i referohet minimumit të trashësisë.

Lista e Produkteve të përdorura:

Te dorezohet nje liste e detajuar të gjitha duarve dhe bojërave të përdorura pas përfundimit të punimeve. Kjo listë duhet të përfshijë, prodhimin, përdorimin, referencën e produktit, furnizuesin & numrin në ngarkim të materialeve për të mundësuar Përftuesin qe të kërkojë përsëri materialet për arsye mirëmbajtjeje.

Rezervat për rregullime:

Te paraqitet një rezervë për secilën shtresë boje të përdorur në ngjyrën origjinale për të lejuar rregullimet e dëmtimeve të vogla të cilat mund të ndodhin para dorëzimit tëgodinës.

13.9 SISTEMET E LYERJES PËR METALIN

Mbikëqyrësi mund të kërkojë që duar të shumta të bojës së mbrojtjes ndaj ndryshkut të aplikohen në ngjyra të ndryshme për të mundësuar verifikimin e numrit të duarve.

13.9.1 Sipëraqet e jashtme metalike

Mbrojtja ndaj ndryshkut: 0.50 mm

E ndërmjetme: gjysmë shkëlqim 0.0375 mm Dora e fundit:gjysmë shkëlqim 0.0375 mm

13.9.2 Sipërfaqet e brendshme metalike

Mbrojtja ndaj ndryshkut - 0.050 mm
E ndërmjetme: gjysmë shkëlqim 0.0375 mm Dora e fundit: gjysmë shkëlqim 0.0375 mm

13.10SISTEMET E LYERJES PËR NËNSHTRESAT E BETONIT DHE TË ÇIMENTOS

Nga jashtë

Dora e parë: 0.0375 mm
E ndërmjetme: (e sheshtë) 0.0375 mm Dora e fundit: (e sheshtë) 0.0375 mm

Nga brenda

Dora e parë:, 0.050 mm
E ndërmjetme:gjysmë shkëlqim 0.0375 mm Dora e fundit:gjysmë shkëlqim 0.0375 mm

13.11MBROJTJA

Ruajtja e Punimeve permanente
Te mbulohet dhe maskohen të gjitha materialet në zonën e punimeve për ti ruajtur ato në mënyrë që të mos preken nga aplikimi i bojës. Çdo njollosje duhet të hiqet menjëherë.
Dyshemetë gjithashtu duhet të ruhen.
Ruajtja e materialeve të djegshme
Ruajtja e materialeve të djegshme në kantier do të diskutohet me Mbikëqyrësin. Heqja e materialeve të magazinuara
Dhomat e përdorura për ruajtjen e materialeve do të pastrohen nga materialet e magazinuara, të pastrohen dhe dorëzohen.

Ruajtja e Xhamave dhe Aluminit
Kur përdoren bojërat me baza vajore duhet të ruhen me kujdes. Ruajtja e ngjitëseve
Ngjitëset për dyert dhe dritaret duhet të hiqen aty ku është e mundur të hiqen dhe të rivendosen pas përfundimit. Ngjitëset e hequra duhet të etiketohen dhe të ruhen me kujdes në mënyrë që rivendosja e tyre në pozicionin origjinal të jetë e sigurt. Aty ku nuk është praktike atëherë ngjitëset duhet të ruhen me izolant. Funksionaliteti i pajisjeve
Ruajtja e pajisjeve si për shembull, menteshat e dyerve, mekanizmat e hapjes së dritareve etj., nuk do të pengojnë funksionalitetin e tyre.
Heqja e materialeve të tepërta
Të gjitha materialet e tepërta duhet të hiqen nga kantieri vetëm nëse nuk tregohet ndryshe.
Lyerja e hershme e pjesëve të mbyllura.
Materialet të cilat do të jenë të fshehura nga ndërtimet e mëvonshme të cilat kërkojnë duar boje duhet të lyhen para se të mbulohen.
Shiriti izolues
Shiriti izolues do të jetë i mundshëm për sipërfaqen të cilën do të maskojë. Reagimi i materialeve duhet të shmanget. Nëse në dyshim testet duhet të kryhen në pjesët e padukshme tësipërfaqes.
Sipërfaqet jo të përshtatshme
Sipërfaqet e mëposhtme konsiderohen jo të përshtatshme për bojën dhe duhet të maskohen gjatë punimeve të bojës:
Shkumat
Ngjitëset Elastomerike
Poliamidja, PVC e butë, Polivinilklorida Polikarbonatet Polietilen

14 DYERT

PJESA 1 – E PËRGJITHSHME

14.1 REFERENCAT

Publikimet e renditura më poshtë përbëjnë një pjesë të këtij specifikimi në sasinë e marr referencë. Botimeve u referohet në tekst vetëm nga përcaktimi i tyre bazë.
Normat dhe
Ligjet e Aplikueshme Shqiptare Normat dhe Standardet Evropiane E përgjithshme

DIN 18101	Dyert; dyert për godinat rezidenciale; madhësia e menteshave të dyerve, pozicioni i menteshave dhe kyçeve, ndërvarësia e dimensioneve
DIN 68121-1/2	Profilet prej druri për dritaret dhe dyert; dimensionet, kërkesat e cilësisë
DIN 68706-1	Dyert e brendshme të kryera nga druri dhe paneleve pre druri – Pjesa 1: Menteshat e Dyerve; konceptet, madhësitë, kërkesat
DIN 18203-3	Tolerancat për godinat; përbërësit e godinave prej druri dhe produkteve me bazë druri, dhe paneleve me bazë druri
DIN 18111	Kornizat e drurit – Kornizat prej çeliku - Pjesa 1: Kornizat standarde të dyerve për dyert e vendosura në ndërtimet prej tulle. Dyert
DIN EN 1522	Dritaret, dyert, grilat, dhe kanatat – Kërkesat dhe klasifikimet

DIN EN 12051	Materialet e Godinave– vidat e dyerve dhe dritareve – Metodat dhe kërkesat e testeve
DIN EN 12207	Dyert dhe dritaret – Kalueshmëria e ajrit - Klasifikimi
DIN EN 12208	Dyert dhe Dritaret – Kalueshmëria e ujit - Klasifikimi
DIN EN 12210	Dyert dhe Dritaret–Rezistenca ndaj ngarkesave të erës - Klasifikimi
DIN 18095-1	Dyert e kontrollit të tymit; konceptet dhe kërkesat
DIN 18093	Barrierat e zjarrit; instalimi i dyerve të zjarrit në ndërtimet kundër zjarrit (muret prej betoni); pozicionimi dhe formatimi i ankorave dhe instalimi
DIN 68706-1	Dyert e brendshme të bëra prej drurit dhe paneleve me bazë druri.
	Çeliku
DIN EN ISO 1461	Lyerjet e galvanizuara me të nxehtë nëçelik të fabrikuar dhe tek materialet e çelikut – Specifikimet dhe metodat e testimit
DIN EN ISO 12944-5	Bojërat dhe llaku – ruajtja ndaj ndryshkut e strukturave metalike me sistemet ruajtëse të bijës – Pjesa 5: Sistemet mbrojtëse të bojës Druri
DIN EN 300	Borde Standarde të Orientuara (OSB) –Përcaktimet, klasifikimet dhe specifikimet
DIN EN 313	Kompensata– Klasifikimi dhe terminologjia - Pjesa 1: Klasifikimi i Kompensatave– Klasifikimi dhe terminologjia - Pjesa 2: Terminologjia
DIN EN 385	Dru i bashkuar me ndërthurje strukturore – Kërkesa performancë dhe kërkesat minimale të produktit
DIN EN 636	Kompensata- Specifikimet
DIN EN 13986	Panelet me bazë druri për përdorim në ndërtim – Karakteristikat, vlerësimi i përputhshmërisë dhe shenjëzimi
	Punimet me Hekur:
DIN 18263	Materialet ndërtimore – mjetet për kontrollimin e mbylljes me zbutje hidraulike
DIN EN 179	Materialet ndërtimore – materialet e daljes së emergjencës të operuara nga një levë shtypëse – kërkesat dhe metodat e testimeve
DIN EN 1125	Materialet ndërtimore – materiale t e daljeve të emergjencë dhe panikut të operuara nga një levë horizontale – kërkesat dhe metodat e testimeve
DIN EN 1158	Materialet ndërtimore – materialet e koordinimit të dyerve – kërkesat dhe metodat e testimeve
	DIN EN 12020-2 Materialet e aluminit dhe me përmbajtje alumini – profilet e precesionit në elementë EN AË-6060 dhe EN AË-6063 – Pjesa 2: Tolerancat në dimensione dhe formë
DIN EN 12365-1	Materialet ndërtimore–Kasketat dhe tërheqja e motit për dyert, dritaret, grilat dhe mbulesat e mureve – Pjesa 1: kërkesat e performancës dhe klasifikimi.

14.2 PARAQITJET

Të gjitha hapjet duhet të maten nga Kontraktori para se të jepet si më poshtë:

14.2.1 Paraqitni si më poshtë

Vizatimet

Teknike
Dyert
Të paraqiten skicat ose të dhënat e katalogut të cilat tregojnëçdo lloj njësie dere me udhëzimet e instalimeve.

Të dhënat e
produktit
Aksesorët
Shembulli i Garancisë
Shkalla e klasifikimit të transmetimit
të Zërit Shkalla e rezistencës ndaj
Zjarrit

14.2.2 Shembujt/mostrat

Para dërgimit të dyerve të drurit, paraqitni një pjesë shembull të secilës lloji dore që tregon stilin, shinën, ngjyrën, përfundimin dhe ndërtimin e brendshëm.
Ngjyrat e përfundimit të dyerve;
Paraqitni një minimum prej trengjyrash. Raportimet e Testeve

14.3 DËRGIMI, MAGAZINIMI DHE TRAJTIMI

Të dërgohen dyert në kantier në kushte të padëmtuara dhe të ruhen nga dëmtim dhe lagështia. Të renditën dyert të shtrira dhe të mbuluara. Mbështetja në blloqe, prej një minimum trashësie 100mm, të vendosur në çdo fund dhe mes të dyerve. Të ruhen dyert në një godinë të mirë ventiluara në mënyrë që të mos ekspozohen ndaj lagështisë së tepërt, nxehtësisë, thatësisë, diellit të drejt për drejtë ose ndryshimeve të tepërta në temperaturë dhe lagështi. Të mos ruhen në një godinë nën ndërtim deri sa betoni, punimet me tulla, dhe fino të jetë e tharë. Të zëvendësohen dyert me defekte dhe të dëmtuara me ato të reja.

14.4 GARANCIA

Garancia duhet të mbulojë dërgimin e dyerve pa defekte siç janë të vendosura në garancinë standarde të prodhuesit.

PJESA 2 – PRODUKTET

Të gjitha dyert duhet të mundësohen në përputhje me kohën e dërgimit të dyerve në bazë të kohës së dërgimit të dyerve në kërkesat e ndërtimit.
Dyert e Çelikut
Dyert e Veçanta
Paneli i Vetëm
Paneli i Dyfishtë
Paneli Rrëshqitës
Dyert që mblidhen

14.5 DYERT E ZJARRIT PREJ ÇELIKU

- Paneli tek
- Paneli dopio
- Paneli rrëshqitës
- Dyert Standarde prej Çeliku

Ndërtimet kryesore do të jenë me përforcuesit vertikal prej çeliku. Dyert duhet të jenë me trashësinë 45mm, vetëm nëse nuk tregohet ndryshe dhe do të jenë prej një përcaktimi të sheshtë. Dyert e jashtme do të kenë anën e sipërme të mbyllur hermetikisht dhe të ngjitura për të parandaluar futjen e ujit.

14.5.1 Dyert e Veçanta prej Çeliku

Dyer të tilla janë të dedikuar për përdorim specifik, janë të kontrolluara elektrikisht dhe në secilin rast kanë doreza tëveçanta si:
Dyert prej çeliku të pa oksidueshëm për sallat e
operacionit; Dyert e jashtme të dhomave teknike.

14.5.2 Dyert ndaj Zjarrit prej Çeliku

Kornizat
Ne çelik të përkulur dhe të galvanizuar 2mm të trashë, të formatuara për tëpasur mentesha të vendosura në një saldimi teli të vazhdueshëm, mbushjen me të nxehtë 2x40, ngjeshjet me tym të ftohtë (opsionale), me bulona fiks.
"Limituesi Termik" një arkitekturë e përbërë nga vrima të vendosura tre fish përgjatë të gjithë perimetrit të kornizës, i cili lejon një ulje thelbësore të transmetimit të nxehtësisë ndërmjet anës së ekspozuar dhe anës së mbrojtur nga zjarri.
Një set standard prej 5 + 5 kllapash muri (5 + 5 + 1 në dyert me hapje të dyfishtë).

Shiritat
Çelik i lyer më parë me një shtresë mbrojtëse, me një shirit të përforcuar nga brenda me një profil "L".
Duke izoluar shtresën e dyfishtë të pambukut mineral, me kalcium-silikat tëvendosur në brendësi ngjitës me një shirit alumini të ndërmjetëm. Mbrojtëset për organet e brendshme si bravat mekanike. Mbulesa e vendosur në kuti duke e kapur nëtëtre anët. Me dy mentesha për fletë. E kryer nga çelik të galvanizuar dhe të shtypur, të kthyer, me një pineskë dhe një sustë për vetë mbyllje. Çdo menteshëështë e vendosur tek ana me bulona çeliku të përforcuar 3+1. Mbajtësetsigurisë në anët e menteshave.
Mbyllja me bravë zjarri në njëpikë mbyllëse (REI 60), ose tre pika mbyllëse (REI 120).

Dy shirita
Çelësi i mbylljes së shiritit, me seri të mbyllura.
Mbyllja e sigurisë dhe gypat e mëdhenj e të vegjël për shiritin
e dytë. Pasha e derës për metër katror 35-40 Kg.

Pajisjet REI 120
Kuadri prej Zinku Elektrik20/10
Izolimi në përputhje me UNI
9723 REI 120 Brava e zjarrit me
tre pika mbyllëse

Cilindri i
pacientit
Çelësi i llojit
të pacientit
Dorezë e brendshme + dorezë zjarri e jashtme me
pllakëza Kllapat për izolim

Lyerja e kuadrit me pluhur ngjitës
Ndërtimi i bravës sëgalvanizuar me rondele për eliminimin
e konsumit Menteshë me sustë për vetë mbyllje dhe
rregullimin e pineskës Paketim i përbërë nga najloni dhe
kutitë e kartonit
Materialet udhëzuese për instalim dhe aksesorët
Daljet e sigurisë dhe kapësët e kuadrove dhe bulonat
mbyllës Kuadri i kasketit vetë zgjeruese: në tëtre anët
Tre bulonat të cilat mbajnë anën e
menteshës Përzgjedhësi i mbylljes së
dyerve
Mentesha për mbylljen lart/poshtë të shiritit të dytë automatik

14.6 AKSESORËT

14.6.1 Grilat

Grilat e brendshme
Grilat duhet të jenë të llojit të vendosura aty ku kërkohet. Fletët e grilave të vendosen në kuadrin e tyre dhe të lidhen me kornizën. Të formohen fletët me çelik të trashë nga 0.9mm deri në 20 trashësi.

14.6.2 Grilat e jashtme

Grilat duhet të jenë të kthyera të llojit Z me një minimum hapjeje prej 30 për qind. Fletët e grilave duhet të ngjiten dhe vendosen në kanalizime të cilat mbrojnë nga uji. Nga grilat e çelikut të galvanizuar me nxehtësi të njëjtës madhësi si hapjet e dyerve.

14.6.3 Ngjitjet

Të mundësohen thurjet rreth dyerve të jashtme dhe të brendshme tek dyert e grilave. Të mundësohen kapjet nga jashtë tek dyert e jashtme dhe në anën e korridorit të dyerve të brendshme.

14.6.4 Dyert e Forta

Të jepet sa më shumë të jetë e mundshme, bravat, menteshat dhe kapësët e njëanshme nga prodhuesi ose sa më pranë specifikimeve të prodhuesit. Të modifikohen pajisjet sa më e nevojshme të jetë e mundur për të mundësuar karakteristikat sipas specifikimeve.
Materialet duhet të përcaktohen për të mbështetur një ngarkesë prej 1-1/2 herë peshën e derës dhe pajisjeve të tjera pa deformimin të cilat mund të ndërhyjnë me veprimin e derës.
Menteshat dhe dorezat duhet të jenë prej çeliku

14.7 PRODHIMI

14.7.1 Korniza Standarde prej Çeliku

Të formohen kornizat në madhësi dhe forma të treguara, me anë të ngjitura ose me anë të cilat mund të çmontohet në terren.

Kornizat e Salduara

Në mënyrë të vazhdueshme të ngjiten/saldohen anët e kornizave në cepat e tyre, mekanikisht të lidhen ose të saldohen/ngjiten në mënyrë të vazhdueshme ndalesat. Të gërryhen në mënyrë të sheshtë saldimet.

Kornizat e hedhshme

Të përcaktohen anët për mbledhje të thjeshta në terren nga kapëse të fshehura, pllakëza të thurura, ose bashkime të ndërthurura të cilat prodhojnë anë të forta dhe një bashkim të ngushtë dhe ruajnë drejtimin e bashkimeve. Të mundësohen dado për bulonat aty ku kryhen këto lidhje.

Shiritat Ndërmjet Dritareve

Shiritat ndërmjet dritareve duhet të jenë të mbyllura ose të një ndërtimi tubuar dhe shiritat duhet të bashkohen me to. Fundi i dyerve me shirita duhet të kenë ankorime dyshemeje të rregullueshme dhe lidhje të hapura.

Ndalesat dhe Thepat

Ndalesat e thepave nga trashësia 0.9mm deri në 20 herë për çelikun. Të mundësohet për hapjen dhe materialet me xham në kornizat standarde të çelikut. Këto ndalesa të thepave të sigurohen tek kokat ovale, me vidat me koka të zhytura e me vida të zhytura ose kapëse të mbyllura. Kapëset e hapësirave përreth 300 deri në 400mm 12 deri në qendër. Format e mundësuara tek anët ose të anëve katrore.

Kanatet per hapjet

Të prodhohen kornizat për këto hapje nga i njëjti material, trashësi dhe mbledhje siç specifikohet për dyert metalike, përveç ndalesave të dyerve dhe përgatitjes së materialeve.

Ankorat

Të mundësohen ankorimet për të siguruar ndërtimin e kornizave me ndërtimin ngjitur. Të mundësohen ankorat prej çeliku ose të lyer me bojën e cila parandalon ndryshkun me bojë zinku, jo më e lehtë se sa
1.2mm nëtrashësinë 18 të çelikut.

Materialet rezistente ndaj motit

Për nga jashtë mund të përdoren shiritat e zinj me gomë sintetike me kapëse për vendosje të fabrikuar nëhapjet e mundësuara nga fabrika, ose me kasketa të dala prej neopreni të prodhuara për tu vendosur në hapjet e vazhdueshme të kryera në korniza.

Pjesa qendrore e Izolimit

Berthama e izolimit do të jete e llojit të specifikuar, duhet të mundësohet mbledhja maksimale për vlerën U të 0.48.

Përgatitja e Materialeve

Te perforcohen, hapen dhe vendosen menteshat e dyerve dhe kornizave për të marre materialin e përfunduar. Përgatitni materialet e dyerve dhe kornizave.

Veshja finale

Vetëm nëse nuk është e specifikuar ndryshe te mundesohet nje veshje finale të lyerjes nga fabrika me një shtresë zinku të lyer në të nxehtë. Pas, aplikoni dy emanel tek sipërfaqet e ekspozuara. Më vete thani ose vendosini në furrë secilën dorë boje. Kërkesat për kohën e tharjes dhe ato të temperaturës duhet të jenë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të bojës. Ngjyrat e bojës së përfunduar duhet të përmbushin shembujt e ngjyrave të miratuara.

Punimi

Dyert dhe kornizat e përfunduara duhet të jenë të forta dhe të pastra në paraqitje, pa defekte, valëzime, gërvishtje, vrima, anime. Pjesët e futura duhet të jenë të prera pastër, drejt, dhe me

bashkime të formuara mirë dhe të drejta. Të adreson saldimet e ekspozuara dhe bashkimet të gërryhen pastër. Seksionet e kornizave të dyerve për përdorim në mur siç tregohet. Bashkimet anësore duhet të jenë të mirë formuara dhe të drejta.

14.7.1.1 DYERT E ALUMINIT

Për instalimin e sistemit në këtë kapitull, duhet të dorëzohet një instalim i plotë dhe skicat e instalimit duke përfshirë përllogaritjet dhe pajisjet sipas përshkrimit tek këto specifikime teknike. Vetëm teknikë të licencuar dhe të aftë janë të autorizuar të instalojnë sistemin. Përmbushja e kërkesave bazë gjithashtu do të kërkohet si më poshtë:

Shiritat e ndërtuar në brendësi të profileve të aluminit ose çelikut
Të gjitha profilet e çelikut duhet të jenë të galvanizuara (brenda dhe jashtë) dhe të lyera Të gjitha profilet e aluminit duhet të jenë të lyera
Profilet termikisht të ndara duhet të jenë si grup materiali 1.0 me 5 dhoma termike
Profilet nga xhami strukturor i përshtatshëm me panele hapëse duke përfshirë ngjitet tek EPDM, me rezistencë absolute ndaj motit.
Profilet me kllapa të jashtme me vida hekzagonale të dukshme V2A dhe profile mbuluese – horizontale si profile U dhe vertikale si profile H.
Mundësimi i kullimit të mjaftueshëm të ujit të shiut.
Dimensionet e Profilit:
Gjerësia e brendshme e dukshme tek panelet e dritareve përreth 50 mm Gjerësia e jashtme e dukshme e profileve me kllapa përreth 50 mm Gjerësia e dukshme e shiritave përreth 50 mm
Anët e përparme të dyerve (ose më mirë kornizave) duhet të jenë të sheshta me profilet me kllapa.
Seksionet e profileve duhet të jenë në përputhje me përllogaritjet strukturore.
Thurjet në formë rrjeti dhe të gjithë elementët mbushës në përputhje me vizatimet teknike të detajuara.

14.7.2 Xhamat

Kërkesat Minimale:
Xham ISO Uv<1,1 W/m2K si xhamat pluskues, të jashtëm dhe të brendshëm me xham sigurie të temperuar, trashësia min. 8 mm, cepa plastikë Izolim për zhurmat ajrore: R'Ëp 37 dB Izolim i Zhurmave Aksiale 46 dB në drejtimin Horizontal dhe 51dB në drejtimin Vertikal (në afërsi të pllakave) Lartësia Maksimale – shih vizatimet
Xhamat:
Xhama të dyfishtë sigurie të temperuar – (ngjyra ekzakte për tu dakorduar me Supervizorin).
Ngjyra:
Të gjithë elementët e dukshëm të veshur (DIN EN ISO 12944) në RAL të përshkruar në vizatime ose të dakorduar me Supervizorin).
Sistemi i Izolimit:
K = 1,30W/m2K
Transparenca Totale e Energjisë g=0,58
Montimi duhet të lejojë bashkimin pa shtrëngim duke lejuar lëvizjet zgjeruese. Bashkimet me strukturën e ndërtesës duhet të jenë kundra avullit.
Nëse kërkohet nga Supervizori, Kontraktori duhet të kryejë një test për të provuar veçoritë e izolimit akustik të dyerve të aluminit.
Të gjithë bashkimet duhet të jenë mekanikë. Përdorimi i shkumave zgjeruese dhe ngjitësve është i ndaluar. Kontraktori do të jetë përgjegjës, me kostot e tij, për të kontrolluar përfundimisht dimensionet e materialeve para dorëzimit të tyre në sheshin e ndërtimit.

Mbrojtja nga korrodimi i elementëve duhet të rregullohet, nëse dëmtohet, gjatë montimit. Ngjitësit nuk duhet të përmbajnë agjentë zbutës.

14.7.3 Hapjet e Dritareve në Dyer

Siguroni hapje xhami me kornizat prej druri standarde të prodhuesit. Kornizat për dyert që do të marrin rifiniturë natyrale duhet të jenë të të njëjtës tipi dhe ngjyre si veniti i faqeve. Kornizat për dyert e rrafshëta do të jenë të tipit me buzë.

14.7.4 Aksesorët e dyerve

Siguroni, aq sa mund të jetë e realizueshme, brava, mentesha, akse, dhe mekanizma të një fisheku, menteshe ose mekanizmi, ose të përafërt me ato të prodhuesit. Modifikoni aksesorët sipas nevojës për siguruar karakteristikat e treguara ose të specifikuara.
Aksesorët duhet të jenë të studiuara për të mbajtur peshën e vdekur të 1-1/2 më shumë se e vetë derës dhe aksesorët e fiksuar duhet të jenë pa deformime që do të pengonin në funksionimin e derës.
Menteshat në sipërfaqe druri natyral ose plastike të dyerve të brendshme duhet të jenë prej çeliku me veshje tunxhi ose bronxi
Dorezat do të jenë prej tunxhi
Fishekët cilindrikë, duhet të jenë si më poshtë:
Kasa dhe shul prej çeliku të plotë, të veshura me zink për mbrojtje nga ndryshku Të garantuara për më shumë se 150,000 cikle jete
Pjesët e ekspozuara duhet të jenë ose prej çeliku të farkëtuar ose tunxhi. Cilindra me 5 kunja, bravë me tre çelësa tunxhi të nikeluar
Bravat elektronike duhet të kenë kode të ngjashëm për të theksuar komoditetin, Bravat elektronike duhet të kenë një kod bazë me një kombinim të thjeshtë, Bravat elektronike duhet të jenë të lehta për tu montuar.
Trashësia e kornizave të bravës duhet të jetë 2 mm dhe madhësia e saj duhet të jetë 28mm x 70 mm, Thellësia e vendit të gjuhëzës duhet të jetë 12,5 mm,
Krahu duhet të jetë tërësisht i ndryshueshëm për montim si në dyer me krah hapjeje të djathtë ose të majtë, Trashësia e derës duhet të jetë e modifikueshme 35 mm deri 50 mm sipas standardeve ose 50 mm deri në 70 mm në raste të veçanta,
Dyert e Hyrjes do të kenë:
Gjuhëza me mekanizëm sigurie
Duke shtypur butonin në dorezën e brendshme bllokohet doreza e jashtme. Doreza e brendshme qëndron gjithmonë aktive
Rrotullimi i dorezës sëbrendshme ose çelësi nga jashtë do të hapin gjuhëzën
Secila nga dorezat vepron mbi gjuhëzën përveç rastit kur doreza e jashtme është bllokuar nga brenda Banjat ose Dyer të tjera Private do të kenë:
Secila nga dorezat vepron mbi gjuhëzën përveç rasteve kur doreza e jashtme është kyçur nga shtypja e butonit tëbrendshëm,
Futja dhe rrotullimi i një monedhe në bravën e urgjencës do të hapë derën nga jashtë. Doreza e brendshmeështë gjithmonë aktive
Shtypja e butonit tëbrendshëm bllokon dorezën e jashtme Dyert që nuk kërkojnë mbyllje do të kenë:

Secila nga dorezat vepron gjithmonë mbi gjuhëzën
Të përshtatshme për përdorim në dhoma magazinimi ose kuzhinë Dyert e magazinimit, hotelit dhe të daljes do të kenë:
Gjuhëza të aktivizuara nga doreza në pjesën e brendshme dhe çelës në anën e jashtme Doreza e brendshmeështë gjithmonë aktive
Doreza e jashtmeështë gjithmonë e palëvizshme
Grupet e levave cilindrike, të dhënat e tyre teknike duhet të jenë si më poshtë: Kasa dhe trup prej çeliku, të veshura me zink për mbrojtje nga ndryshku
Të garantuara për më shumë se 150 000 cikle jete
Pjesët e ekspozuara duhet të jenë prej zinku të derdhur ose tërësisht prej tunxhi. Cilindra me 5 kunja, bravë me tre çelësa tunxhi të nikeluar
Bravat duhet të jenë të ngjashme me ato me gjuhëza siguria për të maksimizuar sigurinë, Bravat duhet të jenë të lehta për tu montuar.
Trashësia e kornizave të bravës duhet të jetë 2 mm dhe madhësia e saj duhet të jetë 28mm x 70 mm, Thellësia e vendit të gjuhëzës duhet të jetë 12,5 mm,
Krahu duhet të jetë tërësisht i ndryshueshëm për montim si në dyer me krah hapjeje të djathtë ose të majtë, Trashësia e dyerve duhet të jetë e modifikueshme 35 mm deri 50 mm sipas standardeve,
Të gjitha instalimet dhe kërkesat për të kompletuar një punim të cilësisë së parë duhet të jenë të përfshira. Shembuj të bravave automatike do ti dorëzohen Supervizorit për një aprovim paraprak para montimit të tyre.

14.7.5 Emertimi

Të gjitha dyert duhet të kenë një stampë, markë, ose një shenjë identifikimi që tregon cilësinë dhe ndërtimin e derës.

14.7.6 Para-përgatitja

Dyert mund të jenë të para-përgatitura për montim nga fabrika. Dyert duhet të kenë përmasat dhe përpunimin që në fabrikë nga prodhuesi në përputhje me standardet përkatëse të prodhimit të tyre. Puna duhet të përfshijë përmasat, zbutja e cepave, kllapat dhe hapja e vendeve të aksesorëve si dhe sigurimi i hapjeve të nevojshme për xhamat dhe pajisjeve të ajrimit. Prodhuesit i duhet siguruar shembujt e nevojshëm të aksesorëve, si dhe programin përkatës të dorëzimit të kornizave dhe aksesorëve që nevojitet për të koordinuar punën.

14.7.7 Rifinitura

Rifinitura Natyrale
Sigurohet për dyert e përfunduara në fabrikë nga prodhuesi si më poshtë: Ngjyra duhet të jetë me gjysmë shkëlqim, me efekt mbushje poresh. Vulosni cepat, prerjet, zbukurimet, dhe aksesorët prej druri, dhe aplikoni dy duar boje të përputhshëm me rifiniturën e faqes së derës. Korrigjoni rifiniturën që mund të jenë gërvishtur ose dëmtuar, ose aty ku janë mbushur vrimat e aksesorëve të ekspozuar, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit të dyerve. Përputhni ngjyrën dhe shkëlqimin me atë të rifiniturës së fabrikës duke përdorur materiale të përshtatshëm.
Rifinitura me Plastikë të Laminuar
Është e aplikuar në fabrikë, e tipit të Përgjithshëm ose Specifik, me trashësi minimale 1.25 mm. Laminati Plastik ngjitet në venir druri, kompensatë ose plakë druri për të formuar panelin e derës për dyer me bërthamë boshe. Trashësia minimale e fletëve të laminuara dhe atyre mbështetëse duhet

të jetë 2.5 mm
Ngjyra
Te sigurohen ngjyrat e rifiniturës së dyerve bazuar në kampionin e ngjyrave.

14.8 DYERT METALIKE

14.8.1 Dyert Metalike Standarde

Konstruksioni i bërthamës do të jetë me shufra vertikale çeliku. Dyert do të jenë 45 mm të trasha, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe dhe do të kenë faqe me pamje krejtësisht të rrafshët. Dyert e jashtme do të kenë cepin e sipërm të mbyllur dhe vulosur rrafsh për të parandaluar fujen e ujit.

14.8.2 Dyert e Sigurisë së Lartë

Dyert e brendshme në zonat e sigurisë duhet të kenë dimensionet dhe dizenjot e përcaktuara në vizatime. Në hapësirën e bërthamës ndërmjet shufrave duhet të jenë të mbushura me material izolues me fibra minerali.

14.9 AKSESORËT

14.9.1 Ajrosësit / grilat

Ajrosësit e Brendshëm

Ajrosësit duhet të jenë të palëvizshëm dhe të mos lejojnë shikimin aty ku parashikohen. Fletët e ajrosësit do të saldohen ose fiksohen në kornizë dhe i gjithë elementi do të bashkohet me derën nëpërmjet kornizave. Formoni fletë me trashësi 0.9 mm nga llamarina e çelikut 20.

Ajrosësit e Jashtëm

Ajrosësit duhet të jenë të tipit Z të përmbysur me minimalisht 30 për qind hapje pa rrjetë. Fletët e ajrosësit do të saldohen ose fiksohen në një kornizë me kanal të vazhdueshëm dhe i gjithë elementi do të saldohet me derën për të krijuar një bashkim rezistent ndaj ujit. Formoni ajrosësit me çelik të galvanizuar me nxehtësi në të njëjtën trashësi me metalin e faqes së derës.

14.9.2 Kornizat

Siguroni korniza rreth xhamave të dyerve të jashtme dhe të brendshme si dhe ajrosësve të dyerve të brendshme. Siguroni korniza të pa-çmontueshme në anën e jashtme të dyerve të jashtme dhe në faqen e korridorit të dyerve të brendshme.

14.9.3 Aksesorët e Dyerve

Siguroni, aq sa mund të jetë e realizueshme, brava, mentesha, akse, dhe mekanizma të një fisheku, menteshe ose mekanizmi, ose të përafërt me ato të prodhuesit. Modifikoni aksesorët sipas nevojës për siguruar karakteristikat e treguara ose të specifikuara.
Aksesorët duhet të jenë të studiuara për të mbajtur nje peshe rendese 1-1/2 më te madhe se ajo e vetë derës dhe aksesorët e fiksuar duhet të jenë pa deformime që do të pengonin në funksionimin e derës.
Menteshat dhe dorezat duhet të jenë prej çeliku.

14.10 PRODHIMI

14.10.1 Kornizat Standarde prej çeliku

